



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Informatikë Ekonomike”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Elva LEKA

Dr. Senada BUSHATI

Janar / 2026

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Informatikë Ekonomike"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Statistikë Informatikë e Zbatuar
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Informatikë Ekonomike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 4250/1 prot, datë 30.07.2003 Urdhër MAS Nr. 110, datë 04.03.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr.297 datë 20.07.2012, ndryshuar me Urdhër MASH Nr. 355, datë 30.08.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip /Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2022 – 2023 – 54 PAE/36 PAK 60%/40% v.a. 2023 – 2024 – 65 PAE/37 PAK 64%/36% v.a. 2024 – 2025 – 69 PAE/34 PAK 67%/33%
18	Numri i studentëve:	v.a. 2022 – 2023 – 241 studentë

		v.a. 2023 – 2024 – 241 studentë v.a. 2024 – 2025 – 241 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Hapja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është miratuar me Shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 4250/1 prot, datë 30.07.2003, me kohëzgjatje studimi 4-vjecar, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit; dhe ndryshuar në sistem 3-vjecar, nga Drejoria e Kurrikulës dhe Standarteve, me anë të shkresës me Nr. 1326 prot, datë 30.05.2011 të Universitetit të Tiranës.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e Informatikës Ekonomike.

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe dhe angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Informatikë Ekonomike” në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2003 – 2004. Në vitin akademik 2022 – 2023, janë regjistruar 241 studentë, në vitin akademik 2023 – 2024, 241 studentë, në vitin akademik 2024 – 2025, 241 studentë.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: **Dr. Elva Leka** dhe **Dr. Senada Bushati**, me mbështetjen e koordinatores së ASCAL, MSc. Denisa Bogdani.

Procesi i vlerësimit të jashtëm në bazë të agjendës ka filluar më 16.07.2025, me dorëzimin nga ana e Universitetit të Tiranës të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës. Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një agjende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës në datat 11 dhe 12 Shtator 2025, GVJ vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh dhe intervistash me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësin e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Degës së Procesit Mësimor, me përfaqësues të Degës së Kulifikimit Shkencor, të degës së Sigurimit të Cilësisë, të degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, përfaqësues të degës së Sigurimit të Cilësisë, të degës së Ekselencës dhe Zhvillimit të Karrierës, dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Pas shqyrtimit të të gjitha të dhënave dhe informacionit të mbledhur, është hartuar draft-raporti i vlerësimit të jashtëm, i cili është dërguar për shqyrtim nga institucioni përkatës. Pas marrëdhënies së komenteve dhe sugjerimeve nga institucioni, raporti ka marrë formën e tij përfundimtare. Ky proces ka pasur si qëllim të ofrojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të cilësisë së programit të studimit, duke ofruar gjithashtu rekomandime për përmirësimin e tij dhe rritjen e standardeve të arsimit të ofruar.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.01.2026, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 17/2 Prot., datë 13.01.2026.

Universiteti i Tiranës përcolli komentet, përmes AMS, më datë 26.01.2026 dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot. 137/3, datë 27.01.2026, ardhur në protokollin e ASCAL më datë 28.01.2026.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si më poshtë vijon:

1. Në lidhje me komentin për *Standardin II.3*, GVJ ka vlerësuar në tërësi nëse programi është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të tij.

Në *Kriterin 4, Standardi II.3*, GVJ ka vlerësuar paraqitjen e informacioneve të nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.

GVJ vlerëson punën e stafit akademik të FE. Konkretisht, gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi që shumica e orëve mësimore zhvillohen totalisht në sallat e laboratorëve të FE duke përcjellë tek studentët kompetenca praktike shumë të rëndësishme për tipologjinë e këtij

Adresa: Blloku i Ambasadave,
Rruga Skënderbej, P. 8, Sh. 1, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

4

programi studimi. Megjithatë, sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 4, Standardi II.3*, GVJ nuk gjen të reflektuar në syllabuset e lëndëve dhe në planin mësimor kredite/orë të dedikuara për detyrat e kursit. Gjithashtu, konstatohet që në syllabuset e lëndëve në sesionin "Forma e vlerësimit të dijeve", detyrat e kursit janë pjesë e vlerësimit përfundimtar të lëndës, por ky komponent formues nuk është i parashikuar në planin mësimor të programit. Rekomandimi i GVJ lidhet me saktësimin e komponentëve formues dhe unifikimin e tyre në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve si edhe pasqyrimin e kodit të lëndëve në to.

Për sa më sipër, vlerësimi i standardit II.3 **nuk ndryshon**.

2. Në *Standardin II.4*, GVJ ka vlerësuar në tërësi strukturën dhe organizimin e programit të studimit, përputhjen me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve

Sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 1, Standardi II.4, GVJ rekomandon: "Lëndët në planin mësimor të këtij programi studimi e kanë të nevojshme zhvillimin në ambiente laboratorike për aftësimin e studentëve në fushën e informatikës dhe formimin e tyre profesional për tregun e punës."*

GVJ: Në përmbushje të Kriterit 1, të Standardit II.4, evidentojmë se programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" zhvillon orët e seminarit në ambiente laboratorike. Veçanërisht, lëndët me karakter praktik, si Programim Java, Programim në Web, Strukturë të Dhënash, Databaza, etj., kanë të detyrueshëm zhvillimin e seminareve në laboratorë. Për realizimin e këtyre aktiviteteve, Fakulteti ofron infrastrukturën e nevojshme, konkretisht 9 laboratorë të pajisur me rreth 250 poste pune, sipas referencës në Tabelën 16 (Aneks - Tabelat Përmbledhëse)."

Për sa më sipër, vlerësimi i standardit II.4, kriteri 1 **ndryshon**.

Hiqet rekomandimi: "Lëndët në planin mësimor të këtij programi studimi e kanë të nevojshme zhvillimin në ambiente laboratorike për aftësimin e studentëve në fushën e informatikës dhe formimin e tyre profesional për tregun e punës".

Bëhet konstatim: "Lëndët në planin mësimor të këtij programi studimi e kanë të nevojshme zhvillimin në ambiente laboratorike për aftësimin e studentëve në fushën e informatikës dhe formimin e tyre profesional për tregun e punës. Për realizimin e këtyre aktiviteteve, Fakulteti ofron infrastrukturën e nevojshme laboratorike të pajisur me 250 poste pune."

3. Në *Standardin III.1*, GVJ ka vlerësuar në tërësi procesin e të nxënit, aftësimin e profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 3, Standardi III.1*, GVJ nuk gjen të reflektuar evidencë nga planifikimi i buxhetit për mbështetje financiare për kërkimin shkencor, për të mbështetur stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca apo publikime në revista shkencore të indeksuara.

GVJ: GVJ rekomandon që institucioni të rrisë fondet e dedikuara për mbështetjen e aktivitetit kërkimor-shkencor të stafit akademik dhe njëkohësisht, të hartojë e zbatojë një procedurë të standardizuar të mbështetjes financiare, e orientuar drejt fuqizimit të publikimeve në revista të

indeksuara (SCOPUS, Web of Science), pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe rritjes së performancës kërkimore-shkencore të institucionit.

GVB: Në përmirësim të përmbushjes së Kriterit 3 të Standardit III.1, jemi dakord me rekomandimin e dhënë nga GVJ për rritjen e fondeve të dedikuara për mbështetjen e aktivitetit kërkimor-shkencor të stafit akademik, si dhe për hartimin dhe zbatimin e një procedure të standardizuar të mbështetjes financiare. Ky rekomandim do t'i përcillet organeve drejtuese të institucionit për shqyrtim dhe zbatim, me synim fuqizimin e publikimeve në revista të indeksuara (SCOPUS, Web of Science), pjesëmarrjen në konferenca shkencore dhe rritjen e performancës kërkimore shkencore të institucionit.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit III.1, Kriteri 3 **nuk ndryshon.**

4. Në *Standardin III.3*, Kriteri 5, GVJ ka rekomanduar: "*Duke marrë parasysh faktin që të gjithë studentët e programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" i realizojnë detyrimet përmbyllëse me tezë diplome, GVJ rekomandon që softueri Turnitin të përdoret për parandalimin e plagjiaturës edhe në ciklin e parë, Bachelor.*"

GVB: Në përmirësim të përmbushjes së Kriterit 5 të Standardit III.3, jemi dakord me rekomandimin e dhënë nga GVJ për përdorimin e softuerit Turnitin edhe në ciklin e parë të studimeve, Bachelor, me qëllim parandalimin e plagjiaturës në detyrimet përmbyllëse me tezë diplome. Ky rekomandim do t'i përcillet organeve drejtuese të institucionit për shqyrtim dhe zbatim. Gjithashtu, bëjmë me dije se ky shqetësim është ngritur më herët nga përgjegjësi i Departamentit të SIZ në mbledhjet e Dekanatit dhe më pas është përcjellë pranë Rektoratit.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit III.3, Kriteri 5 **nuk ndryshon.**

5. Në *Standardin III.5*, Kriteri 2 GVJ ka vlerësuar nëse strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.

GVJ: "GVJ konstaton se aktualisht mungon një manual i posaçëm për përgatitjen e tezës së diplomës. Për këtë arsye, GVJ rekomandon hartimin e një manuali udhëzues për procesin e përgatitjes së tezës së diplomës dhe vënien e tij në dispozicion të studentëve, duke e publikuar gjithashtu edhe në faqen zyrtare të institucionit."

GVB: Në përmbushje të Kriterit 2 të Standardit III.5, e vërtetojmë se, për programin e studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", në funksion të detyrimeve përmbyllëse, njësia bazë, nëpërmjet personelit ndihmës akademik, u komunikon studentëve përmes email-it informacionin mbi pedagogun udhëheqës, si dhe dokumentacionin mbështetës për realizimin e punimit të diplomës. Departamenti i SIZ ka hartuar një manual udhëzues për realizimin e punimit të diplomës, të specifikuar për studentët e programit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Ky dokument u dërgohet studentëve me email nga stafi ndihmës akademik dhe njëkohësisht vendoset në platformën Microsoft Teams nga secili pedagog, në klasat e krijuara për menaxhimin e procesit të udhëheqjes së diplomave. Ky dokument është shtuar në evidencën: 13.2.1 - IE - Udhezues_Diploma_Bachelor.

GVJ: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, nuk ekziston një evidencë e tillë.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit III.5, Kriteri 2 **nuk ndryshon**.

6. Në *Standardin III.5*, Kriteri 6: Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.

GVJ: GVJ rekomandon që Fakulteti të ngrrejë komisionet e mbrojtjes së diplomave me jo më pak se 3 anëtarë, për të siguruar transparencë më të lartë dhe vlerësim më objektiv të diplomave të studentëve.

GVB: Në përmbushje të Kriterit 6 të Standardit III.5, evidentojmë se, sipas "Rregullores së Diplomimit", Neni 6, pika d, në seksionin "Procedura e mbrojtjes së diplomës", përcaktohet se komisioni i mbrojtjes së diplomës përbëhet nga të paktën dy anëtarë, staf akademik i fushës së studimit ku përfshihet studenti. Gjithashtu, sipas Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë për programet Bachelor, Neni 38, pika 4, theksohet se "vlerësimi përfundimtar i temës së diplomës është shumatore e vlerësimit të pedagogut udhëheqës dhe vlerësimit të komisionit". Duke u mbështetur në këto përcaktime, pedagogu udhëheqës është pjesë e komisionit të mbrojtjes së diplomës, pasi në vlerësimin përfundimtar përfshihen vlerësimet e pedagogut udhëheqës dhe të paktën dy anëtarëve të komisionit, çka nënkupton se vlerësimi realizohet nga jo më pak se tre pedagogë.

GVJ: GVJ dakortëson që mënyra e vlerësimit është e përcaktuar në rregulloret përkatëse. Mirëpo gjatë vizitës në institucion pranë sekretarisë mësimore, GVJ konstatoi procesverbale të vlerësimit të studentëve të diplomuar të firmosura vetëm nga një anëtar i stafit akademik.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit III.5, Kriteri 6 **nuk ndryshon**.

7. Në *Standardin IV.1*, Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ: GVJ vëren se stafi PAE ka ngarkesë të lartë, dhe nuk ka një shpërndarje uniforme. GVJ rekomandon që, në mbështetje të realizimit të ngarkesës mësimore të ketë një shpërndarje uniforme tek stafi PAE."

GVB: Në përmbushje të Kriterit 2 të Standardit IV.1 jemi të vetëdijshëm se personeli akademik PAE, në periudha të caktuara, përballet me një ngarkesë të konsiderueshme. Kjo ngarkesë vjen, ndër të tjera, edhe si pasojë e faktorëve të mëposhtëm: lëvizjeve të stafit akademik për pjesëmarrje në aktivitete në kuadër të projekteve kërkimore dhe zhvillimore; shkëputjeve të përkohshme nga puna për arsye të lejes së lindjes; marrjes së vitit sabbatik; si dhe angazhimit në mësimdhënie jashtë vendit, në kuadër të projekteve ose marrëveshjeve të bashkëpunimit ndëruniversitar.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit IV.1, Kriteri 2 **nuk ndryshon**.

8. Në *Standardin IV.1*, Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

GVJ: GVJ rekomandon të bëhen raportimet vjetore të DSIZ, për dy vitet e fundit akademike, 2023-2024, 2024-2025."

GVB: Në përmbushje të Kriterit 3 të Standardit IV.1, bëjmë me dije se raportet për secilin vit akademik realizohen në mbyllje të vitit akademik përkatës, prandaj nuk kemi dorëzuar evidencë për raportin vjetor të DSIZ për 2024-2025, pasi RVB është punuar dhe dorëzuar pa u mbyllur viti akademik 2024-2025. Përsa i përket raportit vjetor të DSIZ për vitin akademik 2023-2024 nuk kemi dorëzuar evidencë më vete por të dhënat e nxjerra nga DSIZ për atë vit akademik janë pjesë e raportit vjetor të FE për 2023-2024, me evidencë: 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.

GVJ: Çdo njësi bazë dhe kryesore në IAL duhet të realizojë raportimet vjetore analitike të punës së realizuar për cdo vit akademik.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit IV.1, Kriteri 3 **nuk ndryshon.**

9. Në Standardin IV.3, Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

GVJ: GVJ rekomandon të shtohen postet PC në bibliotekë, në mbështetje të studentëve.”

GVB: Për të realizuar sa më mirë përmbushjen e Kriterit 3 të Standardit IV.3 jemi dakord me rekomandimin e bërë nga GVJ për shtimin e posteve PC në bibliotekë dhe do ta përcjellim atë në organet drejtuese të institucionit.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit IV.3, Kriteri 3 **nuk ndryshon.**

10. Në Standardin IV.4, Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

GVJ: GVJ vëren se “Në sistemin ‘Sistemi inteligjent i dokumentacionit shkresor’, viti 2016, dhe rekomandon të shtohen shërbime e reja për ruajtjen e të dhënave të stafit akademik.”

GVB: Në përmbushje të Kriterit 2 të Standardit IV.4, jemi dakord me rekomandimin e dhënë nga GVJ për shtimin e shërbimeve të reja në “Sistemin inteligjent të dokumentacionit shkresor” dhe do ta përcjellim këtë rekomandim pranë organeve drejtuese të institucionit për shqyrtim dhe zbatim të mëtejshëm.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit IV.4, Kriteri 2 **nuk ndryshon.**

11. Në Standardin IV.5, Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.

GVJ: GVJ Rekomandon që “Të publikohen në faqen zyrtare të UT-së, në seksionin ‘Programi i Transparencës’ [<https://unitir.edu.al/programi-transparencës-2/>], dokumentacioni mbështetës për procesin e auditimit.”

GVB: Në përmbushje të Kriterit 3 të Standardit IV.5, vlerësojmë rekomandimin e dhënë nga GVJ për publikimin në faqen zyrtare të UT-së të dokumentacionit mbështetës për procesin e

auditimit. Ky sugjerim do t'i përcillet Dekanatis të FE-së, me qëllim adresimin dhe ndjekjen e mëtejshme të tij pranë organeve kompetente.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit IV.5, Kriteri 3 **nuk ndryshon**.

12. Në Standardin V.4, Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

GVJ: GVJ Rekomandon “Të azhurnohet raporti vjetor i DSIZ, në referencë me programin e studimit për vitin 2023-2024, 2024-2025.”

GVB: Në përmbushje të Kriterit 4 të Standardit V.4, raportet realizohen në mbyllje të vitit akademik përkatës. Për këtë arsye, nuk është dorëzuar evidencë për raportin vjetor të DSIZ për vitin akademik 2024-2025, pasi RVB është përgatitur dhe dorëzuar para përfundimit të këtij viti akademik. Sa i përket vitit akademik 2023-2024, të dhënat e nxjerra nga DSIZ janë të përfshira në raportin vjetor të FE për këtë vit, me evidencë 21.2 – Raporti vjetor FEUT 2023-2024.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit V.4, Kriteri 4 **nuk ndryshon**.

13. Në Standardin VI.1, Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

GVJ: GVJ Rekomandon “Që në raportin vjetor të NJSBC, të përfshihen edhe të dhënat për vitin 2023-2024 dhe 2024-2025 (vjetor).”

GVB: Në përmbushje të Kriterit 2 të Standardit VI.1, sqarojmë se raporti i NJSBC për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025 ishte ende në proces përgatitjeje në momentin e dorëzimit të RVB-së për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”. Aktualisht, dokumenti është përfunduar dhe mund të bashkëngjitet, megjithëse nuk është referuar në raportin e GVB-së. Ky dokument përbën evidencën 17.8 – Raporti NJSBC Master 2024–2025_S2.

GVJ: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, nuk ekziston një evidencë e tillë.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit VI.1, Kriteri 2 **nuk ndryshon**.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij, Universiteti i Tiranës (UT) ka mision të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. Universiteti i Tiranës realizon misionin e tij përmes zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Universiteti i Tiranës ofron programe studimi të cilat janë në përputhje me kriteret e Përcaktuara nga “Karta e Bolonjës” dhe legjislacioni shqipëtar për arsimin. UT përbëhet nga 6 fakultete dhe 2 institute, ka 174 programe në të tre ciklet e studimit dhe rreth 23500 studentë. Evidenca: <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.3. Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028</i> https://unitir.edu.al/historiku/ https://unitir.edu.al/vizioni-dhe-misioni/ https://unitir.edu.al/legjislacioni/
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e Universitetit të Tiranës për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj të cilët do të kontribuojnë në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë me aftësitë e tyre analitike, shkencore, teknologjike, sociale, financiare dhe kritike në sektorët publik ose privat dhe në përputhje me vizionin e UT. Programi synon, ndër të tjera, përgatitjen e individëve të mirëkualifikuar, produktivë, të orientuar drejt kërkimit shkencor dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. Evidenca: <i>Evidenca 1.1. Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.3. Strategjia e zhvillimit të UT 2023_2028</i>

	<p><u>Evidenca 3.1. IE Rregullore e Programit te studimit, Neni 4, 9, 14</u></p> <p><u>Evidenca 5. Plani Strategjik i departamentit DSIZ 2025-2030</u></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të brendshëm të institucionit dhe në përputhje me strategjinë e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar në FEUT.</p> <p>Ky program studimi është zhvilluar në bazë të nevojave të tregut të punës duke u mbështetur në “Rregulloren e programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Fakultetin e Ekonomisë dhe në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Programi i studimit ka për qëllim të përgatisë profesionistë në fushën e ekonomisë, biznesit dhe teknologjisë së informacionit dhe synon të kontribuojë në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është hartuar në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e programit të studimit; - Strategjinë e Zhvillimit të UT 2023-2028 - Planin strategjik të DSIZ 2025-2030 <p>Programi i studimit ka në fokus promovimin e ekselencës së studentëve, përmirësimin e arsimit dhe novacionit si dhe nxitjen e ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. Në kuadër të përmbushjes së objektivave të strategjisë së UT dhe të DSIZ në lidhje me ndërkombëtarizimin, ky program studimi prej 5 vitesh akademike zhvillohet edhe në gjuhën angleze.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 5. Plani Strategjik i departamentit DSIZ 2025-2030</u></p> <p><u>Evidenca 1.3. Strategjia e Zhvillimit te UT 2023-2028</u></p> <p><u>Evidenca 1.1. Statuti i UT, Neni 4,5</u></p> <p><u>Evidenca 3. FE Rregullore e Programit Bachelor, Neni 5</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te studimit, Neni 4, Neni 9, Neni 14</u></p> <p><u>Evidenca 10.4.1 Mobilitete Outgoing Staf Akademik FE 2021-2025</u></p> <p><u>Evidenca 10.4.2 Mobilitete Incoming staf FE</u></p> <p><u>Evidenca 10.4.3 Mobilitete Incoming Student</u></p> <p><u>Evidenca 10.4.4 DSIZ Mobilitete Studente</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së</p>

<p>përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Zbatuar, si pjesë e njësisë kryesore të Fakultetit të Ekonomisë (FE). Në përbërje të tij FE ka gjithashtu: Departamenti i Ekonomiksit, Departamenti i Financës, Departamenti i Kontabilitetit, Departamenti Marketing-Turizëm, Departamenti Menaxhimit, duke demonstruar kapacitet e nevojshme për ofrimin e programit. Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij. Gjatë vitit akademik 2024 – 2025, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, ka në përbërje të tij 34 personel akademik efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6 Prof. Dr; - 12 Prof. Asoc; - 5 Dr; - 11 Msc <p>59 personel akademik me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof. Dr; - 5 Prof. Asoc. Dr; - 14 Dr; - 39 MSc; <p>Departamenti i Ekonomisë Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, në funksion të programeve të studimit që ofron, laboratorë bashkëkohore përmes të cilëve, studentët realizojnë orët praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i><u>RVB Bachelor Informatike Ekonomike</u></i></p> <p><i><u>Tabelat permbledhese [Tabela 2, 6, 7]</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.7. DSIZ CV staf PAE-PAK</u></i></p> <p><i><u>https://feut.edu.al/stafi</u></i></p> <p><i><u>https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departemnti-i-statistikes-dhe-informatikes-se-zbatuar/stafi-i-departementit-siz</u></i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Fakulteti i Ekonomisë zhvillon aktivitetin e tij akademik dhe kërkimor në fushën e shkencave ekonomike dhe degëve të saj, si ekonomiksi, financa, kontabiliteti, marketingu, menaxhimi, informatika, sistemet e informacionit, statistika dhe matematika e aplikuar. Struktura e fakultetit përbëhet nga gjashtë departamente:</p>

<p>klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomiksit; • Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ); • Departamenti i Menaxhimit; • Departamenti i Financës; • Departamenti i Kontabilitetit; • Departamenti i Marketing-Turizmit; <p>Programet e studimit ofrohen në të tre nivelet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë, duke mbuluar si ekonominë ashtu edhe informatikën. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ) ka rol kryesor në mësimdhënien e lëndëve që lidhen me teknologjitë e informacionit dhe statistikat, jo vetëm në Fakultetin e Ekonomisë, por edhe në fakultete të tjera të UT. Ai është i angazhuar në modernizimin e kurrikulave për të përmbushur standardet akademike dhe nevojat e tregut. Në kuadër të cikleve të avancuara, DSIZ ofron programe master dhe doktorature, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemet e Informacionit në Ekonomi • Statistikën <p>Bachelor në Informatikë Ekonomike është një program ndërdisiplinor që bashkon elemente të TIK-ut (fusha 06) me ekonominë (fusha 04). Ai përfshin lëndë si gjuhë programimi, algoritmika, arkitekturë kompjuterash, rrjete, sisteme informacioni, web development, si dhe statistika dhe njohuri ekonomike. Pjesën më të madhe të këtyre lëndëve e mbulon DSIZ. Programi është i harmonizuar me Ligjin 80/2015, aktet përkatëse dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke u klasifikuar në nivelin 6 të KSHK. Kodet e tij janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 63BA0688S (Informatikë Ekonomike – në shqip) • 63BA0688A (Economic Informatics – në anglisht) <p>Evidenca: <u>Aneks Tabelat Permbledhese</u> <u>Evidenca 3. FE Rregullore Programit Bachelor, Neni 3</u> https://feut.edu/programe-studimi https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-statistikes-dhe-informatikes-se-zbatuar <u>Evidenca 1.0. Kodifikimi Programee Studimit Fusha 6 – ICT 2024</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë Statistikës dhe</p>




	<p><i>Informatikës së Zbatuar, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni disponon infrastrukturën laboratorike dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit <i>Bachelor</i> në "Informatikë Ekonomike" realizohet nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, Fakulteti i Ekonomisë, mbështetur në rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik nga fakultete të tjera të Universitetit të Tiranës si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë siguron një strukturë bashkëpunimi të brendshëm efektive për hartimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e programeve të studimit. Ky proces bazohet në ndarjen e qartë të detyrave dhe përgjegjësisë ndërmjet njërive akademike, njërive ndihmëse dhe personelit administrativ, si dhe në monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarive. Përmes një organizimi të qartë dhe komisioneve të specializuara, fakulteti nxit bashkëpunimin ndërmjet departamenteve, veçanërisht për programet me karakter ndërdisiplinor. Personeli akademik angazhohet në grupet e punës për hartimin dhe përditësimin e kurrikulave, duke mundësuar shkëmbimin e praktikave të mira dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Fakulteti bashkëpunon gjithashtu me Rektoratin e Universitetit të Tiranës për çështje strategjike, si</p>

proceset e akreditimit, sigurimin e cilësisë dhe përshtatjen e programeve me kërkesat e tregut të punës dhe kuadrin ligjor.

Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike është projektuar nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ) dhe realizohet në bashkëpunim me departamentet e tjera të Fakultetit, për shkak të natyrës ndërdisiplinore që kombinon lëndë të informatikës dhe të ekonomisë. Mbikëqyrja e programit bëhet në përputhje me Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Parë në FE.

Departamentet kanë rol kryesor në rishikimin e vazhdueshëm të kurrikulave. Në mbledhjet periodike shqyrtohen objektivat mësimorë, përmbajtja e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies, ndërsa ndryshimet kalojnë për miratim në Dekanat, duke garantuar transparencë dhe përfshirje të plotë. Sigurimi i cilësisë realizohet nga Dega e Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me departamentet dhe koordinatorët e programeve. Ky bashkëpunim përfshin analizën e ecurisë, shpërndarjen e pyetësorëve për studentët, vlerësimin e ngarkesës akademike dhe hartimin e raporteve vjetore analitike.

Përkushtimi ndaj cilësisë reflektohet edhe në raportet vjetore të Fakultetit dhe të DSIZ, të cilat analizojnë rezultatet, sfidat dhe masat e marra për përmirësim, duke treguar një proces të vazhdueshëm reflektimi dhe zhvillimi institucional. Analizat e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe administrativ e realizuar nga Institucioni, tregojnë rezultate shumë të kënaqshme referuar rezultateve të mbledhura nga analiza e formularëve të vlerësimit të lëndëve, analiza e strukturës së cilësisë së provimit si edhe procesin e vlerësimit të kurrikulës apo përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit të programeve.

Nga vizita në Institucion dhe takimi me stafin akademik PAE dhe PAK, GVJ vlerëson faktin që institucioni mbështet stafin akademik për rritje profesionale, pjesëmarrje në konferenca, publikime në revista shkencore.

Evidenca:

Evidenca 1.2. Rregullorja e UT

Evidenca 5.2. DSIZ Mbledhje Departamenti Bachelor Lende Program 18.12.2024

Evidenca 21.2. Raport vjetor FEUT 2023-2024

Evidenca 21.3.2. DSIZ Raportim vjetor 2022-2023

Evidenca 17.6. Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri 1

Aneks Tablat Permbledhese

Evidenca 8.1. UT Manual Vleresimit Perosnelit vendimi-nr30-1

	<p><u>Evidenca 8.5. Vendim Sentati Plani strategjik mbi zhvillimin profesional te perosnelit ne UT 23-28</u></p> <p><u>Evidenca 17.2. UT Strategji-Plan-veprimi-per-sigurimin-e-brendshem-te-cilesise21 24</u></p> <p><u>Evidenca 17.3. Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti</u></p> <p><u>Evidenca 17.4. Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti</u></p> <p><u>Evidenca 17.6. Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri I</u></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit Universiteti i Tiranës ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucione homologe vendase e te huaja, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë realizon objektivat e tij akademike dhe formuese përmes një rrjeti të gjerë bashkëpunimesh me institucione vendase dhe ndërkombëtare si: Konfindustria Shqiptare (KISH), Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, Raiffeisen Bank, Autoriteti i Mbkiëqyrjes së Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Instituti i Statistikave (INSTAT), Infosoft Systems shpk, Balfin Group, Intesa San Paolo, Universiteti Wroms në Gjermani, International Management School Geneva, Universiteti Bielfeld në Gjermani, Universiteti i Bologna-s në Itali, Universiteti i Granadës në Spanjë etj. Në zbatim të Statutit të UT, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete, institute kërkimore dhe organizata profesionale për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p>Aktualisht, FE ka 45 marrëveshje kombëtare dhe 26 marrëveshje ndërkombëtare që ofrojnë mundësi për mobilitet studentësh dhe pedagogësh, shkëmbim përvojash, ngritje kapacitetesh dhe përmirësim të kurrikulave. Fakulteti përfiton gjithashtu nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të financuara nga AKKSHI, UNICEF, GIZ dhe programe si Erasmus+, CEEPUS, Horizon Europe dhe Jean Monnet, duke rritur cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar është aktiv në projekte kërkimore mbi teknologjitë e informacionit, sigurinë kibernetike dhe inteligjencën artificiale në bashkëpunim me universitete prestigjioze nga BE dhe rajoni (Gjermani, Norvegji, Itali, Angli, Spanjë, etj.). Pjesëmarrja e stafit në programe trajnimi dhe doktoratura ndërkombëtare ka forcuar kompetencat akademike dhe ka ndikuar në rritjen e cilësisë së programeve. Lista e plotë e marrëveshjeve dhe projekteve është e publikuar në faqen zyrtare të fakultetit, duke</p>

siguruar transparencë për partneritetet dhe aktivitetet bashkëpunuese. Nga vizita në institucion, takimi me stafin akademik, dhe takimin me studentët GVJ konstaton se programi i studimit kishte kryer një sërë shkëmbimesh pedagogësh dhe studentësh me këto institucione, si: Universiteti Koblez, Universiteti Wurzburg SchWeinfurt, Universiteti Kauno Kolegija, Universiteti Paris Nord, Universiteti Radboud, Universiteti Vallabdolid, Universiteti Iasit, Universiteti Teknik i Yildizit, Universiteti Linnaeus, Universiteti Polkitekunik Marke etj. Në kuadër të marrëveshjeve Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar kanë organizuar:

- International Conference on Economy, Business, Innovation and Technology: Transforming Economy and Business through Innovation and Digital Solutions. 13-14 Dhjetor, 2024
- International Conference of Phd Students in Economic Science "Economic development challenges according to Phd schools of thought in Poitiers and University of Tirana, In Hybrid form, Poitiers, France, and Berat, Albania, on 21st and 22 nd of May2024". 21-22 Maj, 2024
- International Conference "Economic Restructruing for Sustainable Development. Impact of Tourism in this Process", 15-16 Dhjetor, 2023.
- International Conference "Rebound, Rebuild and Reinvent for a Sustainable and Equitable Development (3R4SED)". 10-11 Qershor, 2022
- International Conference "Circular Economy: Opportunities and Challenges", 17-18 Nëntor, 2022
- Revista "The Albanian Journal of Economy and Business"

Evidenca:

RYB

Evidenca 1.1. Satuti i UT-Neni 12/5

Evidenca 22.1. Marreveshjet Nderinstitucionale mars 2025

Evidenca 22.2. Lista Marreveshjeve Institucionale Praktikant 2023-2024

Aneks Tableat Permbledhese

Evidenca 21.5.1. Projekte ne implementim nderkombetar ongoing 2024- 2025

Evidenca 21.5.2. FE Projekte kombetare ongoing 2024- 2025

	<p><u>Evidenca 21.5.3. FE Lista e Aplikimeve projekte nderkombetare 2024- 2025</u></p> <p><u>Evidenca 21.5.4. FE Lista Aplikim projekte brenda vendit 2024- 2025</u></p> <p><u>Evidenca 21.7. List of previous projects</u></p> <p><u>Evidenca 21.2. Raporti vjetor FEUT 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 21.4.1. DSIZ Raport Puna kerkimore shkencore 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 21.6 - FE Konferenca Nderkombetare Revista</u></p> <p><u>Evidenca 8.8 – UT Shkresa e Rektorit per rregjistrimin ne ORCID</u></p> <p><u>Evidenca 8.8.1 – UT Manuali per regjistrimin ne ORCID</u></p> <p><u>Evidenca 8.9 – UT Krijimi i profileve ne Google Scholar</u></p> <p><u>https://feut.edu.al/partneritete/partneritete-kombetare</u></p> <p><u>https://feut.edu.al/partneritete/partneritete-nderkombetare</u></p> <p><u>https://feut.edu.al/projektet/209-projekte-nderkombetare</u></p> <p><u>https://unitir.edu.al/tabele-pasqyre-mbi-projektet-aktive-ne-ut/</u></p> <p><u>https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-statistikes-dheinformatikes-se-zbatuar</u></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të informatikës ekonomike, si: Qendra Protik, Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, Posta Shqiptare, Raiffeisen Bank, EuroSig, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Infosystem shpk, Instituti i Statistikave (INSTAT), BKT, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), Banka Kombëtare e Investimeve [Evidencë RVB, Tabela 5, faqe 179] etj.</p> <p>Këto bashkëpunime u ofrojnë studentëve mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale dhe ndihmojnë në harmonizimin e kurrikulës me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë edhe integrimin e moduleve mbi tendencat e reja të sektorëve përkatës. Veçanërisht studentët e programeve të Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ) kryejnë praktika pranë subjekteve që operojnë në fushën e të dhënave, teknologjisë dhe sigurisë së informacionit.</p> <p>FE organizon gjithashtu forume pune, panairë karriere, leksione të hapura me përfaqësues të industrisë dhe aktivitete me rrjetin e alumni-ve, duke forcuar lidhjen mes fakultetit dhe biznesit. Paralelisht, DSIZ kontribuon me projekte konkrete në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat, si dhe me botime shkencore në revista ndërkombëtare, çka rrit profilin akademik dhe ndërkombëtar të departamentit dhe fakultetit. Procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të formalizuara në</p>

	<p>rregulloret institucionale dhe të programeve të studimit, ku përcaktohen përgjegjësitë e studentit, institucionit pritës, udhëheqësit dhe mbikëqyrësit të praktikës, si dhe dokumentacioni përkatës që duhet plotësuar.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i><u>RVB – Aneks Tabelat Permbledhese, Tabela 5, 19, 20, 22</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 22.1. Marreveshjet Nderinstitucionale mars 2025</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 22.2. Lista e marreveshjeve Institucionale 2023-2024</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 22.3. Marreveshjet e Marreveshjeve Institucionale 2022-2023</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.11. FE Panairi i punes 2022, 2023, 2024 dhe 2025</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.13. FE Workshop</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.14. DSIZ Workshops</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.2. Rregullore e UT, Neni 66</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 3. FE Rregullore Programit Bachelor, Neni 35</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.12.1. FE Formular Vleresimi Kompanite</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 22.12.2 FE Formular Vleresimi Studentet</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 13.4.0 Formular Vleresimi Studenti Praktikant pedagog udheheqes bachelor</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 13.4.1. Formular Raporti perfundimtar praktika mesimore bachelor</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 13.4.2. Formular Vleresimi Studenti Praktika mesimore bachelor</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 13.4.3. Formular Miratimi Praktika Mesimore Bachelor</u></i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i “Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar” kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale për të gjithë studentët e tij, në përputhje me programin e studimit të ofruar. Për të analizuar arritjet dhe për të përcaktuar objektivat, kryhen raporte vjetore të realizuara nga Departamenti dhe Raporte Vjetore Institucionale, të realizuar nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Raportet hartohen bazuar ne 4 vlerësime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi praktikës mësimore të studentit nga personi përgjegjës në institucion 2. Vlerësimi i praktikës nga pedagogu përgjegjës 3. Vlerësimi i performancës së studentit pranë institucionit ku ai ka kryer praktikën 4. Vlerësimi i raportit final të cilin studentë dorëzon në përfundim të praktikës. <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se marrëveshjet e bashkëpunimit janë shfrytëzuar si mekanizma strategjike për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe</p>




	<p>përafrimin e tyre me nevojat e tregut të punës. Ato kanë ndihmuar në forcimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore, janë shndërruar në ura për shkëmbimin e studentëve dhe stafit me universitete të huaja, kanë krijuar mundësi të strukturuar për praktika profesionale pranë institucioneve publike dhe private më të rëndësishme, si dhe kanë kontribuar në përshtatjen e vazhdueshme të kurrikulave me zhvillimet e tregut. Përmes tyre është zgjeruar edhe rrjeti i partnerëve të departamentit, duke e pozicionuar atë më fort në kontekstin kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 21.1. Raporti vjetor FEUT 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 21.2. Raporti vjetor FEUT 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 21.3.2. DSIZ Raportim vjetor 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 12.1 - UT Vendimi-nr30-1 Manuali i vleresimit te performances se personelit akademik.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.0 Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udheheqës Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.1 – Formular Raporti Përfundimtar Praktika Mësimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.2 Formular Vlerësimi Studenti Praktika Mësimore Bachelor</u></p> <p>https://feut.edu.al/partneritete/64-partneritete-kombetare</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</i></p> <p><i>Fakulteti i Ekonomisë falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i></p> <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që Institucioni ka kryer shkëmbime të stafit akademik dhe të studentëve me institucionet partnere.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>





Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, i ofruar nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar pranë Universitetit të Tiranës, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program realizohet me ndjekje të mësimit me kohë të plotë, me një kohëzgjatje 3 vjet të ndarë në gjashtë semestra, në përfundim të të cilave studenti fiton 180 kredite. Në planin mësimor paraqitet shpërndarja e lëndëve sipas semestrave, dhe krediteve përkatëse të lëndëve, ku secila lëndë ka të përcaktuara orë mësimore në auditor dhe orë të pavarura. Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.</p> <p>Mbështetur në VKM-në e mësipërme, GVJ konstaton se janë ndërtuar në përputhje të plotë edhe kurrikula dhe planprogramet e lëndëve.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i><u>RVB, Aneks Tabelat Permbledhese – Tabela 9</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.6. IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.1. Vendim Nr1326 – Emertimi Bachelor 2011</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.22. Urdher Nr297 RregjistrimDiplomash Bachelor 2012</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.4. IE Suplement Diplome</u></i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është zhvilluar në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të dispozitave të ligjit numër 10247,</p>

<p>larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>datë 04.03.2010. Orientimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” i specifikuar edhe në Statutin e Universitetit, demonstroi aftësi kërkimore të cilat janë të disponueshme në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. Objektivat kryesore formuese të këtij programi, mbështetur në Nivelin 6 në KSHK, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që një student i diplomuar në Bachelor në Informatikë Ekonomike duhet të plotësojë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor me njohuri të avancuara në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë, duke përfshirë analizën kritike të teorive, parimeve, vlerësimeve të njohurive, mjeteve dhe pajisjeve si edhe kriterëve të performancës; Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për aftësi të avancuara në sistemet informatike duke demonstruar inovacion, zgjidhje të problemeve komplekse, përmirësimin e sigurimit të cilësisë; Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke i përgatitur për përgjegjësi vendimarrje. <p>Kurrikula e programit hap rrugë për shumë profesione si: analistë ekonomike ose statistikë, menaxherë, dizajnues të sistemeve inteligjente ekonomike, konsulentë të sistemeve IT, analistë të të dhënave etj.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.0. Kodifikimi i Programeve të Studimit Fusha 6 – ICT 2024</i></p> <p><i>Evidenca 3.1. IE Draft Rregullore e Programit të studimit, neni 4</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 33 ECTS – 18.33 %, - Lëndë karakterizuese (B) – 96 ECTS – 53.33%, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 23 ECTS – 12.22 % - Lëndë plotësuese (D) – 22 ECTS – 12.22 %, - Detyrime përmbyllëse (E) – 6 ECTS – 3.33 %. <p>Të gjitha komponentët formues të parashikuar në planin mësimor të programit të studimit BSc në Informatikë Ekonomike janë të strukturuar qartë dhe ofrojnë informacion të detajuar. Plani përcakton lëndët e detyrueshme dhe me zgjedhje për çdo semestër, ngarkesën mësimore të secilës prej tyre,</p>

	<p>shpërndarjen e orëve ndërmjet leksioneve, seminareve dhe studimit individual, si dhe elementët përbërës si praktika profesionale dhe diploma. GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41, shpërndarja e veprimtarive formuese është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca nr. 3. FE Rregullore Programit Bachelor</i> <i>RVB – Aneks Tabelat Permbledhese</i> <i>Evidenca 3.1 IE Draft Rregullore Programit te studimit, Neni 9, 14</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përputhet plotësisht me kërkesat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, date 24.01.2018.</p> <p>Si pjesë e lëndëve plotësuese (D) janë parashikuar 5 lëndë në lidhje me “Hyrje në Informatikë”, “Gjuhë e huaj 1 (anglisht)”, “Programim në C++”, “Gjuhë e Huaj 2” dhe “Praktika” gjithsej 22 ECTS. Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 6 ECTS, e cila realizohet me punim Diplome. GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41, Programi i studimit i ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca nr. 3. FE Rregullore Programit Bachelor</i> <i>RVB – Aneks Tabelat Permbledhese</i> <i>Evidenca 3.1 IE Draft Rregullore Programit te studimit, Neni 9, 14</i> <i>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve vendas dhe të huaj bazuar në Statutin e Universitetit, Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Programit të Studimit, bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut. Universiteti i Tiranës nuk është një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.2. Rregullorja e UT</i> <i>Evidenca 3.1. Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe</p>	<p>Universiteti i Tiranës nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtesë. Programi i ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike, i ofruar nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së</p>




<p>me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Zbatuar në Fakultetin e Ekonomisë, përfaqëson programin e parë të këtij profili në Shqipëri dhe ka një traditë tashmë mbi dy dekada. Struktura dhe përmbajtja e tij janë ndërtuar duke u mbështetur në modele të universiteteve ndërkombëtare me reputacion, kryesisht në Gjermani dhe Greqi, si dhe mbi analiza të vazhdueshme të kërkesave të tregut për profile ndërdisiplinore. Krahasuar me programe të ngjashme të studimit të ofruara në vend dhe bazuar në listën e programeve të akredituara nga ASCAL dhe të publikuar në faqen web zyrtare, po përmendim disa prej programeve të ngjashme deri në masën 70%:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Bachelor "Informatikë Ekonomike "</i>, ofruar nga Kolegji Universitar i REALD; 2. <i>Bachelor "Informatikë Ekonomike"</i>, ofruar nga Universiteti European i Tiranës; 3. <i>Bachelor "Informatikë Ekonomike"</i>, ofruar nga Kolegji Universitar Bedër; 5. <i>Bachelor "Informatikë Ekonomike"</i>, ofruar nga Universiteti Metropolitan Tirana; 6. <i>Bachelor "Informatikë Biznesi"</i>, ofruar nga Universiteti i New York-ut Tiranë etj. <p>Evidenca: <u><i>Evidenca 2.0 Vendim 4250 Hapje Programit IE 2003</i></u> <i>RVB – Aneks Tableat Permbledhese</i> https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programe-te-akredituara</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Klasifikimi dhe kodifikimi i programit është kryer në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022, Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022 dhe Kornizën Shqiptare të kualifikimeve.</p> <p>Programi i ciklit të parë Bachelor në Informatikë Ekonomike është i kategorizuar në nivelin 6 të KSHK. Për versionin në gjuhën shqipe, programi është kodifikuar si 63BA0688S, ndërsa për versionin në gjuhën angleze "Economic Informatics" si 63BA0688A.</p> <p>Evidenca: <u><i>Evidenca 1.0. Kodifikimi i Programeve Studimit Fusha 6 -ICT 2024</i></u></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca: <u><i>Evidenca 2.0. Vendim 4250 Hapje Programit IE 2003</i></u></p>

dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e informatikës ekonomike. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>Universiteti i Tiranës ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Tiranës (FEUT) si njësi kryesore është e përbërë nga këto njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Ekonomisë; 2. Departamenti i Financës; 3. Departamenti i Kontabilitetit; 4. Departamenti i Marketing-Turizmit; 5. Departamenti i Menaxhimit; 6. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar; <p>Institucioni, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statutin e Universitetit të Tiranës; 2. Rregulloren e Universitetit të Tiranës; 3. FE Rregullore e Programit Bachelor; 4. Rregulloren e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar; 5. Rregullore e Programit të Bachelor në “Informatikë me Ekonomike”.

Mbi bazën e tyre është ngritur Struktura Akademike e FE si më poshtë:

a. Strukturat drejtuese:

- Dekan (Drejtues i Njesisë Kryesore)
- 4 Zëvendës Dekane:
 - Zëvendës Dekan për Gradat dhe Titujt Shkencorë;
 - Zëvendës Dekan për Sigurinë e Cilësisë, Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me jashtë;
 - Zëvendës Dekan për anën Mësimore, Aktivitetet Studentore dhe Komunikimin;
 - Zëvendës Dekani për Marrëdhëniet me sipërmarrjet dhe institucionet publike.
- 6 Përgjegjës Departamenti (drejtues të Njësive Bazë)

b. Administratori i njësisë kryesore

c. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore

d. Njësitë bazë të punës mësimore shkencore:

- Departamenti Ekonomiks; Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar; Departamenti i Menaxhimit; Departamenti i Financës; Departamenti i Kontabilitetit; Departamenti Marketing Turizëm;

e. Strukturat mbështetëse:


- 1 kryesekretare
- Sekretaria mësimore e FE
- Dega e IT dhe Komunikimit
- Dega e procesit mësimor Bachelor dhe Master
- Asistente e Dekanit
- Dega e Burimeve Njerëzore dhe Prtokoll Arkivës
- Laborantë IT
- Biblioteka
- Dega e kualifikimit shkencor
- Specialist i marrëdhënieve me jashtë pranë Degës së IT dhe Komunikimit
- Dega e sigurimit të cilësisë
- Dega e Ekselencës dhe këshillimit të Karrierës
- Psikologe

Fakulteti i Ekonomisë në vitin akademik 2024-2025 është i përbërë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (168 pedagogë PAE) dhe 221 Personel Akademik me Kontratë, dhe 2 Personel Ndhmës akademik, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Njësia bazë	PAE	Tituj/Grada	PAK	Tituj/Grada
Departamenti i Financës	29	6 – Prof. Dr. 10-Prof.Asoc.	36	0 – Prof. Dr. 3– Prof. Asoc.

		6- Dr. 7- Dr. në Proc		5- Dr. 11 - Dr. në Proc. 17- Msc
Departamenti i Kontabilitetit	22	3- Prof. Dr. 2- Prof. Asoc. 8- Dr. 9 - Dr. në Proc. 0 - Msc	25	2- Prof. Dr. 0- Prof. Asoc. 2- Dr. 2 - Dr. në Proc. 19 - Msc
Departamenti i Ekonomiksit	36	5 - Prof. Dr. 15- Prof. Asoc. 9 - Dr. 7 - Dr. në Proc. 0 - Msc	13	1- Prof. Dr. 2- Prof. Asoc. 1 - Dr. 4 - Dr. në Proc. 5 - Msc
Departamenti i Menaxhimit	29	4 - Prof. Dr. 7- Prof. Asoc. 7- Dr. 11 - Dr. në Proc. 0 - Msc	49	1 - Prof. Dr. 2- Prof. Asoc. 11 - Dr. 10 - Dr. në Proc. 25- Msc
Departamenti i Marketing Turizëm	18	4 - Prof. Dr. 4- Prof. Asoc. 6- Dr. 4 - Dr. në Proc. 0 - Msc	36	1- Prof. Dr. 1- Prof. Asoc. 4- Dr. 15 - Dr. në Proc. 15 - Msc
Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar	34	6- Prof. Dr. 12- Prof. Asoc. 5- Dr. 11 - Dr. në Proc. 0 - Msc	62	1 - Prof. Dr. 4- Prof. Asoc. 17- Dr. 6 - Dr. në Proc. 34 - Msc
Total		168		221

Njësia bazë, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, në FE përgjegjës për programin e studimit, përmbush




detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë [*Evidencë RVB, Tabela 2*]:

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024		2024 – 2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	6	2	6	-	6	1
Prof. Asoc.	9	2	7	2	12	4
Dr./PhD.	7	22	10	13	5	17
Msc.	10	40	12	38	11	40
Totali	32	66	35	53	34	62

Nga sa më sipër Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, GVJ konstaton se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.

Evidenca:

Evidenca 1.1 Statuti i UT.pdf

Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf

Evidenca 3- FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf

Evidenca 3.1 - IE Rregullore e Programit te Studimit.pdf

Evidenca 7.1 - FE Organigrama 2025.pdf

RVB – Aneks Tabelat Permbledhese Tabela 1, 2

Evidenca 2.7 – DSIZ CV Staf PAE-PAK

Evidenca 2.0 – Vendim 4250 Hapje e Programit IE 2003

https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet

https://feut.edu.al/fakulteti/organigrama

https://unitir.edu.al/bordi-i-akreditimit-me-vendim-nr-4-date-27-01-2023-akrediton-universitetin-e-tiranes-me-akreditim-maksimal-prej-gjashtevite

https://unitir.edu.al/akreditimi-periodik-i-universitetit-te-tiranes/

https://unitir.edu.al/akreditimi-i-programeve-te-studimit-te-ut-se/

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit

Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar angazhon në kuadër të praktikave profesionale dhe laboratoreve staf akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimet përkatëse për realizimin korrekt të tyre, duke përdorur udhëzimet e

<p>përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë disponon gjithashtu njësi të specializuara administrative, si Dega e IT dhe Komunikimit dhe Dega e Procesit Mësimor Bachelor dhe Master, të cilat angazhojnë staf administrativ në mbështetje të stafit akademik. Ky staf ofron asistencë kryesisht në funksionimin e laboratorëve të informatikës, përdorimin e pajisjeve interaktive, si dhe në mirëmbajtjen, përditësimin dhe instalimin e programeve kompjuterike.</p> <p>Evidenca: <u>RVB – Aneks Tabelat Permbledhese</u> https://feut.edu.al/fakulteti/organigrama</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se cdo program studimi në Fakultetin e Ekonomisë ka një koordinatör të caktuar me vendim të Dekanit, mbi bazën e propozimit të bërë nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, kjo detyrë mbulohet nga Përgjegjësi i Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. Detyrat e koordinatorit janë të përcaktuara në Nenin 7, të Rregullores së programit të studimit dhe lidhen me ndjekjen e zhvillimit të programit në tërësi, koordinimin me strukturat përgjegjëse të fakultetit dhe departamentit, sigurimin e përditësimit të planit mësimor dhe syllabus-eve në fillim të çdo viti akademik, si dhe mbështetjen e studentëve në realizimin e praktikave pranë institucioneve partnere.</p> <p>Evidenca: <u>Evidenca 3.1 – IE Draft Rregullore e Programit të Studimit</u> <u>Evidenca 9.1.1. Bachelor IE Vendim Koordinator Programit</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka përvojë të gjatë në mësimdhënie, kërkim shkencor, dhe është i kualifikuar në qasje me fushën e programit të studimit. - Plotësohen kërkesat ligjore e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, pranë Fakultetit të Ekonomisë. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Universitetit të Tiranës, rregulloren e Programit Bachelor. Informacione të nevojshëm për organizimin, strukturën dhe kurrikulën e programit paraqitet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Versionin fizik</i> nga njësia bazë dhe kryesore dhe depozitohet pranë administratorit të fakultetit dhe koordinatorit të departamentit. Të dhënat janë të detajuara në Rregulloren e Programit, e cila përmban strukturën (neni 9), planin mësimor (neni 14) dhe elementë të tjerë të nevojshëm për funksionimin e tij. Departamenti zotëron gjithashtu “Dosjen e Programit”, e cila përfshin dokumentacionin mbi hapjen e programit, suplementin e diplomës, planet mësimore ndër vite, ndryshimet e miratuara në lëndë, syllabuset, si dhe CV-të e stafit akademik të përfshirë. Programi përmban planin mësimor me informacion të detajuar mbi ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore dhe shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij. - <i>Versionin digjital</i> në faqen e fakultetit (https://feut.edu.al/programe-studimi/bachelor/). Të dhënat mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit janë publike dhe të aksesueshme përmes faqes zyrtare të institucionit. <p>Studentët informohen për përmbajtjen e programit në fillim të studimeve, si dhe në fillim të çdo semestri nga pedagogët përkatës.</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca I. 1. Statuti i UT</i></p>

	<p><u>Evidenca 1.2. Rregullorja e UT</u></p> <p><u>Evidenca 3. Rregullorja e Programit Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullorja e Programit te studimit</u></p> <p><u>Evidenca 2.0. Vendim 4250 Hapje Programit 2003</u></p> <p><u>Evidenca 2.0.1 Projekt Plan Mesimor Dega Informatike Ekonomike</u></p> <p><u>Evidenca 2.1. Vendim Nr1326 Emertimi bachelor 2011</u></p> <p><u>Evidenca 2.2. Vendim 4250 Hapje Programit 2003</u></p> <p><u>Evidenca 2.3. FE Propozim kuotash 2024 2025</u></p> <p><u>Evidenca 2.4. IE Supplement Diplome</u></p> <p><u>Evidenca 2.8. Kodet e Programeve 2018</u></p> <p><u>Evidenca 2.5. Kerkese Dekanit Ndryshim Lendesh 2023</u></p> <p><u>Evidenca 2.6. IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 2.7. DSIZ CV Staf PAE-PAK</u></p>												
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuar në 6 semestra.</p> <p>Zhvillohen gjithsej 31 lëndë të ndara sipas 3 viteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 12 lëndë në vitin e parë; • 10 lëndë në vitin e dytë; • 9 lëndë, praktika dhe diploma në vitin e tretë. <p>Në vitin e tretë është parashikuar edhe Praktika me 4 kredite ECTS dhe Diploma me 6 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.</p> <table border="1" data-bbox="630 1534 1343 1904"> <thead> <tr> <th>Tipi veprimtarise</th> <th>Tipi i Aktivitetit</th> <th>Nr. i ECTS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;">A</td> <td>Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm</td> <td style="text-align: center;">33 ECTS</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">B</td> <td>Aktivitete në disiplinat e formimit të karakterizuar</td> <td style="text-align: center;">96 ECTS</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;">C</td> <td>Aktivitete në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese</td> <td style="text-align: center;">23 ECTS</td> </tr> </tbody> </table>	Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS	A	Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm	33 ECTS	B	Aktivitete në disiplinat e formimit të karakterizuar	96 ECTS	C	Aktivitete në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese	23 ECTS
Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS											
A	Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm	33 ECTS											
B	Aktivitete në disiplinat e formimit të karakterizuar	96 ECTS											
C	Aktivitete në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese	23 ECTS											




	D	Aktivite në disiplina plotësuese	22 ECTS
	E	Përgatitja e tezës së diplomës	6 ECTS
	Totali		180 ECTS

Nga shpërndarja e krediteve sipas tabelës së mësipërme programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike", ka në planin e tij:

- Lëndë bazë (A) – 33 ECTS – 18.33 %;
- Lëndë karakterizuese (B) – 96 ECTS – 53.33 %;
- Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 23 ECTS – 12.78 %;
- Lëndë plotësuese (D) – 22 ECTS – 12.22 %;
- Detyrime përmblylëse (E) – 6 ECTS – 3.33 %.


GVJ konstaton që shpërndarja e krediteve në këtë program studimi është realizuar në përputhje me VKM Nr. 41.

IAL ka parashikuar në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS dhe ndarjen e tyre në aktivitete formuese Leksione, Seminare, (nuk parashikon kredite ECTS/orë mësimore për Ushtrime/labororë) si dhe orët në auditor/jashtë auditorit për çdo lëndë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike rezulton se për programin parashikohen në total 1940 orë në auditor dhe 2560 orë jashtë auditorit.

Evidenca:
Evidenca 2.6. IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025
Evidenca 3.1 IE Draft Rregullore e Programit te Studimit
Aneks – Tabelat Permbledhese

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Universiteti i Tiranës ofron burime të ndryshme për t'i pajisur studentët me informacionet e nevojshme referuar kriterëve të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione jepen në: <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren e programit të studimit; - Rregulloren e Universitetit të Tiranës; - Si edhe në udhëzuesin "UT Të drejtat dhe detyrat e studentit", i cili u ofron informacione të përditësuara për çdo vit akademik në lidhje me pranimin, regjistrimin apo transferimin.
---	---

	<p>Pranimi në programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm, që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM. Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatit Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe RASH, para fillimit të aplikimeve për pranime. Kriteret publikohen në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor, Neni 4, 7, 8, 9</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 - IE Rregullore e Programit të Studimit.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 20.5 - UT Të drejtat dhe detyrat e studentëve.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.1 - UT Kriteret e pranimit 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 8.1.2 - Kuotat e Studenteve 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 8.1.3 - UT Kuotat e Studenteve 2025-2026 VS 13 dt Evidenca 19.03.2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.2.2 - UT FE Links për kriteret e pranimit.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.3 - FE Aplikime-Pranime 2018-2022.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.5 - FE Mbi kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, FEUT, për vitin akademik 2023-2024 -25-26 update.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 19.1 - UT Kuotat e pergjithshme 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 19.2 - Procedure Komisioni Pranimeve 2024-2025.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde, hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit, të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare leksione/seminare, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, <u>GVJ rekomandon:</u></p>





<p>auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në syllabus-et e lëndëve të paraqiten temat javore me orët përkatëse në çdo javë sipas ndarjes në leksione, seminare, laboratore dhe detyra kursi; - Evidentimin në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve/orëve të dedikuara detyrave të kursit/projekteve; - Paraqitjen në syllabus-e dhe në planin mësimor të kodit të lëndëve; <p>Evidenca:</p> <p><u><i>Evidenca 2.6 IE Syllabuse 24-25.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 16.1 - Vendimi-I-KM-Nr.-879-datë-18122019 Elemente e Prog te Studimit</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 16.1.1. -VKM-nr.-41-date-24.1.2018 Per elementet e Programeve te Studimeve</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit për Informatikë Ekonomike nuk ka pësuar ndryshime bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi programi duhet që të kalojë akreditimin e parë dhe më pas mund të propozojë ndryshime. Ndërkohë, në përputhje me “Politikat e Sigurimit të cilësisë” të Universitetit të Tiranës për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të Studimit dhe “Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë” të Universitetit të Tiranës, bëhet një rishikim vjetor i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, i cili përfshin vlerësimin e efektivitetit dhe identifikimin e fushave për përmirësim duke përfshirë modifikimet e kurrikulës.</p> <p>Nga dokumentat e vendosur në dispozicion, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe njëkohësisht në lehtësimin e marrjes gradualisht të mësimin nga studentët, është kërkuar ndryshimi midis semestrave të tre lëndëve në bachelor (Algoritmikë, Strukturë të dhënash, Arkitekturë Kompjuteri) të degës "Informatikë Ekonomike". Gjithashtu nga departamenti janë propozuar disa ndryshime në programin e bachelorit për t'ju përshtatur më shumë tregut të punës për vitet e ardhshme akademike si: futja e Inteligjencës Artificiale apo futja e gjuhës së programimit Python.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u><i>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 1.6 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 1.7 - UT Rregullore për Funkionimin e Komisionit të përhershëm të kurrikulës</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 1.21 - FE Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë</i></u></p>

	<p><u>Evidenca 2.5 - Kerkese Dekanit Ndryshim Lendesh 2023</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25</u></p> <p><u>Evidenca 5.2 DSIZ Mbledhje Departamenti Bachelor Lende Program 18.12.2024</u></p> <p><u>Evidenca 17.2 - UT Strategji-Plan-veprimi-per-sigurimin-e-brendshem-te-cilesise-21-24</u></p>			
Konkluzione	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, <u>GVJ rekomandon:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në syllabus-et e lëndëve të realizohet shpërndarja e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë referuar secilës kategori: leksion, seminar, laborator dhe detyre kursi; - Të shprehen qartë në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve/laboratorëve; - Të paraqiten kodet e lëndëve. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Viti akademik është i organizuar në 6 semestra dhe përmban 180 ECTS.</p> <p>Përgjatë tre viteve të studimit, me anë të lëndëve të cilat zhvillohen, studentët përgatiten që të zbatojnë parimet informatike në fushën e informatikës ekonomike, kërkimit shkencor, por edhe për t’u pajisuar me aftësi për të punuar në grup dhe për të pasur role drejtuesi.</p>

	<p>Në planin mësimor të programit përfshihen lëndë që ofrojnë njohuri teorike dhe praktike në fushën e informatikës dhe ekonomisë si: Arkitekturë Kompjuteri, Programim C++, Strukturë të dhënash, Programim Java, Sisteme Operimi, Makroekonomi, Mikroekonomi, Shkrim akademik, Programim Web, Siguria e Informacionit, Komunikimi i të dhënave dhe rrjetave kompjuterike.</p> <p>Lëndët në planin mësimor të këtij programi studimi e kanë të nevojshme zhvillimin në ambiente laboratorike për aftësimin e studentëve në fushën e informatikës dhe formimin e tyre profesional për tregun e punës. Për realizimin e këtyre aktiviteteve, Fakulteti ofron infrastrukturën e nevojshme laboratorike të pajisur me 250 poste pune.</p> <p>Evidenca: <u>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25</u> <u>Evidenca 2.6 IE Syllabuse 24-25</u> <u>Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 16</u></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënërit.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Detyrimet përmblylëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 6 ECTS. Shpërndarja e lëndëve në semestra duke filluar nga lëndët formuese në vitin e parë, deri te ato bërthamë në vitin e dytë, e më tej në lëndët me zgjedhje bëhet sipas një rrjedhe logjike të programit përputhur me rezultatet e të nxënërit të secilës lëndë, në përputhje me rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Informatikë Ekonomike”. Nisur nga të dhënat e planit mësimor, GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve/moduleve në semestral është në përputhje me aktet ligjore në fuqi (VKM Nr. 41) dhe mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të kërkimit shkencor.</p> <p>Evidenca: <u>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25</u> <u>RVB, Tabelat përmbledhëse</u></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit “Informatikë Ekonomike” ka një fokus të madh në aftësitë praktike, duke ofruar një raport të mirë të teorisë dhe praktikës me qëllim ofrimin e një shpërndarjeje të balancuar ndërmjet lëndëve të profilit të profilit ekonomik dhe atyre të profilit informatik, i hartuar në përputhje të plotë me parimet e kartës së Bolonjës dhe Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve.</p>

	<p>Programi është hartuar në përputhje edhe me programe të tjera studimi të suksesshme të informatikës ekonomike duke u konsultuar me kurrikula të programeve Bachelor në Informatikë Ekonomike të universiteteve ndërkombëtare si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universitat Mannheim LMU Munich, në Gjermani; - Athens University of Economics and Bussiness, në Greqi; - University of Twente, në Hollandë, - Norwegian University of Science and Technology në Norvegji etj. <p>Evidenca: <i>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Universiteti i Tiranës duke ofruar një kurrikul të pasur moderne me fokus në pjesët teorike dhe praktike, nxit një shkallë të lartë të punësimit, sidomos në studentët e viteve të treta. Studentët e degës “Informatikë Ekonomike” duke u pajisur me aftësi të fushës ekonomike dhe informatike, bëhen të aftë në ndjekjen e studimeve të niveleve më të larta jo vetëm në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por edhe në universitete ndërkombëtare. Përafrimi i programit me modelet kombëtare dhe ndërkombëtare mundëson transferimin e studentëve dhe mobilitetet e studentëve përmes programeve Erasmus +.</p> <p>Mobilitetet studentore në kuadër të Erasmus+ janë kryer me Universitetin Linnaeus në Suedi, në Universitetin Westminster në Mbretërinë e Bashkuar, Universitetin e Graz në Austri, Universiteti Huelvas në Spanjë, Universitetin West Attica në Greqi etj.</p> <p>GVJ nga vizita nga dokumentat e vendosura në dispozicion si edhe nga vizita në Institucion; takimi me stafin akademik dhe takimi me studentet, konstaton se institucioni nxit pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete. Gjithashtu GVJ vlerëson faktin e ecurisë së punësimit të studentëve të këtij programi studimi. Sipas raportit të rezultateve mbi punësimin për studentët ALUMNI, organizuar nga DSIZ, për studentët e diplomuar 15 vitet e fundit, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë vijimit të studimeve të degës Informatikë Ekonomike, një pjesë e mirë e studentëve kanë qenë të punësuar me kohë të plotë ose part-time. Kjo i ka ndihmuar ata të zhvillojnë edhe më tepër aftësitë e tyre praktike e profesionale; - Pas përfundimit të studimeve Bachelor, 38% e tyre vijuan studimet në ciklin e dytë të studimeve. Sipas




	<p>analizave të pyetësorit 68% e studentëve kanë qenë të punësuar në profili gjatë kohës së studimeve, ku 56% ishin të angazhuar me kohë të plotë dhe 12% me kohë të pjesshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - 65% e studentëve të diplomuar në degën Informatikë Ekonomike janë aktualisht të punësuar dhe 76% e tyre punojnë full time në fusha të lidhura me profilin e tyre, 6% punojnë part time, dhe pjesa tjetër punon jashtë profilit. - 87% e studentëve janë aktivë në sektorin privat, përfshirë kompani IT, banka dhe biznese të tjera në pozicione si: Data Scientist & Process Mining Kompjuterike Warehouse Engineer, Software Developer, Mirëmbajtje e Sistemeve punësimin e tyre etj. <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plani Mesimor 22-23-24-25</u></p> <p><u>Evidenca 1.2. Rregullorja e UT, neni 66</u></p> <p><u>Evidenca 12.5 - DSIZ Pyetesor mbi Përfshirjen në Tregun e Punës IE</u></p> <p><u>Evidenca 17.5 - DSIZ ALUMNI Raport mbi Punesimin - Pyetesori i FE</u></p> <p><u>Evidenca 3 – FE Rregullore e Programit Bachelor, neni 35</u></p> <p><u>Evidenca 20.4 – Studentet Bursa Nderkombetare</u></p> <p><u>Evidenca 17.5 - DSIZ ALUMNI Raport mbi Punesimin - Pyetesori i FE</u></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit duke kryer mbledhje të departamentit me fokus rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara nga ana e përmbajtjes, metodologjisë, dhe literaturës ndihmëse të 5 viteve të fundit, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Programi i lëndës firmoset dhe dorëzohet pranë koordinorit të departamentit. Ofrimi i programit realizohet në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe një pjesë e konsiderueshme e literaturave ofrohen në gjuhën angleze. Literatura mund të aksesohet fizikisht në bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.6 – IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p>

	<p><u>Evidenca 5.2 – DSIZ Mbledhje Departamenti Bachelor Lende Program 18.12.2024</u></p> <p><u>Evidenca 12.6 FE Alumni Pyetesor</u></p> <p><u>Evidenca 17.5 – DSIZ ALUMNI Raport mbi Punesimin – Pyetesori i FE</u></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave, për t’u punësuar në fushën e ekonomisë dhe informatikës, vendas dhe të huaj, në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë <i>Master Profesional</i> dhe <i>Master i Shkencave</i> në përputhje me profilin e studimit.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 – IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Aneks Tabelat Permbledhese</u></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, është në marrëdhënie të vazhdueshme me industrinë, për të përputhur programin e studimit me nevojën e tregut të punës.</p> <p>Programi i studimit ofron lëndë si ‘Shkrim Akademik’, e cila ndihmon studentët të përfitojnë njohuri të thelluara për të kryer kërkim shkencor e për të ndjekur ciklin tjetër të studimeve. Njohja e studentëve me lëndë me orientim profesional si: Arkitekturë Kompjuteri, Programim në C++, Programim në Web, Algoritmikë, Sistemet e Shfrytëzimit, Komunikim të dhënash dhe rrjeta kompjuterike, Sigura e informacionit, Kontabilitet financiar, Marketing, Menaxhim, Makroekonomi, Mikroekonomi, Ekonometri, si dhe praktika profesionale e deyrueshme lehtëson procesin e integritit të studentëve në tregun e punës.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 – IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Aneks Tabelat Permbledhese</u></p> <p><u>Evidenca 3 – FE Rregullore e Programit Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 – IE Rregullore e Programit të studimit</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturën</i></p>

	<i>bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave.</i>			
	<i>GVJ konstaton se institucioni nxit pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, bëhen analiza në nivel fakulteti dhe departamenti për ecurinë e programeve të studimit, duke marrë në konsideratë mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe studentëve. Misioni i këtij formimi është të sigurojë që programet e studimit përmbushin kërkesat e sektorit privat e të përditësojë kurrikulat në mënyrë të tillë që t'u ofrojë studentëve aftësitë e nevojshme për të qenë të aftë në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të programit i përcaktuar realizohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i programit të studimit nga studentët e alumni; - Vlerësimi i cilësisë së programit nga studentët e diplomuar që realizohet pasdiplomimit dhe studimi në lidhje me punësimin e tyre; - Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga ekspertë të jashtëm ose bashkëpunëtorë të fushës. <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 12.5 - DSIZ Pyetesor mbi Përfshirjen në Tregun e Punës IE</u></p> <p><u>Evidenca 12.6 - FE Alumni Pyetesor</u></p> <p><u>Evidenca 17.5 - DSIZ ALUMNI Raport mbi Punesimin - Pyetesori i FE</u></p> <p><u>Evidenca 20.3 - Studentet Këshillim i Karrierës - Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës</u></p> <p><u>Evidenca 20.11 - FE Panairi Punës 2022-2023-2024-2025</u></p>

	<p><u>Evidenca 20.12.1 - FE Formular Vleresimi Kompanite</u></p> <p><u>Evidenca 20.12.2 - FE Formular Vleresimi Studentet</u></p> <p><u>Evidenca 20.13 - FE Workshop</u></p> <p><u>Evidenca 20.14 - DSIZ Workshops</u></p> <p><u>Evidenca 22.1 - Marreveshjet NderInstitucionale Mars 2025</u></p> <p><u>Evidenca 22.2 - Lista Marreveshjeve Institucionale Praktikant 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 22.3 - Lista Marreveshjeve Institucionale Praktikant 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 22.4 - FE - Links web Marreveshjet e bashkepunimit</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Pranë Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit të studimit kryhen në disa drejtime nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përfshirjes në senatin akademik, organin më të lartë vendimmarrës, të kryetarit të këshillit studentor; 2. Përfshirjes në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës, komision; 3. Përfshirjes në Komisionin e përhershëm të Kurrikulës; 4. Përfshirjes në Këshillin e Etikës; 5. Sondazhit të vlerësimit të pedagogëve të lëndës; 6. Takimeve me studentet e diplomuar të cilët ndajnë eksperiencën profesionale në tregun e punës dhe shprehin sugjerimet për përditësime apo përmirësime që mund t'i bëhen kurrikulës për t'iu përshtatur tregut të punës. <p>Universiteti i Tiranës përfshin studentët në kërkimin shkencor duke i nxitur ata të marrin pjesë në konferenca, workshope, botime akademike e revista shkencore. Nga takimi i GVJ i zhvilluar me studentët u konstatua një përfshirje dhe interes i tyre në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, duke qenë se një pjesë e tyre ishin të punësuar (kryesisht studentët e vitit të tretë), ose ishin punësuar pas zhvillimit të praktikave mësimore nga Institucione, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushat e informatikës si programimi, rrjete kompjuterike, siguria e rrjeteve kompjuterike, menaxhim bazash të dhënash, “machine learning” apo menaxhim biznesi. Gjithashtu, njësisia bazë realizon takime të ndryshme në formën e diskutimeve me studentët e diplomuar, për të marrë propozime nga këndvështrimi i tyre, tashmë si të punësuar.</p>





	<p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 1.1 Statuti i UT</u></p> <p><u>Evidenca 20.5 UT Te drejtat dhe Detyrat e studenteve</u></p> <p><u>Evidenca 20 Rregullore per zgjedhjet e keshillave te studenteve ne UT</u></p> <p><u>Evidenca 20.6 UT Rregullore per zgjedhjen e keshillave te studenteve</u></p> <p><u>Evidenca 17.6.1 – IE Raporti NJSBC Pyetesorit te Studenteve 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 17.6 Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri I</u></p> <p><u>Evidenca 12.6 FE Alumni Pyetesor</u></p> <p><u>Evidenca 17.5 DSIZ ALUMNI Raport mbi Punesimin – Pyetesor FE</u></p> <p><u>Evidenca 17.3 FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti</u></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, ka autonomi organizative për t’u angazhuar vazhdimisht në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar mundësi për krijimin e rrjeteve dhe nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU) me institucione publike/jopublike, institucione të arsimit të lartë kombëtare/ndërkombëtare apo organizata të ndryshme.</p> <p>Ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm në kuadër të hartimit të programit të studimit, duke sjellë një kurrikul, e cila plotëson nevojat e tregut nga pikëpamja e përmbajtjes dhe e zbatimit të tij. Nga takimet e zhvilluara në institucion u konstatua që ky bashkëpunim është i vazhdueshëm nga ana e institucionit gjë që garanton ruajtjen e cilësisë së programit të studimit dhe lidhjen e ngushtë të tij me tregun e punës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 22.1 Marreveshjet Nderinstitucionale mars 2025</u></p> <p><u>Evidenca 22.2 Lista e Marreveshjeve Institucionale Praktikat 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 22.3 Lista e Marreveshjeve Institucionale Praktikat 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 22.4 Links Web Marreveshjet Nderinstitucionale mars 2025</u></p> <p><u>Aneks Tabelat Permbledhese</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 – IE Plane Mesimore Syllabuse 2024 -2025</u></p> <p><u>Evidenca 5.2 DSIZ Mbledhje Departamenti Bachelor Lende Program 18.12.2024</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ nga vizita në Institucion dhe nga dokumentat e vendosura në dispozicion konstaton se institucioni merr në</i></p>

	<p><i>konsideratë mendimin e studentëve dhe të bashkëpunëtorëve të tij për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Mekanizmat që përdor në këtë drejtim janë: (1) mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar; (2) përfshirja e studentëve në organet më të larta vendimmarrëse si: Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët; Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë; Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Këshillit të Etikës dhe Senatit Akademik; (3) takimet dhe marrja e “feedback-ut” nga partnerë e bashkëpunëtorë në tregun e punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Universiteti i Tiranës si pjesë e misionit të tij, ka krijimin, zhvillimin dhe transmetimin e njohurive përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atij të aplikuar, si dhe inovacionit.</p> <p>Në një sërë dokumentash që i janë paraqitur GVJ, si “Statuti i Universitetit të Tiranës”, “Plani Strategjik i Departamentit DSIZ 2025-2030”, “Manual i Sigurimit të Cilësisë”, “Strategjia Institucionale për Mësimdhënien 2022-2027”, “Rregullore e programit të studimit”, “Vlerësimi performancës së personelit akademik”, paraqiten prioritete të tilla si: Inovacioni dhe kreativiteti i burimeve njerëzore; promovimi i zhvillimit intelektual dhe përqafimin e risive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe statistikës së aplikuar; rritja e mbështetjes për</p>




	<p>ekselencë në mësimdhënie, kërkim, zhvillim kurrikular dhe bashkëpunim institucional etj.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të orëve të hapura, të planifikuara nga departamenti, aktorë të ndryshëm nga industria apo universitetet partnere ndërkombëtare ftohen dhe ndajnë me studentët ekspertizat e tyre. Ngarkesa në auditor e studentëve është e organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione (975 orë); - Seminare (273 orë); - Ushtrime/laboratorë (552 orë); - Projekte/Detyra (n/a); - Praktika (80 orë); - Diploma (60 orë); - Totali 1940 orë; <p>Metodologjitë e mësimdhënies së përdorura në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, përshkruhen në Planprogramin e lëndëve, në “Kurrikulën e programit të studimit të programit”, ku përfshihen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione në auditor; - Seminare; - Ushtrime/laboratorë të cilat mund të organizohen në auditor apo laborator; - Prezantime në baza javore për lëndët për lëndët e bazës së projektit; - Detyra javore; - Leksionet të hapura. <p>Format e mësimdhënies i prezantohen studenti nga pedagogu i lëndës për secilën lëndë në fillim të semestrit.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 Statuti i UT</u></p> <p><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 - IE Rregullore e Programit të Studimit</u></p> <p><u>Evidenca 5 - Plani strategjik i departamentit DSIZ 2025-2030</u></p> <p><u>Evidenca 8.1 - UT Manual Vleresimit Personelit vendimi-nr30-1</u></p> <p><u>Evidenca 8.5 - UT Vendim Senati Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në UT 23-28</u></p> <p><u>Evidenca 8.7 - Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë</u></p> <p><u>Evidenca 11.2 – UT Vendim Strategji Institucionale Mesimdhënie -- nr.24</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p>
--	---

	<p><u>Evidenca 11.5.1 - UT Sherbimet online</u></p> <p><u>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student</u></p> <p><u>Evidenca 11.11 - UT Manual per Pedagog e-Student</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.0 – Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udheheqës Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.1 – Formular Raporti Përfundimtar Praktika Mësimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.2 – Formular Vlerësimi i Studentit per Praktiken Mesimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.3 – Formular Miratimi i Praktikes Mesimore</u></p> <p><u>RVB Bsc ne Informatike Ekonomike.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Mësimdhënia në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Informatikë Ekonomike” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale, e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional. Programi i përgjigjet nevojës së tregut të punës për specialistë në fushën e informatikës ekonomike, zhvillues programesh, mirëmbajtës rrjeti, siguria në rrjetet kompjuterike, zhvillues faqesh web, manaxhimin e sistemeve të informacionit apo informatikës për biznesin.</p> <p>Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve. Departamenti i Statistikës së Zbatuar dhe Informatikës gjatë gjithë vitit akademik bën konsulta të vazhduara të pedagogëve me studentët për plotësimin e nevojave të tyre. Studentët gjithashtu mund të kontaktojnë koordinatoren e tyre akademik për të vepruar si ndërmjetës në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kuadrin e mësimdhënies. Disa nga format kryesore të mësimdhënies që Universiteti i Tiranës përdor janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <u>Puna në grup.</u> Stafii akademik i organizon seminarët, orët e laboratorit apo praktike në punë në grup në mënyrë që të rrisë te studentët aftësitë e bashkëpunimit dhe negocimit, shkëmbimit të eksperiencave, ndarjes së detyrave; <u>Prezantime/ekspozime publike.</u> Secilës lëndë i caktohet si kriter vlerësues edhe një detyrave e cila duhet të mbrohet me prezantim, e cila synon të përmirësojë dhe rrisë cilësinë e teknikave të prezantimit të studentit, për ta bërë atë më konkurrues në tregun e punës; <u>Leksione të hapura.</u> DSIZ vazhdimisht organizon leksione të hapura në të cilat kryen prezantime studimesh, kërkimesh




	<p>apo projektesh e që më pas ndiqen nga një sesion pyetjesh dhe diskutimi nga pjesëmarrësit në aktivitet.</p> <p>d. <u>Study Visit</u>. Format e mesimdhënies në auditor integrohen me ato jashtë auditorit, në kompanitë partnere të fushës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.6.1 IE Plani Mesimor 22-23-24-25 ENG</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 Statuti i UT, Neni 78</u></p> <p><u>Evidenca 3 FE Rregullore e Programit Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te Studimit</u></p> <p><u>Evidenca 1.10 UT Strategjia Institucionale per Mesimdhënien 2022-2027</u></p> <p><u>Evidenca 8.7 Trajnimet ne FEUT per metodat e reja te mesimdhënies</u></p> <p><u>Evidenca 9.1 Mbledhje Departamentit – Mbiqyresit e Programeve, 10.9.2024</u></p> <p><u>Evidenca 11.5.1 UT Shërbimet online</u></p> <p><u>Evidenca 12.5 DSIZ Pyetesor mbi perfshirjen ne tregun e punes</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, dhe në mënyrë të veçantë Departamenti i Statistikës së Zbatuar dhe Informatikës, mbështetin personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamentit. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) i kanë shërbyer përmirësimin të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike.</p> <p>Institucioni ndjek politika të tilla, që ofron trajnime të ndryshme apo leksione të hapura për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mësimdhënies. Stafin akademik inkurajohet duke u mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo publikime në revista, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur interesin e tyre në kërkimin shkencor. Për përmirësimin e zhvillimit të procesit mesimor, Departamenti i Statistikës Së Zbatuar dhe Informatikës ofron infrastrukturë të konsoliduar IT për Shërbimet Mësimore duke përmendur (1) Sistemin e-Student; (2) Rrjetin; (3) Shërbimet Google; (4) Mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimet e programit etj. Nga vizita në institucion dhe nga takimi me stafin akademik PAE/PAK, GVJ konstatoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Stafi akademik mbështetet duke mos paguar “fee-në” e publikimit në revistë apo pjesëmarrjes në Konferencë në ato revista apo konferenca në të cilat Departamenti i


	<p>Statistikës së Zbatuar dhe Informatikës organizon apo është partner.”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni ofron një procedurë për mbështetje financiare vjetore në lidhje me kërkimin shkencor në revista me faktor impakti të indeksura apo revista ndërkombëtare të cilat do të rrisin cilësinë e kërkimit shkencor deri në 500 Euro/vit për personelin akademik me kohë të plotë që prezanton kërkimin në një konferencë ndërkombëtare në vendet e BE-së. <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të rrisë fondet e dedikuara për mbështetjen e aktivitetit kërkimor-shkencor të stafit akademik dhe njëkohësisht, të hartojë e zbatojë një procedurë të standardizuar të mbështetjes financiare, e orientuar drejt fuqizimit të publikimeve në revista të indeksuara (SCOPUS, Web of Science), pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe rritjes së performancës kërkimore-shkencore të institucionit.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.10 Strategjia Institucionale per mesimdhënie 2022-2027</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 3.1 Rregullore e Programit te studimit</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 5.2 DSIZ Mbledhje Departamenti Bachelor Lende Proqram 18.12.2024</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 8.1 UT Manual per Vleresimin e Performances se Personelit Akademik</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 8.2 Vendimi per grantet ne Konferenca Shkencore</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 8.5 Plani Strategjik per Zhvillimin Profesional te Personelit ne UT 2023-2028</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 8.7 Trajnimet ne FEUT per metodat e reja te mesimdhënie</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 10.4.1 Mobilitete Outgoing Staf Akademik FE 2021-2025</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 10.4.2 Mobilitete Incoming Staf FE</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11 UT Paketa e Instrumentave te cilesise</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.5.1 UT Sherbimet online</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.8 UT Upgrade i aplikimit software e-Student</u></i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mesimdhënie interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te</p>	<p>Në programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Informatikë Ekonomike” është i angazhuar në mesimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mesimdhënës në Universitetin e Tiranës. Tërheqja dhe rekrutimit të stafit të kualifikuar akademik, si një ndër objektivat strategjike të Universitetit të Tiranës realizohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në përputhje me synimet dhe standardet e përcaktuara në Planin Strategjik të Institucionit;

<p>student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes Rregullores së Punësimit; - Nëpërmjet një procesi vlerësimi dhe verifikimi nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit. <p>Aplikanti për staf akademik vlerësohet për kompetencat e tij përmes plotësimit të një “Formularin e Vlerësimi” ku analizohen rezultatet shkencore, metodologjia e prezantuar, aftësitë komunikuese, arritjet e kandidatit në ekspertizën e tij/saj të mësimdhënies dhe entuziazmin e kandidatit/es. Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik.</p> <p>Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve. Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik. Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve. Referuar komunikimit pedagog-student:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lektorët këshillojnë, orientojnë dhe mbështesin studentët gjatë gjithë procesit të mësimdhënies si dhe përgatitjes për diplomimin përmes konsultimeve individuale/grup; - Këshilltari akademik ndjek nga afër procesin e mësimnxënies së studentëve; - Guida e stafit jep udhëzimet/direktivat për të siguruar një marrëdhënie sa më të shëndoshë dhe etike ndërmjet lektorit dhe studentit. <p>Evidenca:</p> <p><i><u>Evidenca 7.4 - Procedura rekrutimi tip (DSIZ)</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 8.1 – UT Manual Vleresimit Personelit Vendimi nr 30.1</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 12.1 – UT Vendimi nr 30.1 Manual Vleresimit Personelit Akademik</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.7 – CV DSIZ PAE</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.7.1 – CV DSIZ PAK</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.2 – UT Vendim Strategji Institucionale Mesimdhënie nr. 24</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 3.1. Rregullore e Programit te studimit</u></i></p>
---	--

	<p><u>Evidenca 7.2 Model kontrate per Personelin Akademik me Kohe te plote</u></p> <p><u>Evidenca 7.2 Model kontrate per Personelin Akademik me Kohe te plote</u></p> <p><u>Evidenca 13.3 Formular Vleresimi Teme Diplome per Ciklin e pare Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.0 Formular Vleresimi Studenti Praktikant Pedagogu udheheqes Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.1 Formular raporti perfundimtar Praktika Mesimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.2 Formular raporti perfundimtar Praktika Mesimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.3 Formular miratimi Praktika Mesimore</u></p> <p><u>RVB Aneks Tableat Permbledhese, Tabla 2</u></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatores të programit të studimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes mbledhjes së opinioneve nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe njësia bazë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët; - Vlerësimi nga drejtuesit; - Vetëvlerësimit të pedagogëve. <p>Varësisht rezultateve të pyetësorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i Departamentit përgatit një Raport të detajuar dhe Plan Veprimi, i cili i përcillet Zyrës së Rektoratit dhe NJSBC-së; - NJSBC-ja u vendos në dispozicion rezultatet: Njësia Kryesore, Rektoratit dhe Zyrës së burimeve njerëzore; - Përgjegjësi zhvillon takime individuale me pedagogët vlerësimi i të cilëve është nën mesatare apo që kanë komente shqetësuese nga studentët; - Organizohen trajnime dhe seminare të ndryshme në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies. <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te Studimit</u></p> <p><u>Evidenca 8.1 UT Manuali per Vleresimin e Performances se Personelit Akademik</u></p> <p><u>Evidenca 12.5 Pyetesor mbi pervojen mesimore dhe perfshirjen e studetneve</u></p>

	<p><u>Evidenca 13.4.1 Formular i Raportit Perfundimtar te Praktikës Mesimore</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.2 Formular i Vleresimit te Studimit per Praktikën Mesimore</u></p> <p><u>Evidenca 12.2 UT Plani i Veprimit te Sigurimit te Cilesise 2024-2028</u></p> <p><u>Evidenca 5.2 Mbledhje Departamenti Statistike dhe Informatike e Zbatuar Bachelor 18.12.2024</u></p> <p><u>Evidenca 11.4 UT Rregullore per organizimin dhe funksionimin e NJSBC</u></p> <p><u>Evidenca 12.1 UT Vendimi nr.30-1 Manual i Vleresimit te Performances se Personelit Akademik</u></p> <p><u>Evidenca 17.1 Raport NJSBC 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 17.2. UT Strategji Plan Verprimi per Sigurimin e brendshem te cilesise</u></p> <p><u>Evidenca 17.3 FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti</u></p> <p><u>Evidenca 17.4 FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti</u></p> <p><u>Evidenca 17.6 Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri I</u></p> <p><u>Evidenca 17.6.1 IE Raporti NJSBC Pyetesorit te Studenteve 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 17.6 Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri I</u></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në Universitetin e Tiranës funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Standardet e sigurimit të cilësisë hartohen në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë miratuar me vendim të KM-së; Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren “Për Sigurimin e Cilësisë në UT”, Manualin e Cilësisë, si dhe paketës së Instrumentave të Cilësisë, miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, me Vendim nr. 51, datë 23.12.2020.</p> <p>Në nivel rektorati, kjo njësi e cila është e përbërë nga 9 anëtarë, të cilët janë personel akademik me kohë të plotë, përfaqësues i përzgjedhur nga secili fakultet, 1 anëtar i jashtëm, ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë i caktuar me vendim të Rektorit, si dhe 1 anëtar student i caktuar nga Këshilli Studentor i UT-së.</p> <p>Në njësitë kryesore, NJSBC përbëhet nga 1 përfaqësues i përzgjedhur nga personeli akademik respektiv me kohë të plotë i çdo njësie bazë, 1 personel ndihmës akademik, i cili emërohet nga Dekanati si dhe një anëtar student, i përzgjedhur nga Këshilli Studentor i fakultetit. Në njësitë bazë, NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 anëtarë janë personel akademik me kohë të plotë në këtë njësi, 1 personel ndihmës akademik, i cili propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet me</p>


	<p>vendim të njësisë bazë, si dhe një anëtar student nga studentët e degës përkatëse.</p> <p>Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësim dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik. NJSBC kryen procesin e vlerësimit të stafit akademik, stafit administrativ, vlerësimit të infrastrukturës dhe logjistikës përmes pyetësorëve drejtuar studentëve, formularëve të vlerësimit dhe vetëvlerësimit. Ky proces kryhet në nivel horizontal dhe vertikal. Departamenti harton një raport vlerësimi për stafin akademik, të cilin ia përcjell Dekanit. Me tej Dekani informon stafin akademik dhe administrativ për rezultatet. NJSBC në fillim të çdo viti akademik realizon Kalendarin e Ngjarjeve dhe Aktivitetëve për të kryer trajnime të rregullta për zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës, nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të metodave të reja dhe inovative në mësimdhënie si dhe eksperimentimin në këtë fushë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Evidenca 1.10 Strategjia Institucionale për Mesimdhënien 2022-2027</i></p> <p><i>Evidenca 11.3. UT Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e KPS Sigurisë së Cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca 11.4. UT Rregullore për Organizimin dhe Funkcionimin e NJSBC</i></p> <p><i>Evidenca 12.2 UT Plani i Veprimit të Sigurimit të Cilësisë 2024-2028</i></p> <p><i>Evidenca 12.5 Pyetësor mi përvojën mesimore dhe përfshirjen e studentëve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Tiranës kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i></p>




	<i>GVJ rekomandon që institucioni të rrisë fondet e dedikuara për mbështetjen e aktivitetit kërkimor-shkencor të stafit akademik dhe njëkohësisht, të hartojë e zbatojë një procedurë të standardizuar të mbështetjes financiare, e orientuar drejt fuqizimit të publikimeve në revista të indeksuara (SCOPUS, Web of Science), pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe rritjes së performancës kërkimore-shkencore të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Format e kontrollit të dijeve në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar janë: provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar me seminare workshope, frekuentime e studime laboratorike. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit studentët informohen mbi politikat, proceset dhe mekanizmat që drejtojnë studimet e tyre. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimin. Në rregulloren programit <i>Bachelor</i> në Informatikë Ekonomike, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Rregulloren e Universitetit të Tiranës, dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes. Gjithashtu, në auditore dhe përmes sistemit <i>e-Student</i>, studentët informohen për kalendarin e provimeve, rregullat e zhvillimit të tyre dhe mundësitë për ankim dhe rishikim note.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit, Neni 16</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, Neni 57</u></p> <p><u>Evidenca 3 FE, Rregullore e Programit Bachelor, Neni 24</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 11.10 UT Manual Sistemi e-Student</u></p> <p><u>Evidenca 11.11 UT Manual Pedagog e-Student</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Syllabuse 24-25</u></p> <p><u>Evidenca 11.4 UT Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</u></p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Pedagogu i lëndës ditën e parë të fillimit të lëndës, informon studentët në lidhje me syllabusin e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit. Informimi i studentëve me mënyrat e vlerësimit realizohet gjithashtu në klasat virtuale respektive të secilës lëndë, të krijuara në Microsoft Teams.</p> <p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, tezat hartohen nga titullari i lëndës së bashku me pedagogun që e ka zhvilluar lëndën. Pas përfundimit të një procesi testimi dhe vlerësimi, bëhet shpallja e vlerësimit përfundimtar nga pedagogu i lëndës shoqëruar me firmën e tij. Bazuar në Rregulloren e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, studenti ka të drejtën e ankimimit të notës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit, Neni 16</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, Neni 57, Neni 58, Neni 59</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 Statuti i UT, Neni 78</u></p> <p><u>Evidenca 3 Rregullore e Programit Bachelor, Neni 31</u></p> <p><u>Evidenca 11.5.1 UT Sherbimet online</u></p> <p><u>Evidenca 1.4 Kodi i Etikes i UT, neni 6</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Rregulloren e Programit të studimit dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes. Secili syllabus përmban informacion si:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Emri dhe kategoria e lëndës; – Pozicioni i lëndës në afatin dyvjeçar (vit+semestër); – ECTS të lëndës dhe vlerat e krediteve; – Kategoria e lëndës (A, B, C, D apo E); – Përcaktimin nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje; <p>Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Testimet e ndërmjetme (10-20%) • Labororet e Detyrat e kursit (10-20%) • Frekuentimi e aktivizimit (0-10%) • Provimi përfundimtar (70-80 %) <p>Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm. Në total studenti/ja mund</p>




të përfitojë 100 pikë. Sistemi i vlerësimit në Universitetin e Tiranës bëhet me sistemin me 10 nota. Për çdo vlerësim me notën nga 4 (katër) e poshtë, studenti shpallet jokalues dhe është i detyruar ta përsërisë lëndën. Për çdo vlerësim me notën nga 5 (pesë) e sipër, studenti shpallet kalues. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:

Nota	Pikët
10	91-100
9	81-90
8	71-80
7	61-70
6	51-60
5	41-50
4	31-40
3	21-30
2	11-20
1	1-10
0	0

GVJ konstaton që pavarësisht se sipas rregullores studenti ka të drejtën e ankimit të notës, institucioni nuk ka paraqitur një procedurë në lidhje me ankimin e notës.

Planprogramet e secilës lëndë publikohen gjithashtu në faqen e Internetit të Fakultetit të Ekonomisë (<https://feut.edu.al/programe-studimi/bachelor/bachelor-ne-informatike-ekonomike>).

Gjithashtu studentëve u vjen në ndihmë e-Student, përmes së cilës studentët përditësohen mbi pikët e marra në vlerësim, mungesat dhe përmbajtjet e lëndëve të zhvilluara.

Evidenca:

Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit, Neni 16

RVB, Tableat përmbledhese

Evidenca 1.3 Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë

Evidenca 2.6 Plani Mesimor 22-23-24-25

Evidenca 11.5.1 UT Sherbime online

<https://feut.edu.al/programe-studimi/bachelor/bachelor-ne-informatike-ekonomike>


<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor, të cilët hartohen në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u><i>Evidenca 5.2 Mbledhje Departamenti Statistike dhe Informatike e Zbatuar – 18.12.2024 në Informatikë Ekonomike Signed.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 8.7 Trajnimet per perrmiresimin e metodave te mesimdhënies ne FEUT</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 12.2 UT Plani i Verprimit të Sigurimit të Cilësisë 2024–2028</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 12.5 Pyetesor mbi pervojen mesimore dhe perfshirjen e studenteve</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 17.3 FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 17.4 FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 17.6.1 IE Raporti i NJSBC Pyetesorit te Stududenteve 2024-2025</i></u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar vendos në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme teknologjike për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim realizimin e objektivave formues të studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës. Përfshirja e studentëve, nën mbikqyrjen e pedagogëve të lëndëve, në rindërtimin e situatave reale në laborator përmes pajisjeve laboratorike në dispozicion, i aftëson në profesion dhe inkurajon sensin e tyre të autonomisë.</p> <p>Me qëllim promovimin shkencor, përveç trajnimeve të ndryshme të stafit akademik, njësia përgjegjëse angazhohet për të garantuar njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor, duke bashkëpunuar me institucione të tjera në organizimin konferencave për të nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u><i>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 12.2 UT Plani i Veprimit te Sigurimit te Cilesise 2024-2028</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 12.3 FE Aktiviteti i NJSC Material Permbledhes 2022-2025</i></u></p>




Konkluzione	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimin të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p> <p><i>Nëpërmjet sistemit 'e-Student', studentët informohen për kalendarin e provimeve, rregullat e zhvillimit të tyre dhe mundësitë për ankim dhe rishikim note.</i></p> <p><i>Njësia përgjegjëse angazhohet për të garantuar njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor, duke bashkëpunuar me institucione të tjera në organizimin konferencave për të nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


<p>Standardi III.3</p> <p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet duke u bazuar në më shumë se një komponent, në përputhje me VKM 41 më datë 24.01.2018. Format e vlerësimit parashikohen në: (1) Rregulloren Fakultetit të Ekonomisë për Programet Bachelor; (3) Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është kombinim i vlerësimeve të ndryshme, të specifikuar nga pedagogu i lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • provimi i ndërmjetëm • detyrat e kursit • laboratore • quize/projekte • provimi përfundimtar <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë. Për të siguruar transparencën e procesit në lidhje me periudhën e zhvillimit të provimeve të</p>

	<p>ndërmjetme apo përfundimtare, institucioni bën publik në faqen e tij zyrtare kalendarin akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Memimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 3 FE Rregullore Programit Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te Studimit</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 Plani Mesimor 22-23-24-25</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti i Tiranës vë në zbatim sistemin elektronik <i>e-Student</i>, i cili ofron një hapësirë të dedikuar si për studentët ashtu edhe për pedagogët, ku menaxhohen notat, frekuentimi, regjistrimet në lëndë dhe të dhëna të tjera akademike. Përmes këtij sistemi, të gjitha të dhënat përfundimtare të vlerësimit regjistrohen në mënyrë të sigurt dhe të verifikueshme, duke garantuar integritet dhe transparencë të plotë në programin Bachelor të Informatikës Ekonomike.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë është vënë në zbatim një infrastrukturë e integruar e testimit dhe vlerësimit elektronik, e cila siguron transparencë dhe shmang praktikat abuzive. Një nga instrumentet kryesore është platforma CleanScore, e cila garanton objektivitet në vlerësim dhe minimizon ndikimin e faktorëve subjektivë. Gjithashtu, përmes Microsoft Teams, ku pedagogët krijojnë klasa virtuale, studentët informohen në mënyrë të menjëhershme mbi rezultatet e komponentëve të vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar, duke rritur aksesin e tyre ndaj informacionit dhe duke forcuar transparencën në proces.</p> <p>Provimet kryhen në formatin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Testeve në kopje fizike</u>, ku studentët vendosin një kod të personalizuar, me qëllim që të ruhet anonimiteti dhe të shmangen forma të ndryshme abuzimi; - <u>Testimi elektronik</u> duke përdorur platformën "CleanScore" me qëllim rritjen e transparencës. Secilit student i shfaqen pyetje të ndryshme dhe rezultati u shfaqet në mënyrë automatike duke shmangur forma të ndryshme abuzimi. <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 11.5.1 UT SHerbimet online</u></p> <p><u>Evidenca 11.5.1 UT SHerbimet online</u></p> <p><u>Evidenca 11.10 UT Manual Sitemi e-Student</u></p> <p><u>Evidenca 11.11 UT Manual per pedagog e-Student</u></p> <p><u>Evidenca 11.18 Perdorimi i CleanScore-DSIZ</u></p>




	<i>Evidenca 11.6.4 FE Manual J-score</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Vlerësimi i dijeve realizohet përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndës/modulit. Vlerësimi përfundimtar është kombinim i vlerësimeve të ndryshme, të specifikuara nga pedagogu i lëndës. Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë, të cilat konvertohen në vlerësim me notë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit, Neni 16</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, Neni 57, Neni 58, Neni 59</i></p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UT, Neni 78</i></p> <p><i>Evidenca 3 Rregullore e Programit Bachelor, Neni 31</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</i></p> <p><i>Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Procesi i vlerësimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në planprogramin e lëndës, Rregulloren e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”.</p> <p>Pas kryerjes së provimeve dhe korrigjimeve të tyre, personeli akademik bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Në raste kontestimi, pedagogu i lëndës ofron gatishmërinë për të bërë sqarimet e nevojshme.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 3 Rregullore e Programit Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca 11.4 UT Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i></p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Personeli akademik është përgjegjës për kontrollin dhe shmangien e plagjiaturës dhe kopjeve në provim. Provimet organizohen në salla të mëdha me të paktën dy vëzhgues për të shmangur kopjet. Në përputhje me “Rregulloren e Programit Bachelor në FE”, “Kodin e Etikës së UT”:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës; 2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi;

	<p>3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit;</p> <p>Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës dhe informohet instruktori i kursit dhe Përgjegjësi i Departamentit. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi, i cili vlerësohet me 0 pikë.</p> <p>Për të shmangur plagjiaturën në projektet apo tezat e doktoraturës, institucioni përdor softuerin Turnitin.</p> <p>Megjithatë, GVJ nga dokumentat e vendosura në dispozicion dhe takimi me stafin akademik, konstatoi se Institucioni nuk përdor softuerin Turnitin për të kontrolluar plagjiaturën në tezat e diplomave të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”.</p> <p>Duke marrë parasysh faktin që të gjithë studentët e programit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” i realizojnë detyrimet përmblyëse me tezë diplome, <i>GVJ rekomandon që softueri Turnitin të përdoret për parandalimin e plagjiaturës edhe në ciklin e parë, Bachelor.</i></p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 3 FE Rregullore e Programit Bachelor, Neni 27</i></p> <p><i>Evidenca 1.4 Kodi i Etikes UT</i></p> <p><i>Evidenca 20.5 UT Te drejtat dhe detyrat e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në përputhje me afatet e përcaktuara nga Universiteti i Tiranës, si dhe me dispozitat e Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe të Rregullores së Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, rezultatet e provimeve përfundimtare administrohen dhe publikohen në mënyrë të rregullt dhe të barabartë për të gjithë studentët. Pas zhvillimit të provimit, personeli akademik i lëndës është i detyruar të ngarkojë notat në sistemin elektronik e-Student brenda 10 ditëve të punës. Sekretaria mësimore administrojnë dhe shpërndan këto rezultate, duke garantuar transparencë dhe respektim të afateve për çdo student. Ndërkohë, procesverbalet përfundimtare të provimit depozitohen në sekretarinë mësimore brenda 2 ditëve të punës nga përfundimi i shqyrtimit të kërkesave për sqarime, duke siguruar kështu dokumentimin dhe shpërndarjen në kohë të rezultateve mbi bazën e meritës.</p>




	<p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</i></p> <p><i>Evidenca 3 FE Rregullore Programit Bachelor, neni 30</i></p> <p><i>Evidenca 11.10 UT Manual Sitemi e-Student</i></p> <p><i>Evidenca 11.11 UT Manual per Pedagog e-Student</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Procesi i trajtimit të ankesave për rezultatet e provimeve është i rregulluar me afate të qarta dhe të detajuara, duke garantuar një procedurë të shpejtë dhe transparente. Bazuar në “Rregulloren e Universitetit të Tiranës”, “Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë për Programet Bachelor”, studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit, duke dorëzuar një kërkesë me shkrim për ankimim notash drejtuar drejtuesit të Departamentit të Statistikës së Zbatuar dhe Informatikës.</p> <p>Pas depozitimit të ankimit nga studenti, drejtuesi i njësisë bazë, brenda 24 orëve, njofton pedagogun përgjegjës të lëndës për shqyrtimin e rastit dhe për dhënien e qëndrimit të tij. Qëndrimi i formuluar nga personeli akademik i lëndës i përcillet më pas, sërish brenda 24 orëve, drejtuesit të njësisë kryesore. Ky i fundit, brenda 48 orëve nga marrja e informacionit, ngre një komision ad hoc, i cili ka detyrë të verifikojë pretendimet e studentit. Komisioni zhvillon shqyrtimin dhe brenda tre ditëve pune përcakton nëse ankesa është e bazuar dhe, nëse po, vendos vlerësimin përfundimtar të provimit. Rezultatet e këtij shqyrtimi i përcillen drejtuesit të njësisë kryesore, i cili, brenda 48 orëve, informon përfundimisht njësinë bazë, pedagogun e lëndës dhe studentin ankesues.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, Neni 61, Neni 62</i></p> <p><i>Evidenca 3 FE Rregullore e Programit Bachelor, Neni 31</i></p> <p><i>Evidenca 28 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p> <p><i>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të</i></p>

	<p>ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit.</p> <p>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen nga ana e studentëve.</p> <p>Megjithatë, GVJ nga dokumentat e vendosura në dispozicion dhe takimi me stafin akademik, konstatoi se Institucioni nuk përdor softuerin Turnitin për të kontrolluar plagjiaturën në tezat e diplomave të programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”.</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> që softueri Turnitin të përdoret për parandalimin e plagjiaturës edhe në ciklin e parë, Bachelor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, siç dëshmohet edhe në “Kurrikulat” e lëndës ka për mision:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. T’u ofrojë studentëve mundësinë që të marrin dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e informatikës ekonomike; 2. Të nxisë tek studentët të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të ndryshme të fushës; 3. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e informatikës dhe ekonomisë. <p>Për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentit, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar kujdeset që studenti krahas teorisë, seminareve, projekteve të kryejë edhe praktika profesionale e intershipe në kompanitë e ndryshme në të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Evidenca:</p>

	<p><u>Evidenca 2.0.1 Projekt Plan Mesimor Dega Informatike Ekonomike 2003</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te Studimit, Neni 4</u></p> <p><u>Evidenca 5 Plani strategjik i departamentit DSIZ 2025-2030</u></p> <p><u>Evidenca 12.5 Pyetesor mbi pervojen mesimore dhe perfshirjen e studenteve</u></p> <p><u>Aneks Tabelat Permbledhese</u></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë, komunikimit dhe ndërveprimit social duke qenë se sektori informatik është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Për më tepër, në fushat e (1) <i>shkencave humane</i>, ku planprogrami ofron lëndë si: “Gjuhë e Huaj” “Shkrim Akademik”, “Inovacion/Etikë Biznesi”, “Menaxhim” “Praktika”, të cilat e ndihmojnë studentin në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.0.1 Projekt Plan Mesimor Dega Informatike Ekonomike 2003</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te Studimit, Neni 4</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.1 Formular Raporti Perfundimtar i Praktikes Mesimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.2 Formular Vleresimi i Studentit per Praktiken Mesimore Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.3 Formular Miratimi i Praktikes Mesimore Bachelor</u></p> <p><u>Aneks Tabelat Permbledhese</u></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e</p>	<p>Gjatë orëve të fundit të mësimin, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara, në përputhje kjo edhe me kërkesat e VKM nr. 41 datë 24.01.2018.</p> <p>Direktiva e Universitetit të Tiranës urdhëron çdo fakultet që për çdo program studimi të kryhet anketimi i vlerësimit të lëndës,</p>

<p>tyre dhe për detyrimet përmyblëse.</p>	<p>me qëllim vlerësimin cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e saj.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.0.1 Projekt Plan Mesimor Dega Informatike Ekonomike 2003</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit te Studimit, Neni 6</u></p> <p><u>Evidenca 20.12.2 FE Formular Vleresimi Studentet</u></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën profesionale, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e informatikës ekonomike, sikurse pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve. Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre.</p> <p>Studentët kanë akses në infrastrukturën e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura në Funksionin e Programit të Studimit; - Shërbimet e Bibliotekës së Universitetit; - Aksesin në laboratorët kompjuterikë; - Aksesin në database JSTOR. <p>Universiteti i Tiranës nxit dhe mbështet studentët drejt studimeve të kërkimit shkencor dhe zhvillimit të ideve inovative.</p> <p>Këtu mund të përmendim:</p> <ol style="list-style-type: none"> (1) Pjesëmarrja e studentëve në konferenca studentore si (2) Angazhimi në mobilitetet e studentëve në institucionet partnere në kuadër të programit Erasmus. <p>Nga ana tjetër Praktika, është lëndë e detyrueshme e cila zhvillohet semestrin e tretë. Nëpërmjet bashkëpunimit e marrëveshjeve me institucione qendrore që operojnë në profilin e programit të studimit, institucioni mundëson kryerjen e praktikave profesionale.</p> <p>Bashkëpunimet e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ai brenda vendit kontribuon për rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave.</p>




	<p>GVJ vlerëson kontributin që institucioni jep në kuadër të praktikave profesionale dhe mbështetjen për projekte kërkimore shkencore.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.0.1 Projekt Plan Mësimor Dega Informatikë Ekonomike 2003</u></p> <p><u>Evidenca 2.6 IE Plane Mësimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.0 Formular Vleresimki Studenti Praktikant Pedagogu Udheheqes Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 22.2 Lista e Marrëveshjeve Institucionale Praktikat 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 22.3 Lista e Marrëveshjeve Institucionale Praktikat 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 11.9.1 - FE Foto të sallave të laboratoreve</u></p> <p><u>Evidenca 11.9 - FE Infrastruktura Mjediset</u></p> <p><u>Evidenca 10.4.3 Mobilitete Incoming Student</u></p> <p><u>Evidenca 10.4.4 FE Mobilitete Outgoing Student FEUT</u></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjellë tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave kompjuterike, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Duke konsideruar faktin që një ndër pikat kyçe të MoU që Universiteti i Tiranës ka nënshkruar me partnerët e tij është organizimi i leksioneve të hapura periodikisht dhe seminareve të organizuara nga drejtorët ekzekutivë të këtyre institucioneve, e bën më të lehtë ekspozimin e vazhdueshëm të studentëve në ide e teknologji inovative. Organizimi i këtyre aktiviteteve organizohet në nivel departamenti dhe fakulteti çdo fillim viti akademik.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.6.1 IE Plane Mesimore Syllabuse 2024-2025</u></p> <p><u>Evidenca 21.1 Raporti Vjetor FEUT 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 21.2 Raporti Vjetor FEUT 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 21.1 Raporti Vjetor FEUT 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 21.3.2 DSIZ Raportim vjetor 2022-2023</u> https://feut.edu.al/kerko?searchword=leksion%20hapur&searchphrase=all</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke</i></p>

	<p><i>mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e informatikës dhe ekonomisë.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson kontributin që institucioni jep në kuadër të praktikave profesionale dhe mbështetjen për projekte kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Bashkëpunimet e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Zhvillimi i provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës në programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike” është një proces i mirë organizuar përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullores së Universitetit të Tiranës; - Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë për programet Bachelor - Rregullores së programit të Studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike”; - Rregullores për diplomim në Ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve Master Ekzekutiv <p>Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimeve të ciklit të parë në FEUT bëhet me punim diplome. Të drejtën për të mbrojtur temën e diplomës e kanë të gjithë studentët që janë vlerësuar kalues në të gjithë lëndët dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës Bachelor dhe detyrimet financiare ndaj FEUT. Punimi i diplomimit parashikohet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 1.2 Rregullore e UT, Neni 67-72</u></p> <p><u>Evidenca 3 FE Rregullore e Programit Bachelor, Kreu V Diplomimi, Neni 36-43</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit, Neni 3</u></p>

	<p><i>Evidenca 13 Rregullore per diplomim ne ciklin e pare, te dyte dhe te trete te studimeve "Master Ekzekutiv", ne Universitetin e Tiranës, Neni 3-6</i></p> <p><i>Evidenca 13.1 Projekt Rregullore per diplomimin ne ciklin e pare dhe te dyte te studimeve dhe NJSBC ne Universitetin e Tiranës, Neni 3-6</i></p> <p><i>Evidenca 13.3 Formular Vleresimi Teme Diplome per ciklin e pare Bachelor</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar përcakton listën e temave të diplomave (Projektin e Diplomimit) dhe programet e lëndëve bazë e përgjithshme përfundimtare në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik, në përputhje me Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të parë.</p> <p>Në përgatitjen e temës së diplomës, studenti ka të drejtë të ketë një pedagog drejtues, i cili caktohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që mbulon programin Bachelor që ka zhvilluar ai. Për udhëheqjen e diplomave të ciklit të parë nuk kërkohet që pedagogu udhëheqës të ketë gradë apo titull shkencor.</p> <p>Njësia bazë, në përfundim të semestrit të parë, u bën të njohur studentëve të vitit të fundit të ciklit të parë të studimeve Bachelor temat e diplomave apo fushat e kërkimit që do të përdoren për përgatitjen e diplomave dhe pedagogun udhëheqës. Çdo njësi bazë përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përcaktimin dhe shpërndarjen e temave të diplomave, si dhe për informimin e studentëve. Punimi i Temës së Diplomës për ciklin e parë Bachelor në FEUT hartohet bazuar në udhëzuesin e hartuar nga komisioni ad hoc dhe miratohet nga Dekani. Ky udhëzues bazohet në kërkesat e Statutit, Rregullores të UT dhe Rregullores së Diplomimit të UT.</p> <p>GVJ konstaton se aktualisht mungon një manual i posaçëm për përgatitjen e tezës së diplomës. Për këtë arsye, <i>GVJ rekomandon hartimin e një manuali udhëzues për procesin e përgatitjes së tezës së diplomës dhe vënien e tij në dispozicion të studentëve, duke e publikuar gjithashtu edhe në faqen zyrtare të institucionit.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 3 FE Rregullore Programit Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Evidenca 13 Rregullore për diplomim në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", në Universitetin e Tiranës</i></p>

	<p><u>Evidenca 13.1 Projekt Regullore për diplomimin në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Dhe NJSBC në Universitetin e Tiranës</u></p> <p><u>Evidenca 13.3 Formular Vlerësimi Temë Diplome për ciklin e parë Bachelor</u></p> <p>https://feut.edu.al/studentet/dokumenta-te-nevojshme-per-studentet</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në programin Bachelor në Informatikë Ekonomike, forma e përfundimit të studimeve nuk realizohet përmes një provimi të përgjithshëm final me shkrim, por përmes punimit të diplomës, siç përcaktohet në Rregulloren e Diplomimit të Informatikës Ekonomike dhe Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë për Programet Bachelor. Për këtë arsye, në këtë program nuk parashikohet ngritja e një komisioni të posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar mbi të gjitha lëndët/modulet.</p> <p>Në vend të kësaj, ngrihet ‘Komisioni i Vlerësimit të Diplomës’, i cili ka funksion formal dhe siguron objektivitet e transparencë në procesin e vlerësimit. Ky komision, i përbërë nga pedagogë të fushës përkatëse, shqyrton cilësinë e punimit, rëndësinë e temës së trajtuar, integrimin e njohurive të fituara gjatë viteve të studimit, qasjen metodologjike si dhe përgatitjen e studentit për mbrojtjen publike të diplomës. Procedurat dhe përgjegjësitë e secilit aktor në këtë proces përcaktohen qartë në dokumentet zyrtare: Rregullorja e Programit të Studimit të Informatikës Ekonomike, Formulari i Vlerësimit të Diplomës për ciklin Bachelor, si dhe Rregullorja e përgjithshme e Fakultetit të Ekonomisë për programet Bachelor.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 3 FE Rregullore Programit Bachelor</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Regullore e Programit të Studimit</u></p> <p><u>Evidenca 13 Regullore për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, në Universitetin e Tiranës</u></p> <p><u>Evidenca 13.2 IE Draft regullore Diplomimi</u></p> <p><u>Evidenca 13.3 Formular Vlerësimi Temë Diplome për ciklin e parë Bachelor</u></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë ka hartuar një procedurë për përzgjedhjen e temës së diplomës nga ana e studentëve, ku në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik të vitit të tretë, Departamenti shqyrton propozimet e studentëve mbi temat dhe garanton që temat të jenë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe profilin e ngushtë akademik dhe profesional të lektorëve udhëheqës, i cili përcaktohet me vendim të këshillit të departamentit.</p>




<p>tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pas përfundimit të këtij procesi, udhëheqësi ndihmon studentin në zhvillimin e idesë fillestare, kryerjen e studimit të literaturës, përcaktimin e metodologjisë, implementimin dhe testimin e rezultateve. Për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit të punimit të diplomës institucioni ka hartuar një formular raportimi periodik në lidhje me ecurinë e saj.</p> <p>Përpara paraqitjes së punimit për mbrojtje, udhëheqësi kryen vlerësimin përfundimtar të cilësisë së diplomës dhe vendos nëse ajo është e përgatitur në mënyrë të përshtatshme për t'u paraqitur përpara komisionit të vlerësimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 3 FE Rregullore Programit Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Evidenca 13 Regullore për diplomim në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve "Master Ekzekutiv", në Universitetin e Tiranës</i></p> <p><i>Evidenca 13.1 Projekt Rregullore për diplomimin në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve Dhe NJSBC në Universitetin e Tiranës, Neni 5</i></p> <p><i>Evidenca 13.3 Formular Vlerësimi Temë Diplome për ciklin e parë Bachelor</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me GVB, takimi me studentët, GVJ konstaton se: Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën shkencore për të inkurajuar studentët drejt kërkimit shkencor, praktikave, apo kryerjeve të implementimeve apo testeve të ndryshme në lidhje me informatikën ekonomike. Infrastruktura shkencore e ofruar përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura në funksion të programit të studimit; - Shërbimet e bibliotekës; - Biblioteka online JSTORE dhe JLimprecht; - Shërbimet e IT-së; - Aksesit në burime online të revistave shkencore; - Programe softuerike specifike të nevojshme për lëndët e tyre. <p>Institucioni gjatë periudhës së provimeve dhe punimit të tezës së diplomës mban të hapur aksesin në laboratorët e kompjuterave dhe bibliotekë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të Studimit</i></p> <p><i>Evidenca 11.9 FE Infrastruktura Mjediset</i></p> <p><i>Evidenca 22.1 Marrëveshjet Ndërinstitucionale mars 2025</i></p> <p><i>Evidenca 22.2 Lista e Marrëveshjeve Institucionale Praktikat 2023-2024</i></p>

	<p><u>Evidenca 22.3 Lista e Marrëveshjeve Institucionale Praktikat 2022-2023</u></p> <p><u>Evidenca 22.4 Links web Marrëveshjet e bashkëpunimit</u></p> <p><u>Aneks Tabelat Përmbledhëse</u></p> <p><u>Evidenca 11.6 UT Biblioteka JSTORE Agreement 2020 IPA countersigned</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.2 FE Biblioteka J.Limprecht.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.3 FE Marrëveshjet per bibliotekat online</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.4 Manual Ulibrary</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.7 Biblioteka Formular Cobiss</u></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar ngrre komisionin e vlerësimit, i cili përbëhet nga jo më pak se 2 anëtarë dhe miratohet nga këshilli i departamentit.</p> <p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet me prezantim para komisionit, dhe vlerësohet me notë, e cila arkivohet pranë koordinatorës së departamentit dhe u shfaqet studentëve në sistemin e-Student.</p> <p>Sipas ‘Rregullores së Diplomimit’, Neni 6, pika d, në seksionin “Procedura e mbrojtjes së Diplomës”, përcaktohet se: Komisioni i mbrojtjes së diplomës përbëhet nga të paktën dy anëtarë, staf akademik i fushës së studimit ku përfshihet studenti. Gjithashtu, në Rregulloren e Fakultetit Ekonomik për programet Bachelor, Neni 38, pika 4, theksohet se: “Vlerësimi përfundimtar i temës së diplomës është shumatore e vlerësimit të pedagogut udhëheqës dhe vlerësimit të komisionit”.</p> <p>Nga verifikimet e kryera gjatë vizitës pranë Sekretarisë Mësimore, GVJ konstatoi raste kur vlerësimi i diplomës së studentëve ishte kryer vetëm nga një anëtar i stafit akademik, në kundërshtim me dispozitat e rregullores.</p> <p><u>GVJ rekomandon që Fakulteti të ngrrejë komisionet e mbrojtjes së diplomave me jo më pak se 3 anëtarë, për të siguruar transparencë më të lartë dhe vlerësim më objektiv të diplomave të studentëve.</u></p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 3 FE Rregullore Programit Bachelor, Neni 38</u></p> <p><u>Evidenca 13 Regullore për diplomim në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, në Universitetin e Tiranës, Neni 14</u></p> <p><u>Evidenca 13.1 Projekt Regullore për diplomimin në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve dhe NJSBC në Universitetin e Tiranës, Neni 14</u></p> <p><u>Evidenca 13.3 Formular Vlerësimi Temë Diplome për ciklin e parë Bachelor</u></p>




<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti, i cili ka përfunduar me sukses të gjitha lëndët e programit të studimit dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në programin e studimit, pajiset me diplomë <i>Bachelor</i> në “Informatikë Ekonomike” në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion diploma, suplementi i diplomës dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit, bazuar në Rregulloren e Universitetit të Tiranës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 2.0.1 Projekt Plan Mësimor Dega Informatikë Ekonomike 2003</u></p> <p><u>Evidenca 3.1 IE Rregullore e Programit të studimit</u></p> <p><u>Evidenca 14.1 UT Suplementi i Diplomës</u></p> <p><u>Evidenca 14.2 Urdhër Nr. 297 për Regjistrimin e Diplomave Bachelor dhe Master</u></p> <p><u>Evidenca 14.3 IE Suplement Diplome</u></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Ruajtje dhe arkivimi i të dhënave është parashikuar në Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Zyra e Regjistrimit dhe Akriva e Fakultetit të Ekonomisë, sipas detyrimeve ligjore ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të të dhënave të diplomimit dhe performancës së studentit si: dosja e studentit, rregjistri themeltar, rregjistri i arritjeve akademike etj. dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p> <p>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Bazuar në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, studenti i cili ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomën përkatëse; - Suplementin e diplomës; - Certifikata e notave; - Katalogu i përshkrimit të lëndëve. <p>Diploma nënshkruhet me shkrim dore duke shënuar emrin, mbiemrin, gradën dhe titullin shkencor nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë përgjegjës për programin e studimit dhe nga Rektori i Universitetit të Tiranës. Me tej diploma vuloset me vulën e njomë të Universitetit të Tiranës. Fakulteti pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari,</p>

	<p>kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij.</p> <p>Evidenca: <u>Evidenca 1.2 Rregullore e UT</u> <u>Evidenca 1.22 FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore</u> <u>Evidenca 1.26 FE Manuali i arkivës</u> <u>Evidenca 2.4 IE. Supplement Diplome</u></p>			
Konkluzione	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit përfundimtar/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Bachelor" në "Informatikë Ekonomike" në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i></p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - hartimin e një manuali udhëzues për procesin e përgatitje së tezës së diplomës dhe vënien e tij në dispozicion të studentëve, duke e publikuar gjithashtu edhe në faqen zyrtare të institucionit. - Fakulteti të ngrejë komisionet e mbrojtjes së diplomave me jo më pak se 3 anëtarë, për të siguruar transparencë më të lartë dhe vlerësim më objektiv të diplomave të studentëve. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1																																																													
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																																																													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																												
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, vërehet që personeli akademik (PAE, PAK) dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, sa i përket kualifikimit akademik, në qasje me programin e studimit. Lëndët/modulet kryesore të programit mbulohen nga staf me titull “Doktor i Shkencave” dhe më lart, në përputhje me Rregulloren e UT-së. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, si njësi bazë përgjegjëse për programin Informatikë Ekonomike, përbëhet nga 34 pedagogë me kohë të plotë, ndër të cilët: 6 janë Profesorë të rregullt, 12 Profesorë të Asociuar, 5 Doktorë Shkencash, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga lektorë në proces të kualifikimit shkencor. Për të mbuluar ngarkesën mësimore DSIZ angazhon edhe pedagogë me kohë të pjesshme [PAK] nga fakulteti dhe institucione të tjera, për të garantuar ndërthurjen e mësimdhënies teorike me eksperiencën praktike. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për gjatë 3 viteve të fundit është si më poshtë vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> <th colspan="2">2023 - 2024</th> <th colspan="2">2024 - 2025</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>16</td> <td>-</td> <td>18</td> <td>-</td> <td>21</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>19</td> <td>11</td> <td>24</td> <td>7</td> <td>19</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd në proces</td> <td>7</td> <td>3</td> <td>20</td> <td>5</td> <td>25</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>9</td> <td>21</td> <td>-</td> <td>25</td> <td>-</td> <td>23</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>54</td> <td>36</td> <td>65</td> <td>37</td> <td>69</td> <td>34</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidenca: <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p>						Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		2024 - 2025		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	3	1	3	-	4	1	Prof.As.Dr	16	-	18	-	21	-	Dr/PhD	19	11	24	7	19	5	Dr/Phd në proces	7	3	20	5	25	5	Msc	9	21	-	25	-	23	Në total	54	36	65	37	69	34
Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		2024 - 2025																																																								
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																																							
Prof.Dr	3	1	3	-	4	1																																																							
Prof.As.Dr	16	-	18	-	21	-																																																							
Dr/PhD	19	11	24	7	19	5																																																							
Dr/Phd në proces	7	3	20	5	25	5																																																							
Msc	9	21	-	25	-	23																																																							
Në total	54	36	65	37	69	34																																																							

	<p><u>Evidenca 5 - Plani strategjik i departamentit DSIZ 2025-2030.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 7 - UT Manual mbi Punësimimin e Personelit në Universitetin e Tiranës.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 2.7 - CV_DSIZ_PAE.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 2.7.1 - CV_DSIZ_PAK.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 1, 6^{1,2,3}, 7, 8</u></p>												
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ vëren se PAE që është angazhuar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike respekton të gjitha dispozitat ligjore sa i përket ngarkesës mësimore. Ngarkesa mësimore është shpërndarë sipas Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor në Informatike Ekonomike, për vitin akademik 2024-2025, personeli akademik efektiv përballon pjesën më të madhe të ngarkesës (73%), duke u përballur me një mbingarkesë mbi normën mësimore, e cila është e miratuar nga Dekani dhe mund të arrijë deri në 300 orë mësimore, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Raporti midis personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë mund të jenë në përputhje me përcaktimet ligjore, por ngarkesa për disa PAE është e lartë.</p> <table border="1" data-bbox="593 1048 1342 1265"> <thead> <tr> <th>Viti Akademik</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>76.38%</td> <td>23.62%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>73.71%</td> <td>26.29%</td> </tr> <tr> <td>2024-2025</td> <td>72.48%</td> <td>27.51%</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ vëren se stafi PAE ka ngarkesë të lartë, dhe nuk ka një shpërndarje uniforme.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Që, në mbështetje të realizimit të ngarkesës mësimore të ketë një shpërndarje uniforme tek stafi PAE.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse të plota, Tab. 12.1/2/3</u></p>	Viti Akademik	PAE	PAK	2022-2023	76.38%	23.62%	2023-2024	73.71%	26.29%	2024-2025	72.48%	27.51%
Viti Akademik	PAE	PAK											
2022-2023	76.38%	23.62%											
2023-2024	73.71%	26.29%											
2024-2025	72.48%	27.51%											
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për</p>	<p>GVJ vëren se stafi PAE i angazhuar në programin e studimit Informatikë Ekonomike mbulon 73% të ngarkesës për vitin akademik 2024-2025. UT garanton qëndrueshmërinë e PAE të angazhuar në programin e studimit përgjatë 3 viteve të fundit. Fakulteti i Ekonomisë dhe DSIZ sigurojnë që përzgjedhja dhe angazhimi i stafit akademik të kryhet mbi bazën e rregullores së IAL-së. Të dhënat mbi personelin akademik dhe ndihmës</p>												




<p>të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>akademik, përfshihen në kontratat e punës të secilit, menaxhohen nga njësitë përkatëse në bashkëpunim me Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës pranë Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Të bëhen raportimet vjetore të DSIZ, për dy vitet e fundit akademike, 2023-2024, 2024-2025.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.26 - FE Manuali i arkivës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.3.2 - DSIZ RaportimVjetor 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se FE/DSIZ realizon rekrutimin e personelit akademik në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. GVJ vëren se procedurat e rekrutimit janë të përcaktuara qartë në dokumentet institucionale të ofruara nga IAL-ja, si Statuti i UT-së, Neni 67 dhe Rregullorja UT.</p> <p>Përgjegjësi i njësisë bazë DSIZ të programit Informatikë Ekonomike, identifikon nevojat për staf akademik dhe ia paraqet ato Dekanit si propozim. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes së stafit përcaktohen në Statutin e UT, ndërsa kriteret specifike formulohen nga njësia bazë, në përputhje me kërkesat e departamentit. Pas miratimit nga Rektori, pozicionet vakante publikohen në faqet zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Universitetit të Tiranës. Procesi i përzgjedhjes zhvillohet në dy faza: Vlerëson dosjet e aplikantëve dhe intervistohen vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf, Neni 67, 68</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7 - UT Manual mbi Punësimimin e Personelit në Universitetin e Tiranës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7.2 - Model kontrate person.akad.me kohe te plote.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7.3 - Model kontrate personel akdemik me kohe te pjesshme.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7.4 - Procedure rekrutimi tip (DSIZ).pdf</i></p> <p><i>https://feut.edu.al/lajmerime/2449-njoftim-vende-te-lira-pune-prane-fakultetit-te-ekonomise-per-personel-akademik-me-kohe-te-plote-ne</i></p>

	<i>departamentin-e-statistike-dhe-informatike-e-zbatuar-ne-fakultetin-e-ekonomise-shpallur-ne-buletinin-nr-16-date-25-03-2024</i>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe DSIZ, sigurojnë angazhimin e personelit ndihmës-akademik, të cilët mbështesin drejtpërdrejt procesin mësimor të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Stafi ndihmës akademik kontribuon në mbarëvajtjen e procesit akademik përmes menaxhimit dhe mirëmbajtjes të laboratorëve. Personeli administrativ dhe ai ndihmës-akademik janë pjesë e strukturës së miratuar të Fakultetit. DSIZ ka në strukturën e tij dy punonjës në rolin e personelit ndihmës-akademik.</p> <p><u>Evidenca:</u> <i>Evidenca 7.1 - FE Organigrama 2025.pdf</i> <i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 2</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar vizitës në IAL, GVJ vëren se Universiteti i Tiranës ka një proces administrativ për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ të angazhuar në çdo program studimi, përfshirë programin Bachelor Informatikë Ekonomike, sipas një frekuence vjetore (1 herë në vit).</p> <p>Të dhënat mbahen në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, si dhe me Ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të Fakultetit të Ekonomisë. Dosja e personelit ruhet në formë fizike, dhe përmban dokumentacionin e plotë për secilin punonjës, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Curriculum Vitae [CV], ● Dokument identifikimi, ● Pozicionin e punës, ● Diplomën dhe listën e notave, ● Gradën shkencore dhe/ose titullin akademik, ● Dëshmitë e njohjes së gjuhëve të huaja, ● Dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve profesionale, ● Kontratën e punës dhe dokumentacion tjetër mbështetës, ● Librezën shëndetësore, ● Raportin mjekësor për aftësinë për punë. <p><u>Evidenca:</u></p>

	<p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.26 - FE Manuali i arkivës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, ka marrëveshje institucionale me IAL, kompani dhe biznese në mbështetje të praktikës profesionale, punimit të diplomës apo veprimtarive të tjera të lidhura me formimin profesional të studentëve, në përputhje me objektivat e programit të studimit bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Në programin Bachelor Informatikë Ekonomike, studentët zhvillojnë kursin praktika profesionale (4 kredite) në institucione publike dhe private në përputhje me fushën e programit të studimit. Këto praktika koordinohen nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar. Personeli i angazhuar për udhëheqjen e praktikës dhe të diplomave është staf PAE i kualifikuar, të cilët mbikëqyrin studentët gjatë fazës së realizimit të praktikës dhe temës së diplomës. Procesi për zhvillimin e praktikave profesionale është i dokumentuar dhe përfshin, listën të pedagogëve udhëheqës për çdo vit akademik dhe cikël studimi të miratuar nga përgjegjësi i Njësisë Bazë, formularët e vlerësimit të praktikës dhe të punimit të diplomës, si dhe raportet përfundimtare të praktikës dhe të diplomës, të arkivuara në Sekretarinë Mësimore dhe Departament. Zyra e karrierës në FEUT, informon studentët në lidhje me kompani që ofrojnë praktika ose trajnim profesional.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1 - Rregullore e UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 13.4.0 - Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udheheqës Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 13.4.1 - Formular Raporti Përfundimtar Praktika Mësimore Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 13.4.2 - Formular Vlerësimi Studenti Praktika Mësimore Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 13.4.3 - Formular Miratimi Praktika Mësimore Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 20.12.1 - FE Formular Vlerësimi Kompanite.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 20.12.2 - FE Formular Vlerësimi Studentet.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 22.2 - Lista Marrëveshjeve Institucionale Praktikant 2023-2024.pdf</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave</p>	<p>Universiteti i Tiranës, Fakultetit Ekonomisë dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, përmes miratimit të lektorëve mbikqyrës, siguron që ky personel të jetë i përfshirë në mënyrë aktive në ndjekjen dhe vlerësimin e studentëve gjatë</p>

<p>profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>praktikës profesionale. Çdo praktikë profesionale realizohet në institucione në marreveshje me IAL-në. Ky proces është i formalizuar nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga UT me institucione pritëse për zhvillimin e praktikës. - Manualeve të praktikës dhe udhëzimeve të shpërndara studentëve për çdo vit akademik. - Përfshirjes së personelit pritës në procesin e vlerësimit përfundimtar të praktikës. <p>Vlerësimi përfundimtar, mbledh dokumentacionin e dorëzuar nga studenti, vlerësimin e pedagogut udhëheqës, si dhe prezantimi i studentit para komisionit. Në fund, studenti vlerësohet me një notë, e cila shfaqet në ndërfaqen e profilit të tij në Sistemin e-Student.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.0 - Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udheheqës Bachelor.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.1 - Formular Raporti Përfundimtar Praktika Mësimore Bachelor.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.2 - Formular Vlerësimi Studenti Praktika Mësimore Bachelor.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 13.4.3 - Formular Miratimi Praktika Mësimore Bachelor.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 20.12.1 - FE Formular Vleresimi Kompanite.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 20.12.2 - FE Formular Vleresimi Studentet.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 22.2 - Lista Marreveshjeve Institucionale Praktikant 2023-2024.pdf</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar kriteret më lart, GVJ vëren që personeli akademik (PAE, PAK) dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, sa i përket kualifikimit akademik, në qasje me programin e studimit. GVJ vëren se stafi PAE ka ngarkesë të lartë, dhe nuk ka një shpërndarje uniforme.</p> <p>GVJ vëren se Universiteti i Tiranës ka një proces administrativ për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmës-akademik etj.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Që, në mbështetje të realizimit të ngarkesës mësimore të ketë një shpërndarje uniforme tek stafi PAE.</i></p>




	Të bëhen raportimet vjetore të DSIZ, për dy vitet e fundit akademike, 2023-2024, 2024-2025.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë dhe DSIZ, ofrojnë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike një infrastrukturë mësimore, e cila përfshin auditorë leksioni, salla seminari, laboratorë informatike dhe zyra për personelin akademik dhe administrativ. Procesi mësimor zhvillohet kryesisht në Godinat A dhe B të fakultetit. Sipas Godina “Liria” ofron gjithashtu laboratorë shtesë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në mbështetje të procesit akademik, Fakulteti disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 22 auditorë leksionesh; • 18 salla seminari; • 13 laboratorë informatike; • Bibliotekë. <p>Nga evidencat e ofruara nga IAL-ja, GVJ vëren se infrastruktura në mbështetje të programit të studimit është 1.66 m²/student dhe 14.7 m²/person. Të gjitha ambientet mësimore janë të pajisura me projektorë, lidhje Wi-Fi dhe pajisje të tjera të nevojshme, duke garantuar kushte optimale për zhvillimin e mësimdhënies, të nxënit dhe veprimtarive kërkimore të programit të studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 11.9 - FE Infrastruktura Mjediset.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.9.1 - FE Foto të sallave të laboratoreve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.13.2- FE Informacion per Biblioteken 2024-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab 16</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, në mbështetje të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ofron mjedise mësimore të pajisura me infrastrukturën e nevojshme teknologjike, në</p>

<p>pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>përputhje me kërkesat e këtij programi studimi, si një program me karakter praktik dhe ndërdisiplinor.</p> <p>Orët mësimore të përcaktuara sipas kurrikulës së programit të studimit, zhvillohen në laborator. Programi Bachelor në Informatikë Ekonomike ka një numër të dedikuar laboratoresh informatike, të cilat përmbajnë: Kompjuterë të pajisur me programe profesionale në mbështetje të kurrikulës së programit.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 11.9 - FE Infrastruktura Mjediset.pdf</u> <u>Evidenca 11.9.1 - FE Foto të sallave të laboratoreve.pdf</u> <u>Evidenca 11.9.2 - FE Foto të zyrave të arkivave.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>DSIZ ofron mbështetje për programin Bachelor në Informatikë Ekonomike, si një program ndërdisiplinor, i cili ndërthur konceptet themelore të ekonomisë me ato të teknologjisë së informacionit. Njësia disponon laboratorë të dedikuar informatike, të pajisur me infrastrukturën dhe aparaturat e nevojshme teknologjike. Aktualisht, njësia disponon: 9 laboratorë informatike, me kompjuterë të lidhur në rrjet të brendshëm dhe akses në internet wireless; auditoret janë të pajisur me projektorë për realizimin e mësimdhënies me komponent multimedial.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 11.9 - FE Infrastruktura Mjediset.pdf</u> <u>Evidenca 11.9.1 - FE Foto të sallave të laboratoreve.pdf</u> <u>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vëren se në mbështetje të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, IAL-ja vë në përdorim 9 laborator informatike, të pajisur me programe profesionale (SPSS, Python, Dev C++, C-Free –) dhe mjete bashkëkohore (projector, smartboard etj.), në përputhje me natyrën ndërdisiplinore të programit. Laboratorët përdoren kryesisht në zhvillimin e orëve laboratorike.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 11.9 - FE Infrastruktura Mjediset.pdf</u> <u>Evidenca 11.9.1 - FE Foto të sallave të laboratoreve.pdf</u> <u>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, tab. 16</u></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se IAL-ja, në mbështetje të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ofron mjedisë mësimore të pajisura me infrastrukturën e nevojshme teknologjike, në përputhje me kërkesat e këtij programi studimi, si një program</p>

	<i>me karakter praktik dhe ndërdisiplinor. Ambjentet janë të pajisura me projektorë, lidhje interneti Wi-Fi dhe pajisje bashkëkohore për një përvojë të plotë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Bazuar në vizitën në IAL, GVJ vëren se njësia bazë që ofron programin e studimit siguron një literaturë bashkëkohore, të përditësuar çdo vit akademik. DSIZ paraqet kërkesat e stafit akademik për blerjen e librave të rinj në fillim të çdo viti akademik. Literatura e detyrueshme dhe ndihmëse paraqitet në syllabus-in përkatës të lëndës. Leksionet vihen në dispozicion studentëve në formë elektronike përmes google classroom. Gjithashtu studentët kanë akses në fondin fizik të librave në bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë, si dhe në burime digjitale, përfshirë katalogun online COBISS.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 2.6 IE Syllabuse 24-25.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.5 - UT Biblioteka të UT-së. FE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.5.1 - UT Sherbimet online.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.12 - FE Titujt e rinj te librave 2025.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.6.5 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.6.8 - Lista e librave 2023-2024.pdf</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>Bazuar në evidencat e ofruara nga IAL-ja, GVJ vëren se në fillim të çdo viti akademik, DSIZ, në bashkëpunim me Dekanatin dhe përgjegjësit e moduleve, organizon procesin e monitorimit sistematik të literaturës së përdorur në programet e studimit. Ky proces përfshin verifikimin e materialeve ekzistuese, identifikimin e botimeve më të fundit në fushat përkatëse dhe evidentimin e nevojës për përditësime në literaturë. Përgjegjësi i departamentit në fillim të çdo viti akademik, u kërkon titullarëve të lëndëve dorëzimin e syllabus-eve të përditësuara.</p>

	<p>Kërkesat për tekste të reja identifikohen dhe paraqiten në fillim të çdo viti akademik, duke u përcjellë tek strukturat përkatëse të fakultetit. Si rezultat i këtij procesi, gjatë vitit akademik 2023–2024 biblioteka është pasuruar me 92 tituj të rinj, prej të cilëve 41 i përkasin Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ). Kjo listë librash vendoset ne bibliotekë dhe departament, dhe është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 2.6 IE Syllabuse 24-25.pdf</u> <u>Evidenca 11.12 - FE Titujt e rinj te librave 2025.pdf</u> <u>Evidenca 11.6.5 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.pdf</u> <u>Evidenca 11.6.8 - Lista e librave 2023-2024.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, UT, ofron për të gjithë studentët e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike akses të barabartë në bibliotekën mësimore të fakultetit si dhe në bibliotekat digjitale që janë pjesë e marrëveshjeve institucionale, si COBISS, JStore, ULlibrary. Biblioteka e Fakultetit është e pajisur me hapësira të përshtatshme për lexim dhe studim, duke përfshirë 5 poste PC dhe lidhje interneti Wi-Fi. Staf i bibliotekës përbëhet nga katër punonjës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i bibliotekës; - 3 specialistë të sallës. <p>Shërbimi në bibliotekë ofrohet në orarin 8.30-19.30, nga e hëna në të premte, dhe gjatë sezonit të provimeve, është e hapur dhe në fundjave. Studentët mund të konsultojnë literaturën në vend, të marrin libra në përdorim afatshkurtër, si dhe të kenë akses në literaturë digjitale përmes sistemit COBISS dhe platformave ndërkombëtare online. Gjithashtu, janë marrë masa për përditësimin e fondit të librave çdo vit, bazuar në kërkesat e paraqitura nga pedagogët e moduleve përkatëse, duke siguruar që literatura të jetë në përputhje me nevojat aktuale të kurrikulës.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Të shtohen postet PC në bibliotekë, në mbështetje të studentëve.</i></p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 11.5 - UT Biblioteka të UT-së. FE.pdf</u></p>




	<p><u>Evidenca 11.6 - UT Biblioteka JSTORE Agreement 2020 IPA countersigned.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.1 - FE Biblioteka Plani Strategjik.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.2 - FE Biblioteka J.Limprecht.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.3 - FE Marrëveshjet për bibliotekat online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.5 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.7 - Biblioteka-FORMULAR COBISS.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.8 - Lista e librave 2023-2024.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.13 - FE Rregullore e Bibliotekes.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.13.2- FE Informacion per Biblioteken 2024-2025.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në IAL, GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë, UT, ofron një bibliotekë mësimore funksionale dhe të pasur me literaturë mbështetëse për programin të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Biblioteka përmban një fond fizik dhe digjital, prej rreth 5280 titujsh, nga të cilët 2526 tituj janë në gjuhën shqipe dhe 2754 tituj në gjuhë të huaja, në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Në tre vitet e fundit janë shtuar 342 tituj të rinj në gjuhën angleze për të pasuruar literaturën e disponueshme. Gjatë vitit akademik 2023–2024 biblioteka është pasuruar me 41 tituj të rinj, që i përkasin Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ). Literatura online mund të arrihet përmes bibliotekës digjitale, përfshirë JSTOR, U-Library, dhe COBISS+.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 11.5 - UT Biblioteka të UT-së, FE.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.2 - FE Biblioteka J.Limprecht.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.3 - FE Marrëveshjet për bibliotekat online.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.5 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.6.7 - Biblioteka-FORMULAR COBISS.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.13 - FE Rregullore e Bibliotekes.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.13.2- FE Informacion per Biblioteken 2024-2025.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, UT, garanton akses të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike në bibliotekat online. Nëpërmjet marrëveshjeve institucionale, studentëve u vihet në dispozicion një sërë platformash digjitale ndërkombëtare, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● JSTOR ● U-Library dhe Emerald Insight,

	<ul style="list-style-type: none"> ● COBISS+ <p>Studentëve i ofrohet asistencë nga personeli i bibliotekës në përdorimin e këtyre platformave.</p> <p><u>Evidenca:</u> <i>Evidenca 11.5 - UT Biblioteka të UT-së, FE.pdf</i> <i>Evidenca 11.6.2 - FE Biblioteka J.Limprecht.pdf</i> <i>Evidenca 11.6.3 - FE Marrëveshjet për bibliotekat online.pdf</i> <i>Evidenca 11.6.5 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.pdf</i> <i>Evidenca 11.6.7 - Biblioteka-FORMULAR COBISS.pdf</i> <i>Evidenca 11.13 - FE Rregullore e Bibliotekes.pdf</i> <i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bazuar në vizitën në IAL, GVJ vëren që Fakulteti i Ekonomisë ofron një bibliotekë të pajisur me kompjutera të lidhur me internet, duke mundësuar kështu akses të barabartë dhe pa kufizime për të gjithë studentët e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Aktualisht aktiv ishin 5 post PC. Kjo infrastrukturë mbështetëse nuk lejon shfrytëzimin e literaturës digjitale dhe fizike në mënyrë efikase dhe të njëjtë për të gjithë studentët.</p> <p><u>Evidenca:</u> <i>Evidenca 11.13.2- FE Informacion per Biblioteken 2024-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Ambientet e bibliotekës në Fakultetin e Ekonomisë janë në shërbim të studentëve nga e Hëna deri të Premten, në orarin 08:30–16:30. Gjatë sezoneve të provimeve, orari i bibliotekës zgjatet edhe në fundjavë, nga e shtuna në të dielë, në të njëjtin orar 08:30–16:30, për të plotësuar nevojat e shtuara të studentëve për studim dhe konsultim të literaturës.</p> <p><u>Evidenca:</u> <i>Evidenca 11.5 - UT Biblioteka të UT-së, FE.pdf</i> <i>Evidenca 11.13 - FE Rregullore e Bibliotekes.pdf</i> <i>Evidenca 11.13.2- FE Informacion per Biblioteken 2024-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik</p>	<p>Njësia përgjegjëse e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, DSIZ në bashkëpunim me bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë dhe strukturat e tjera përgjegjëse, ndjek dhe raporton në mënyrë të rregullt mbi cilësinë dhe përdorimin e fondit fizik dhe atij digjital të literaturës për programin Bachelor në Informatikë Ekonomike. Raportimi i rregullt bëhet përmes dokumenteve dhe formularëve përkatës të mbajtur nga biblioteka dhe drejtuesit e njësive akademike.</p>





dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 11.6.3 - FE Marrëveshjet për bibliotekat online.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.6.5 - Linku i fondit të librave të bibliotekës së feut.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.6.8 - Lista e librave 2023-2024.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.12 - FE Titujt e rinj te librave 2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.13 - FE Rregullore e Bibliotekes.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 11.13.2- FE Informacion per Biblioteken 2024-2025.pdf</u></i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ nga vizita në IAL, vëren se FE dhe DSIZ ka një proces të mirëorganizuar për pasurimin e literaturës në mbështetje të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Ambientet e bibliotekës në Fakultetin e Ekonomisë janë në shërbim të studentëve, në orare të ndryshme.</i></p> <p><i>IAL ofron 2 mënyra aksesi në bibliotekë, fizik dhe online. Kërkesat për tekste të reja paraqiten në fillim të çdo viti akademik. Gjatë vitit akademik 2023–2024 biblioteka është pasuruar me 41 tituj të rinj, që i përkasin Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar (DSIZ). Kjo listë librash vendoset ne bibliotekë dhe departament, dhe është në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik.</i></p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Të shtohen postet PC në ambientet e bibliotekës, në mbështetje të studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë	Bazuar në evidencat e ofruara nga IAL-ja, GVJ vëren se çdo student disponon një profil individual në platformën e-student, përmes të cilit ndërvepron me pedagogët dhe sekretarinë. Në Fakultetin e Ekonomisë, administrimi dhe

Handwritten signature

Handwritten signature

<p>informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>përpunimi i këtyre të dhënave kryhet nga sekretaria mësimore. Përveç dokumentacionit fizik, të dhënat menaxhohen edhe përmes platformës elektronike e-Student, e cila përdoret për menaxhimin e plotë të ciklit akademik të studentëve. Përmes sistemit e-Student, studentët kanë mundësi të kryejnë një sërë shërbimesh administrative dhe akademike, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • regjistrimin në provime, • marrjen e njoftimeve për vlerësimet dhe rezultatet, • paraqitjen e kërkesave për përmirësim apo ankim të notave. <p>Në mbështetje të procesit mësimor dhe komunikimit ditor, stafi akademik përdor gjithashtu platforma të tjera dixhitale, si Microsoft Teams, Google Classroom, Zoom.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u><i>Evidenca 1.1 - Rregullore e UT.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 1.22 - FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 1.26 - FE Manuali i arkivës.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 11.8 - UT Upgrade i aplikimit software e-Student.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 11.11 - UT Manual per Pedagog e-Student.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë visitës në IAL, GVJ konstaton se Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës ruan, menaxhon dhe arkivon dokumentacionin që lidhet me personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ. Stafi dhe studentët komunikojnë përmes adresave të dedikuara të email-it me formatin <i>emër.mbiemër@unitir.edu.al</i>, të cilat garantojnë identifikimin e saktë të përdoruesve. Gjithashtu stafi akademik përdor platformat digjitale Microsoft Teams, Google Classroom dhe Zoom, si mjete efektive për zhvillimin e mësimin, organizimin e takimeve, ndarjen e materialeve dhe koordinimin administrativ. Studentët dhe stafi kanë akses të vazhdueshëm në informacionet zyrtare përmes faqeve web të Universitetit të Tiranës (<i>unitir.edu.al</i>) dhe të Fakultetit të Ekonomisë (<i>feut.edu.al</i>), ku publikohen njoftime, udhëzime akademike, akte normative dhe materiale të tjera mbështetëse.</p> <p>Bazuar në evidenca, GVJ vëren se IAL-ja zotëron sistemin ‘Sistemi inteligjent i dokumentacionit shkresor’, i cili daton në vitin 2016. Dokumentacioni I përfshirë në këtë sistem</p>




	<p>është I vjetër dhe duhet azhurnuar në përmbajtje dhe shërbime.</p> <p>GVJ rekomandon:</p> <p><i>Në sistemin 'Sistemi inteligjent i dokumentacionit shkresor', viti 2016, të shtohen shërbime e reja për ruajtjen e të dhënave të stafit akademik.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.22 - FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.26 - FE Manuali i arkivës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7 - UT Manual mbi Punësimimin e Personelit në Universitetin e Tiranës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.8 - UT Upgrade i aplikimit software e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.11 - UT Manual per Pedagog e-Student.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se në Fakultetin e Ekonomisë, bazuar në dokumentacionin e ngarkuar në sistem dhe vizitën në IAL, për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, dokumentacioni administrohet nga specialistët e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, në dosje fizike. Këto dosje azhurnohen në fillim të vitit akademik. Studentët dhe stafi kanë akses në sistemin e-Student, dhe në informacione zyrtare përmes faqeve web të Universitetit të Tiranës [unitir.edu.al] dhe të Fakultetit të Ekonomisë [feut.edu.al].</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.22 - FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.26 - FE Manuali i arkivës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 7 - UT Manual mbi Punësimimin e Personelit në Universitetin e Tiranës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.8 - UT Upgrade i aplikimit software e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.11 - UT Manual per Pedagog e-Student.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë, komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve realizohet nga sistemi e-Student. Gjithashtu përdorin platforma të integruara të komunikimit dhe menaxhimit të informacionit si platforma Microsoft Teams. Gjithashtu, çdo anëtar i stafit dhe student është i pajisur me adresë zyrtare email-i të formatit emër.mbiemër@unitir.edu.al, duke garantuar një kanal zyrtar dhe të besueshëm komunikimi institucional.</p> <p><u>Evidenca:</u></p>

	<p><i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.11 - UT Manual per Pedagog e-Student.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Bazuar në vizitën e realizuar në IAL, GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë përdor platformën e-Student si sistemin kryesor për administrimin dhe menaxhimin e të dhënave akademike të studentëve. Përmes këtij sistemi digjital realizohen proceset kryesore administrative dhe akademike, duke përfshirë regjistrimin në provime, ndjekjen e ciklit të studimeve, publikimin dhe verifikimin e vlerësimeve, si dhe procedurat e lidhura me përfundimin e studimeve. Platforma është e aksesueshme nga stafi akademik dhe administrativ, studentët. Sistemi e-Student realizon koordinimin e informacionit akademik, duke mundësuar transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e të dhënave.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 11.8 - UT Upgrade i aplikimit software e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.11 - UT Manual per Pedagog e-Student.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ vëren se Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar publikon në faqen zyrtare të institucionit informacionet kryesore që lidhen me programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Ky informacion ofrohet në gjuhën shqipe edhe në gjuhën angleze, duke garantuar akses dhe transparencë për të gjithë. Në faqen e fakultetit dhe DSIZ mund të gjeni kurrikulën e programit të studimit, objektivat dhe rezultatet e pritshme, si dhe informacion për përbërjen e stafit akademik të DSIZ. Këto të dhëna shërbejnë për orientimin e studentëve.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p>https://feut.edu.al/programe-studimi/bachelor/bachelor-ne-informatike-ekonomike</p> <p>https://feut.edu.al/fakulteti/departamentet/departamenti-i-statistikes-dhe-informatikes-se-zbatuar/stafi-i-departamentit-siz</p> <p>https://feut.edu.al/lajmerime/2626-grupet-mesimore-bachelor-viti-i-viti-akademik-2024-2025</p> <p>https://feut.edu.al/lajmerime</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se UT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, të cilin e vë në dispozicion të administrimit dhe monitorimit të dokumentacionit të stafit, studentëve në lidhje me procesin mësimor. FE përdor sistemin e-Student si platformën kryesore për administrimin e të dhënave akademike të studentëve, nga regjistrimi në provime, ndjekja e progresit dhe vlerësimet. Secili anëtar i</i></p>

	<p>stafit akademik, administrativ dhe studentët, komunikojnë përmes adresave zyrtare mail, të ofruara nga IAL-ja.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p>Në sistemin 'Sistemi inteligjent i dokumentacionit shkresor', viti 2016, të shtohen shërbimet e reja për ruajtjen e të dhënave të stafit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në evidencat e IAL-së, GVJ vëren se të ardhurat për programin e studimit sigurohen dhe administrohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, siç përcaktohet në Statutin e UT-së, Neni 144. Duke qënë IAL publike, burimet kryesore të financimit përfshijnë: fondet e alokuara nga buxheti i shtetit; pagesat e studentëve; të ardhurat e realizuara nga bashkëpunimet me biznesin ose sponsorizemt; donacionet; si dhe projektet.</p> <p>DSIZ dhe Fakulteti i Ekonomisë hartojnë raportin vjetor, ku përfshihet një plan i detajuar i të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me funksionimin e programit të studimit, Bachelor në Informatikë Ekonomike. Ky raport paraqet situatën financiare, të njësisë. Këto mekanizma të raportimit dhe planifikimit ndihmojnë qëndrueshmërinë financiare të programeve të studimit për cikle të plota akademike, si dhe në sigurimin e një menaxhimi transparent.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.1- Statuti i UT</u></p> <p><u>Evidenca 1.2- Rregullore e UT, Kreu VI, neni 82</u></p> <p><u>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024</u></p> <p><u>Evidenca 8.11 - FE Buxhetet e miratuar 2025-2024-2023-2022</u></p> <p><u>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 18</u></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse</p>	<p>GVJ vëren se njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, krijon cdo vit</p>

<p>për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.G</p>	<p>planin e financimit për funksionimin dhe zhvillimin e programit të studimit. Ky informacion paraqitet në raportet vjetore të DSIZ dhe FE. Raporti paraqet shpenzimet, të cilat lidhen me mirëmbajtjen e mjediseve fizike, laboratorëve, financimi i bibliotekës, që përfshin pasurimin e fondit të literaturës me botime të reja, dhe aksesin në platforma online me karakter akademik dhe shkencor. Në tablën 18 (Ascal) paraqiten zërat e shpenzimeve dhe të ardhurat në lidhje me programin e studimit.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 8.11 - FE Buxhetet e miratuar 2025-2024-2023-2022</i></p> <p><i>Evidenca 8.12 - FE Projekt Buxhetet 2025-2024-2023</i></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 18</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UT/FE, GVJ vëren se IAL-ja realizon kontroll periodik vjetor të brendshëm dhe të jashtëm për mirëpërdorimin e fondeve. IAL-ja ka në strukturën e tij Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, e cila përbëhet nga një staf prej 7 punonjësish dhe raporton tek Bordi i Administrimit për kontrollat e realizuara. Raporti vjetor i FE përmban informacion mbi veprimtarinë akademike, shkencore, financiare të njësive përbërëse të tij, si dhe programeve që ofron. GVJ vëren se në faqen zyrtare të IAL-së, mungon dokumentacioni i afishuar për procesin e auditimit.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Të publikohen në faqen zyrtare të UT-së, në seksionin "Programi i Transparencës" [https://unitir.edu.al/programi-i-transparencës-2/], dokumentacioni mbështetës për procesin e auditimit.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.12 - UT Vendim-4-1-Rregullore-e-brendshme-e-punes.pdf, Neni 17</i></p> <p><i>Evidenca 1.21 - FE Rregullore e Njësive të Sigurimit të Cilësisë.pdf, Neni 6</i></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Universiteti i Tiranës realizon periodikisht cdo vit kontrollin e veprimtarisë akademike dhe administrative të tij. IAL-ja harton raportet financiare periodike. Këto raporte përfshijnë të ardhurat dhe shpenzimet e IAL-së. Të ardhurat e FEUT-së përbëhen nga granti nga buxheti i shtetit dhe tarifat e shkollimit, si dhe të ardhura të gjeneruara nga vetë njësia kryesore, si projekte dhe sponsorizime. IAL-ja raporton në njësitë drejtuese të FE, raportin financiar vjetor. Informacioni dhe vendimet përkatëse i komunikohen përgjegjës të DSIZ dhe shërbejnë si bazë për planifikimin buxhetor të ciklit akademik pasardhës.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1- Statuti i UT, neni 7, 9, 54, 55</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT, neni 32, 33</i></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 18</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në raportin vjetor të FEUT, GVJ vëren se të ardhurat për programin e studimit, sigurohen nga granti i buxhetit të shtetit si dhe nga tarifat e studentëve. Kuotat e miratuara janë të plotesuara tërësisht gjatë 3 viteve të fundit, gjë që tregon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimi gjithashtu, FE/DSIZ ka të ardhura nga projektet e kërkimit shkencor dhe sponsorizime nga të tretë. FE monitoron ecurinë financiare të çdo programi studimi dhe ndërmerr masa për vazhdimsinë cilësore të tyre, përfshirë edhe programin Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca Venidm Bordi, Nr.12, dt.18.03.2024, 'Për miratimin e buxhetit në UT, viti 2024'</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë harton dhe miraton në mënyrë periodike raportin vjetor të veprimtarisë së tij, ku përfshihet edhe burimi i të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve që mbulojnë programin e studimit, Bachelor në Informatikë Ekonomike.</i></p> <p><i>Këto raporte i shërbejnë drejtuesve institucionalë, departamenteve dhe njësisë mbështetëse për planifikimin financiar afatmesëm dhe afatgjatë të mbështetjes së programeve të studimit dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare për cikle të plota studimi.</i></p>

	<p>Bazuar në raportin vjetor të FEUT, vërehet qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit. Kuotat e miratuara janë të plotësuara 100% për këtë program studimi. Fakulteti i Ekonomisë, si një nga njësitë kryesore të UT-së, siguron të ardhura nga granti i buxhetit të shtetit si dhe nga tarifatat e studentëve.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p>Të publikohen në faqen zyrtare të UT-së, në seksionin "Programi i Transparencës" [https://unitir.edu.al/programi-i-transparencës-2/], dokumentacioni mbështetës për procesin e auditimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ vëren se UT-ja ka një rregullore, ku përcaktohen procedurat të cilat mbulojnë të gjitha fazat e ciklit akademik të studentëve, që nga momenti i aplikimit dhe pranimit e deri në përfundimin e studimeve. Institucioni garanton që çdo student i programit Bachelor në Informatikë Ekonomike të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. FE bazohet në në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor. Dokumenti përfshin udhëzime të qarta mbi kriteret e pranimit, afatet, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe mënyrat e komunikimit të rezultateve të konkurrimit. IAL-ja publikon cdo njoftim në faqen zyrtare. Këto mekanizma lehtësojnë orientimin e studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve dhe garantojnë

	<p>cilësi të procesit akademik, në përputhje me praktikat e mira institucionale dhe kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu VII, Nenet 4-6, Neni 94</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.3- Strategjia e Zhvillimit te UT_2023-2028.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se UT garanton që çdo student i programit Bachelor në Informatikë Ekonomike të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. FE bazohet në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor. Dokumenti përfshin udhëzime të qarta mbi kriteret e pranimit, afatet, dokumentacionin e nevojshëm, si dhe mënyrat e komunikimit të rezultateve të konkurrimit.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu VII, Neni 94</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.3 - Strategjia e Zhvillimit te UT_2023-2028.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në evidenca, GVJ vëren se FE/DSIZ harton kriteret për pranimin e studentëve në programet e ciklit të parë Bachelor në Universitetin e Tiranës, sipas legjislationit në fuqi. Për programin Bachelor në Informatikë Ekonomike, kriteret përgatiten nga DSIZ dhe më pas miratohen me vendim të Senatit Akademik të UT-së.</p> <p>Kriteret e pranimit publikohen çdo vit në dokumentin zyrtar “Kriteret e Pranimit”, si dhe çdo vit akademik të gjitha kriteret, afatet, procedurat dhe udhëzimet për pranimin e kandidatëve publikohen në faqen zyrtare https://feut.edu.al/programe-studimi/bachelor. Kriteret e pranimit për programin Bachelor në Informatikë Ekonomike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 50% – Nota mesatare e shkollës së mesme (për të gjitha vitet e arsimit të mesëm, përfshirë edhe notat e Maturës Shtetërore; llogaritet si mesatare e thjeshtë). • 50% – Nota mesatare e gruplëndëve, llogaritur për të gjitha vitet ku lëndët janë zhvilluar, përfshirë dhe rezultatet e Maturës Shtetërore. <p>Përbërja e gruplëndëve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Matematikë – 15% • Ekonomi – 15%

	<ul style="list-style-type: none"> • Fizikë – 10% • Gjuhë e huaj – 10% <p>Aktualisht, programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike disponon 240 kuota të miratuara për pranime në ciklin e parë të studimeve.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.1 - UT Kriteret e pranimi 2024-2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.1.2 - Kuotat e Studenteve 2024-2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.1.3 - UT Kuotat e Studenteve 2025-2026 VS 13 dt 19.03.2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.2 - UT Urdher per Procedurat e Aplikimit dhe Rregjistrimit Studenteve.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimi publikohen çdo vit akademik në faqet zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Ekonomisë, pasi janë miratuar nga instancat drejtuese.</p> <p>Përveç publikimeve online, UT-ja organizon edhe takime informuese në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë me maturantë, ku shpërndahen materiale shpjeguese si broshura, fletëpalosje dhe mjete të tjera komunikimi që ofrojnë të dhëna të detajuara mbi programin e studimit.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.1 - UT Kriteret e pranimi 2024-2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.1.2 - Kuotat e Studenteve 2024-2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.1.3 - UT Kuotat e Studenteve 2025-2026 VS 13 dt 19.03.2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 18.5 - FE Mbi kriteret e pranimi të studentëve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, FEUT, për vitin akademik 2023-2024 -25-26 update.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, organizon çdo vit, takime orientuese me maturantët, ku shpërndahen materiale informuese, fletëpalosje që ofrojnë një informacion mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi dhe kurrikulën e programit. FE organizon aktivitetin Open Day dhe Work and Study për shpërndarjen e e informacionit. DSIZ realizon çdo fillim viti akademik, takime</p>




	<p>orientuese me studentët e vitit 1, për orientimin e tyre në ambientet dhe rregulloren e FE.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 18.1 - UT Kriteret e pranimit 2024-2025</u> https://feut.edu.al/programe-studimi/bachelor/bachelor-ne-informatike-ekonomike</p> <p><u>Evidenca 20.8 - FE Open Day 2025</u></p> <p><u>Evidenca 20.9 - FE Work and Study 2025</u></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL-së, GVJ vëren se UT-ja, ka përcaktuar qartë përfshirjen e gjithë kandidatëve aplikantë, në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi. DSIZ harton çdo vit akademik kritere të veçanta pranimi për kandidatët që i përkasin kategorive me aftësi të kufizuara, minoriteteve kombëtare dhe shtresave të marginalizuara sociale. Në evidencat 18.1 dhe 18.5, përcaktohen qartë kriteret e pranimit për vitin akademik 2024–2025, duke garantuar gjithëpërfshirjen në mënyrë transparente. Këto kritere dhe kuota publikohen rregullisht në faqen web të Universitetit të Tiranës, si dhe në atë të njësive përkatëse akademike.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu VII, Neni 94</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.1 - UT Kriteret e pranimit 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.5 - FE Mbi kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, FEUT, për vitin akademik 2023-2024 -25-26 update.pdf</u></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL-së, GVJ vëren se UT-ja, ka përcaktuar qartë përfshirjen e gjithë kandidatëve aplikantë nga shtete të tjera, në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi. Në evidencën 18.5, përcaktohen qartë kriteret e pranimit për vitin akademik 2024–2025, duke garantuar përfshirjen e aplikantëve nga shtete të tjera sipas kuotave të miratuara nga MAS. Këto kritere dhe kuota publikohen rregullisht në faqen zyrtare të FE.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.2- Rregullore e UT.pdf, neni 39</u></p> <p><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 18.5 - FE Mbi kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, FEUT, për vitin akademik 2023-2024 -25-26 update.pdf</u></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të</p>	<p>UT ofron ndihmë/bursa për shtresat në nevojë bazuar në Vendimin Nr. 903, datë 21.12.2016, Vendimin Nr. 40, datë</p>

<p>ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>23.01.2019 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale në pamundësi financiare për të mbuluar tarifat vjetore të shkollimit”, të ndryshuar, Vendimin Nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”.</p> <p>Për të përfituar reduktimin e tarifës, studentët duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës pranë Degës së Shërbimeve në FE-UT. Në raportet vjetore të fakultetit jepet informacion për studentët përfitues të reduktimit apo përjashtimit nga pagesat dhe përfitimit të bursave.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</u></p> <p><u>https://feut.edu.al/studentet/mundesit-per-bursa/bursa-te-ofruara-nga-shteti-4</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se Universiteti i Tiranës ka zhvilluar dhe implementon politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që mbulojnë tërësisht ciklin akademik të studentëve. Këto rregullore janë të përshkruara në Statutin e UT-së, në Rregulloren e UT-së, sipas Ligjit Nr. 80/2015.</i></p> <p><i>Procesi akademik dhe administrativ zhvillohet në përputhje me parimet themelore të barazisë, transparencës, meritokracisë dhe mosdiskriminimit, duke garantuar respektimin e të drejtave të çdo studenti të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimit publikohen çdo vit akademik në faqet zyrtare të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Ekonomisë, pasi janë miratuar nga instancat drejtuese.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2




Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ vëren se në programin “Bachelor në Informatikë Ekonomike” studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi kriteret dhe procedurat që lidhen me përparimin e tyre akademik. DSIZ ka hartuar rregulloren e programit të studimit, ku përcaktohen kushtet për të kaluar nga një vit në tjetrin deri në diplomimin e tyre. Në fillim të çdo semestri, çdo pedagog prezanton syllabus-in e kursit, mënyrën e vlerësimit të studentit, dhe rregulloren. Në sekretarinë dhe faqen e web-it të FE, studentët informohen mbi kalendarin akademik, procesin e provimeve dhe kriteret për diplomim.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Kreu V, neni 63</u></p> <p><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></p> <p><u>Evidenca https://feut.edu.al</u></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>UT garanton që studentët e programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike” të informohen në mënyrë të qartë dhe të vazhdueshme mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit, kualifikimeve, trajnimeve, transferimeve etj. Kriteret e vlerësimit për secilin kurs janë të përcaktuara në syllabus-in që pedagogu prezanton në fillim të çdo semestri.</p> <p>Nota përfundimtare për çdo lëndë formohet si një kombinim i vlerësimeve të vazhduara dhe rezultatet në provimin përfundimtar, duke respektuar rregullat e përcaktuara në Rregulloren e UT-së. Studentët informohen për të kërkuar rishikim të notës dhe ankimim të vlerësimit, afatet për dorëzimin e kërkesës për ankimim, procedurat për shqyrtimin e ankesës etj.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Kreu V, neni 63</u></p> <p><u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u></p> <p><u>https://feut.edu.al</u></p> <p><u>Evidenca 20.8 - FE Open Day 2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 20.9 - FE Work and Study 2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 20.5 - UT Të drejtat dhe detyrat e studentëve.pdf</u></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	<p>GVJ vëren se IAL-ja ka një sistem vlerësimi të unifikuar, sipas një strukture të miratuar nga njësitë drejtuese të UT. Në fillim të çdo viti dhe semestri studentët informohen rregullisht mbi</p>

<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>format dhe mënyrat e vlerësimit. Informacioni mbi mënyrën e vlerësimit dhe afatet përkatëse është gjithashtu i disponueshëm në faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë dhe përmes komunikimeve institucionale të Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Evidenca: <u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf</u> <u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Kreu V</u> <u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u> https://feut.edu.al</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vëren se studentët në programin “Bachelor në Informatikë Ekonomike” informohen mbi procesin e punimit të diplomës dhe diplomimit gjatë vitit të 3, semestri I. DSIZ ka hartuar ‘Udhëzuesi i Punimit të Diplomës’, ku përcaktohen qartë detyrimet e studentit, udhëzimet për përzgjedhjen e temës, kriteret për vlerësimin e punimit të diplomës, si dhe rregullat për mbrojtjen saj. DSIZ në semestrin e dytë të vitit të fundit përcakton afatet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ përzgjedhjen e temës së diplomës dhe dorëzimin e formularëve përkatës; ✓ Procedurat për caktimin e udhëheqësit akademik dhe format e komunikimit me të; ✓ Formatin e punimit të diplomës; ✓ Prezantimin e punimit <p>Informacioni mbi diplomimin publikohet rregullisht në faqen web të Fakultetit të Ekonomisë, në seksionin e dokumenteve për studentët.</p> <p>Evidenca: <u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Neni 92</u> <u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Kreu V</u> <u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf, Kreu 7</u> https://feut.edu.al, <u>Evidenca 13 - UT Rregullore “Për diplomimin në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”.pdf, Kreu II</u> <u>Evidenca 13.3 - Formular Vlerësimi - Temë Diplome për Ciklin e Parë Bachelor.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë</p>	<p>Bazuar në evidenca GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë zhvillon takime informuese dhe publikon udhëzues dhe fletëpalosje për kandidatët maturantë që synojnë të ndjekin programin “Bachelor në Informatikë Ekonomike”. Në</p>

<p>publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>strukturën e fakultetit është Zyra e Shërbimit ndaj Studentëve, e cila në bashkëpunim me DSIZ, organizon takime të hapura me maturantët, si Open Day, Work and Study.</p> <p>Informacioni shpërndahet fizikisht përmes fletëpalosjeve, posterave dhe nëpërmjet faqes web të fakultetit.</p> <p>Evidenca: Evidenca 20.8 - FE Open Day 2025.pdf Evidenca 20.9 - FE Work and Study 2025.pdf Evidenca 20.10 - IE Takime me studentet e viteve te para 22-23.pdf Evidenca 18.2.1 - IE Programi i Studimit Booklet.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se UT dhe FE vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Bachelor në Informatikë Ekonomike”, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p> <p>Studentët në programin “Bachelor në Informatikë Ekonomike” informohen mbi procesin e punimit të diplomës dhe diplomimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik, në bashkëpunim me Zyren e Shërbimit ndaj Studentëve dhe Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, zhvillohen takime të hapura informuese me maturantët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Programi i ciklit të parë “Bachelor në Informatikë Ekonomike” përbëhet nga 180 kredite evropiane (ECTS) dhe zhvillohet përgjatë një periudhe minimale prej tre viteve akademike me kohë të plotë. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomë universitare “Bachelor në Informatikë Ekonomike”. Çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra me 15 javë mësimore secili.</p> <p>Viti akademik përbëhet nga procesi mësimor dhe sesione të strukturuar provimesh: 4 javë provime në sesionin e dimrit, 4 javë në sesionin e verës dhe 10 ditë në sesionin e vjeshtës.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave,
 Rruga Skënderbej, P. 8, Sh. 1, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

98

	<p>Çdo vit përmban 60 kredite. Fakulteti i Ekonomisë, dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, organizon çdo vit aktivitete orientuese për studentët e rinj, me qëllim njohjen e tyre me ambientin universitar, strukturën akademike të programit dhe kërkesat institucionale. Çdo pedagog, gjatë prezantimit të lëndës, u dorëzon studentëve syllabus-in përkatës, materialet didaktike të rekomanduara, për zhvillimin e modulit.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT, Neni 91-94</u> <u>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</u> <u>Evidenca https://feut.edu.al</u> <u>Evidenca 20.10 - IE Takime me studentet e viteve te para 22-23.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në vizitën në IAL, GVJ vëren se programi mësimor dhe syllabusi është i ndërtuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Çdo fillim semestri, lektori gjatë prezantimit të lëndës/kursit, paraqet syllabus-in e kursit, me të gjithë elementët përbërës. Gjithashtu, informacioni mbi programin e studimit bachelor në Informatikë Ekonomike, afishohet në faqen zyrtare të internetit të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 20.10 - IE Takime me studentet e viteve te para 22-23.pdf</u> <u>Evidenca 2.6 IE Syllabuse 24-25.pdf</u> <u>Evidenca https://feut.edu.al</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ vëren se Universiteti i Tiranës, ka në organigramën e tij njësinë e Qendrës së Karrierës. Kjo qendër ofron mbështetje institucionale studentëve të programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike” për orientimin e tyre drejt tregut të punës dhe zhvillimin e karrierës. Qendra e Karrierës u siguron studentëve informacione të strukturuar dhe të përditësuara për pozicione pune, praktika profesionale, bursa studimi dhe trajnime të fokusuara në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu. Përmes marrëveshjeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, studentëve u mundësohet pjesëmarrja në projekte dhe praktika profesionale. Gjithashtu studentëve të këtij program i ofrohen edhe shkëmbime studimore në kuadër të programeve Erasmus+. Në faqen zyrtare të Fakultetit të</p>




	<p>Ekonomisë [https://feut.edu.al] studentët mund të informohen rregullisht për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Thirrje për aplikim në praktika dhe pozicione pune; - Evente të dedikuara për karrierën; - Materiale orientuese dhe udhëzime për zhvillimin e CV-së, përgatitjen për intervista dhe ndërtimin e rrjeteve profesionale; <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u><i>Evidenca 7.1 - FE Organigrama 2025.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 10.1-Raport mbi Qendren e Karrieres.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 10.2-Aktivitet-NjoftimetWeb-Zyra e Karrierës.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 10.5 - WebLajmerime Bursa Programi Erasmus+ - FEUT.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 20.0 - FE Udhezim mbi funksionimin e Zyres se Karrieres.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 20.1 - Studentët - Web Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 20.3 - Studentet Këshillim i Karrierës - Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 20.11 - FE Panairi Punës 2022-2023-2024-2025.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 20.12 - FE Raport Dita e Karrieres 2025.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 22.1 - Marreveshjet NderIstitucionale Mars 2025.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 22.2 - Lista Marreveshjeve Istitucionale Praktikant 2023-2024.pdf</i></u></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, FE dhe DSIZ organizon takime orientuese për studentët në programin e studimit “Bachelor në Informatikë Ekonomike”, ku informohen për strukturën e programit, organizimin institucional dhe shërbimet që ofrohen. Studentët njihen me drejtuesit akademikë dhe lektorët e programit. Zyrat në shërbim të studentëve janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyra e Informacionit; 2. Sekretaria Mësimore; 3. Biblioteka; 4. Qendra e Karrierës; 5. Zyra e Shërbimeve Studentore; <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u><i>Evidenca 10.1-Raport mbi Qendren e Karrieres.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 10.2-Aktivitet-NjoftimetWeb-Zyra e Karrierës.pdf</i></u></p> <p><u><i>Evidenca 20.0 - FE Udhezim mbi funksionimin e Zyres se Karrieres.pdf</i></u></p>

	<i>Evidenca 20.10 - IE Takime me studentet e viteve te para 22-23.pdf</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Bazuar në visitën në IAL, GVJ vëren se informacioni për programin e studimit “Bachelor në Informatikë Ekonomike është I shpërndarë fizikisht dhe online në ambientet e IAL-së. Stafi angazhohet për prezantimin e kurrikulës me të gjithë elemntët përbërës. Informacioni online mbi programin e studimit bachelor në Informatikë Ekonomike, afishohet në faqen zyrtare të internetit të Fakultetit të Ekonomisë (https://feut.edu.al).</p> <p>Evidenca: <i>Evidenca https://feut.edu.al</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vëren që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Çdo pedagog, në fillim të semestrit, gjatë prezantimit të lëndës/kursit, paraqet syllabus-in, i cili përmban objektivat mësimorë, format dhe kriteret e vlerësimit, literaturën bazë dhe ndihmëse.</i></p> <p><i>Qendra e Karrierës u siguron studentëve informacione të strukturuar dhe të përditësuara për pozicione pune, praktika profesionale, bursa studimi dhe trajnime të fokusuara në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu. Përmes marrëveshjeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, studentëve u mundësohet pjesëmarrja në projekte dhe praktika profesionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore pranë Fakultetit të Ekonomisë mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore për të gjithë studentët e regjistruar dhe të diplomuar në programin “Bachelor në Informatikë Ekonomike”. Dokumentacioni i administruar nga sekretaria mësimore përfshin:</p> <p>1- Regjistrin e studentëve të regjistruar për çdo vit akademik;</p>

	<p>2- Regjistrin e notave dhe procesverbalet e provimeve;</p> <p>3- Regjistrin e diplomave të lëshuara;</p> <p>4- Evidencat e vazhdueshme të ecurisë akademike për çdo student.</p> <p>Të dhënat statistikore përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numrin total të studentëve të regjistruar në program çdo vit akademik; - Numrin e të diplomuarve në fund të çdo viti; - Të dhëna mbi studentët që ndërpresin studimet, transferohen apo nuk përfundojnë me sukses vitin akademik; <table border="1" data-bbox="555 703 1343 943"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti</th> <th>Të diplomuar</th> <th>Nota Mestare në dalje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Bachelor në Informatikë Ekonomike</td> <td>2019 - 2022</td> <td>206</td> <td>7.7</td> </tr> <tr> <td>2020 - 2023</td> <td>198</td> <td>7.49</td> </tr> <tr> <td>2021 - 2024</td> <td>213</td> <td>7.53</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga vizita në IAL, GVJ vëren se raportimi për të diplomuarit e brezit 2022-2025, nuk është hartuar në momentin kur janë dorëzuar evidencat dhe realizuar vizitat në institucion.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Neni 79, 81</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.22 - FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 18.3 - FE Aplikime-Pranime 2018-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 18.4- FE Te dhëna per numrin e studenteve Rregjistruar Diplomuar.pdf</i></p>	Programi i studimit	Viti	Të diplomuar	Nota Mestare në dalje	Bachelor në Informatikë Ekonomike	2019 - 2022	206	7.7	2020 - 2023	198	7.49	2021 - 2024	213	7.53
Programi i studimit	Viti	Të diplomuar	Nota Mestare në dalje												
Bachelor në Informatikë Ekonomike	2019 - 2022	206	7.7												
	2020 - 2023	198	7.49												
	2021 - 2024	213	7.53												
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me</p>	<p>GVJ vëren se IAL-ja UT/FE, ruan dhe dokumenton të dhëna vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Sekretaria Mësimore është njësi përgjegjëse për menaxhimin e këtij dokumentacioni. Sekretaria ruan këto të dhëna në regjistrat zyrtarë, si: regjistri i studentëve të regjistruar, regjistri i notave të përfituara, procesverbalet e provimeve, regjistri i diplomave të lëshuara. Ky dokumentacion shërben si bazë për monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së programit. Referuar shqyrtimit të</p>														

<p>sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>dokumentacionit numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="550 353 1337 600"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Nota Mestare në hyrje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Bachelor në Informatikë Ekonomike</td> <td>2022 - 2023</td> <td>241</td> <td>9.52</td> </tr> <tr> <td>2023 - 2024</td> <td>241</td> <td>9.54</td> </tr> <tr> <td>2024 - 2025</td> <td>241</td> <td>9.42</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidenca: <i>Evidenca 1.22- FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i> <i>Evidenca 18.4- FE Te dhena per numrin e studenteve Rregjistruar Diplomuar.pdf</i> <i>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 21, 23</i></p>	Programi i studimit	Viti	Të regjistruar	Nota Mestare në hyrje	Bachelor në Informatikë Ekonomike	2022 - 2023	241	9.52	2023 - 2024	241	9.54	2024 - 2025	241	9.42
Programi i studimit	Viti	Të regjistruar	Nota Mestare në hyrje												
Bachelor në Informatikë Ekonomike	2022 - 2023	241	9.52												
	2023 - 2024	241	9.54												
	2024 - 2025	241	9.42												
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë, në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e UT-së, zbaton politika të mirëpërcaktuara për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të studentëve. Gjithashtu studentët përdorin platformën elektronike “e-Student”, përmes të cilës mund të menaxhojnë në mënyrë të pavarur procesin akademik dhe administrativ. Qasja në këtë sistem mundësohet përmes kredencialeve të siguruara nga platforma shtetërore e-Albania dhe u mundëson studentëve të realizojnë veprimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Regjistrimi në provime; ✓ Paraqitja e kërkesave për përmirësim të notës; ✓ Konsultimi i të dhënave personale dhe akademike, përfshirë listën e notave dhe historikun e regjistrimeve në provime; ✓ Realizimi i ankimeve për nota; ✓ Konsultimi i të dhënave financiare dhe tarifave sipas programit të ndjekur dhe viteve akademike përkatëse. <p>Evidenca: <i>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf, Neni 124</i> <i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Neni 56</i> <i>Evidenca 1.22- FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i> <i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></p>														
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë</p>	<p>Referuar vizitës në IAL, GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë zbaton një proces periodik të kontrollit dhe vlerësimit të dokumentacionit</p>														

<p>gjithë njësi përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>të studentëve të programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike”. Ky proces realizohet përmes strukturave përgjegjëse si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sekretaria Mësimore, e cila verifikon në fund të çdo viti saktësinë e regjistrave të studentëve, notave, diplomave dhe dokumentacionit të lidhur me ciklin e studimeve; - Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit e-Student. <p>Njësia përgjegjëse harton raporte vjetore mbi ecurinë e programit të studimit Bachelor Informatikë Ekonomike.</p> <p><i>GVJ rekomandon: Të azhurnohet raporti vjetor i DSIZ, në referencë me programin e studimit për vitin 2023-2024, 2024-2025.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.22- FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 11.10 - UT Manual Sistemi e-Student.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar vizitës në IAL, GVJ vëren se Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Ekonomisë, menaxhon dhe harton të dhëna statistikore për studentët në hyrje dhe dalje të programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike”. Këto të dhëna përfshihen në raporte mbi mesataret e pranimit, përfundimin në kohë të programit, si dhe rezultatet përfundimtare të studentëve të diplomuar. Raportet analitike përgatiten në përputhje me udhëzimet e rregullores së Qendrës së Karrierës. Këto raporte përfshihen në raportet vjetore strategjike të njësisë kryesore.</p> <p><i>GVJ rekomandon:</i></p> <p><i>Që në raportin vjetor të DSIZ, të përfshihet edhe raporti analitik i sekretarisë mësimore për vitin 2023-2024 dhe 2024-2025.</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 10.1-Raport mbi Qendren e Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se UT/FE, ruan dhe dokumenton të dhëna vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</i></p> <p><i>Dokumentacioni administrohet nga Sekretaria Mësimore. Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Ekonomisë,</i></p>

	<p>harton në mënyrë periodike raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve të programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike”.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p>Që në raportin vjetor të DSIZ, të përfshihet edhe raporti analitik i sekretarisë mësimore për vitin 2023-2024 dhe 2024-2025.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ vëren se studentët e programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike” janë të përfshirë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese të Universitetit të Tiranës, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, si dhe në referencë me Statutin dhe Rregulloren e UT-së. Studentët kanë përfaqësues të zgjedhur në strukturat akademike si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik UT, - Këshilli i Etikës, - Komisionet e përhershme institucionale, - Këshillat Studentorë në nivel universiteti dhe fakulteti. <p>Evidenca:</p> <p><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf</u>, Neni 129-134</p> <p><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u>, Kreu VII</p> <p><u>Evidenca 20.5 - UT Të drejtat dhe detyrat e studentëve.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 20.6 - UT Rregullore per zgjedhjet e Keshillave te Studenteve.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të</p>	<p>GVJ vëren se IAL-ja ka në strukturën e tij njësi ku studentët janë të përfshirë. Këto njësi ndihmojnë që studentët të jenë të përfshirë në vendimmarrje. Këshillat studentorë drejtohen nga rregullore të miratuara, që përcaktojnë përfaqësimin e tyre në këto njësi. Gjithashtu studentët përfshihen në pyetësorët periodikë të shpërndarë nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm</p>

<p>jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>të Cilësisë (NJSBC) si një mekanizëm për mbledhjen e mendimeve.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 20.5 - UT Të drejtat dhe detyrat e studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 20.6 - UT Rregullore për zgjedhjet e Keshillave të Studenteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Bazuar në evidenca dhe vizita në IAL, GVJ vëren se DSIZ garanton përfshirjen e studentëve të programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike” në vendimarrje në përputhje rregullore e IAL-së. DSIZ garanton përfshirjen aktive të studentëve në proceset e rishikimit dhe përmirësimit të kurrikulës së programit, duke u mbështetur në mekanizmat institucionalë të miratuar për sigurimin e cilësisë. Studentët e shprehin vlerësimin e tyre përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësorët e vlerësimit të lëndëve dhe të pedagogëve, të cilët plotësohen në fund të çdo semestri. 2. Grupet e fokusit, të organizuara periodikisht me pjesëmarrjen e studentëve nga të gjitha vitet akademike. 3. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në mbledhjet e Departamentit të DSIZ. <p>Këto mekanizma ndihmojnë në rritjen e cilësisë së programit dhe përshtatjen e tij me nevojat reale të studentëve dhe tregut të punës.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf, Kreu IX 129-134</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Kreu VII</i></p> <p><i>Evidenca 20.5 - UT Të drejtat dhe detyrat e studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 3 - FE Rregullore e Programit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 3.1 - IE Rregullore e Programit të Studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>GVJ vëren se studentët në Fakultetin i Ekonomisë, janë të përfshirë në dhënien e mendimeve në procesin e vlerësimit. Kjo përfshirje realizohet përmes disa mekanizmash të përcaktuar në rregullore e IAL-së. Disa nga format e shprehjes së mendimeve janë: Mekanizmat e Ankimit, ku studentët kanë të drejtën të kërkojnë rishikimin e notës përfundimtare, sipas një procedure të përcaktuar. Pyetësorët institucionalë të vlerësimit të stafit dhe lëndës dhe plotësimi i pyetësorëve anonimë që u mundësojnë studentëve të shprehin lirshëm mendimin e tyre; dhe përfaqësimi i tyre në këshillat studentorë.</p>

njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, 132</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf, Neni 61, 62, 65</i></p> <p><i>Evidenca 20.5 - UT Të drejtat dhe detyrat e studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.7 - UT Rregullore për Funkcionimin e Komisionit të përhershëm të kurrikulës.pdf, Neni 3, pika 5</i></p> <p><i>Evidenca 17.3 - FE Pyetësor Vlerësimi i lendes nga studenti.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.4 - FE Pyetësor Vlerësimi për pedagogun nga studenti.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ vëren se UT/FE garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit përmes përfaqësimit të zgjedhur në strukturat drejtuese akademike sipas rregullores së IAL-së, këshillat studentorë dhe shprehjen e mendimeve përmes pyetësorëve të ndryshëm, që realizohen në mënyrë periodike. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), çdo semestër shpërndan pyetësorë anonimë që u mundësojnë studentëve të shprehin lirshëm mendimin e tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ vëren se Fakulteti i Ekonomisë në UT ofron një strukturë të mirëpërcaktuar mbështetëse për studentët. Njësitë kryesore mbështetëse për studentët janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyra e Informacionit; 2. Sekretaria Mësimore; 3. Qendra e Karrierës; 4. Zyra e Shërbimeve Studentore; 5. Kujdestari i Studentëve; 6. Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët; 7. Koordinatorin e Programit të Studimit;

	<p>Gjithashtu, faqja zyrtare web e FE shërben si një burim informacioni për studentët, ku janë të publikuara funksionet dhe kontaktet e secilës njësi mbështetëse.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf</u></i>, Neni 40, 127</p> <p><i><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></i>, Kreu VII</p> <p><i><u>Evidenca 1.7 - UT Rregullore për Funkcionimin e Komisionit të përhershëm të kurrikulës.pdf</u></i>, Neni 3, pika5</p> <p><i><u>Evidenca 1.22 - FE Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 9.1.1 - Bachelor IE Vendim Koordinator Programit.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.1.1 - Shërbime Studentore - FEUT.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.7 - UT Rregullore-e-komisionit-të-mbarëvajtjes-së-veprimtarisë-dhe-marrëdhënieve-me-studentët.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>FE/UT ka një sistem funksional mbështetës për studentët, i cili përfshin informimin, këshillimin, ndjekjen e progresit akademik nga hyrja në dalje dhe asistencën e vazhdueshme për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Njësitë kryesore mbështetëse për studentët janë: Sekretaria Mësimore, Qendra e Karrierës, Zyra e Shërbimeve Studentore, Kujdestari i Studentëve, Koordinatori i Programit të Studimit. Platformat elektronike të përdorura nga fakulteti, mundësojnë që informacioni akademik të jetë i aksesueshëm në kohë reale për çdo student dhe staf pedagogjik.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf</u></i>, Neni 127</p> <p><i><u>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</u></i>, Kreu VII</p> <p><i><u>Evidenca 9.1.1 - Bachelor IE Vendim Koordinator Programit.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 10.2-Aktivitet-NjoftimetWeb-Zyra e Karrierës.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.1 - Studentët - Web Fakulteti i Ekonomisë. Universiteti i Tiranës.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.7 - UT Rregullore-e-komisionit-të-mbarëvajtjes-së-veprimtarisë-dhe-marrëdhënieve-me-studentët.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm,</p>	<p>GVJ vëren se në Fakultetin e Ekonomisë të UT, Qendra e Karrierës luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe profesional. Kjo qendër ofron këshillim individual dhe informacion të detajuar mbi mundësitë e karrierës, praktikat profesionale dhe kërkesat e tregut të punës. Qendra ofron shërbime të specializuara këshillimi individual, duke i orientuar studentët mbi mundësitë e zhvillimit profesional,</p>

<p>në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>kërkesat aktuale të tregut të punës dhe rrugët e mundshme të karrierës që lidhen me profilin e tyre të studimeve.</p> <p>Ajo ofron gjithashtu informacion të strukturuar mbi praktikat profesionale, programet e punësimit dhe bashkëpunimet me institucione publike e private. Në bashkëpunim me departamentin DSIZ, organizon panairë punësimi, trajnime, workshop-e dhe aktivitete që synojnë rritjen e punësimit të studentëve. Fakulteti i Ekonomisë kryen periodikisht pyetësorë me studentët Alumni, për të mbledhur të dhëna mbi ecurinë e tyre profesionale, cilësinë e përgatitjes akademike dhe nevojat për përmirësim të mëtejshëm të programit, duke zgjeruar kështu burimet e informacionit që shërbejnë për rritjen e cilësisë institucionale.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 12.6 - FE Alumni Pyetesor.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.12 - FE Raport Dita e Karrieres 2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 10.2-Aktivitet-NjoftimetWeb-Zyra e Karrierës.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.1 - Studentët - Web Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.0 - FE Udhezim mbi funksionimin e Zyres se Karrieres.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.3.2 - Keshilli Karrieres Aktivitetet FEUT.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ vëren se Qendra e Karrierës në FE mbledh dhe analizon të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve, me qëllim vlerësimin e programit Bachelor në Informatikë Ekonomike dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Rezultatet e këtyre analizave përdoren si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe për forcimin e lidhjes ndërmjet formimit akademik dhe nevojave profesionale. Informacionet e përpunuara publikohen në faqen zyrtare të fakultetit dhe prezantohen gjatë aktiviteteve informuese të organizuara nga Qendra e Karrierës, duke garantuar transparencë dhe akses publik në të dhënat mbi performancën e të diplomuarve.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 10.2-Aktivitet-NjoftimetWeb-Zyra e Karrierës.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 20.3.2 - Keshilli Karrieres Aktivitetet FEUT.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 12.6 - FE Alumni Pyetesor.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 17.5 - DSIZ ALUMNI Raport mbi Punesimin - Pyetesori i FE.pdf</u></i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se FE/UT ka një sistem funksional mbështetës për studentët, i cili përfshin informimin, këshillimin, ndjekjen e</p>


	<p>progresit akademik nga hyrja në dalje. Njësitë kryesore mbështetëse për studentët janë: Sekretaria Mësimore, Qendra e Karrierës, Zyra e Shërbimeve Studentore, Kujdestari i Studentëve, Koordinator i Programit të Studimit. Platformat elektronike të përdorura nga fakulteti mundësojnë që informacioni akademik të jetë i aksesueshëm në kohë reale për çdo student dhe staf pedagogjik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>GVJ gjatë vizitës në UT/FE, vëren një dëshirë të stafit akademik dhe administrativ për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në fillim të cdo viti akademik, DSIZ realizon azhurnimin e syllabuseve dhe literurës përkatëse ofron trajnime për stafin mbi metodologjinë e mësimdhënies, përfshirjen e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, përvetësimin e teknikave bashkëkohore të mësimdhënies, motivimin e studentëve dhe zhvillimin e kreativitetit. Trajnime janë realizuar edhe nga Qendra e Zhvillimit Profesional dhe Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional. Qendrat janë pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë e promovojnë zhvillimin profesional të personelit në UT.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu X</u></p> <p><u>Evidenca 8.5 - UT Vendim Senati Plani strategjik mbi zhvillimin profesional te personelit ne UT 23-28.pdf</u></p>

	<p><u>Evidenca 8.7 - Trajnimet në FEUT për metodat e reja të mësimdhënies dhe pedagogjinë.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.2 - UT Vendim Strategji Institucionale Mesimdhënie -nr.24.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.8 - FE Java e cilesise.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ vëren se në organigramën e FE ekziston Dega e Sigurimit të Cilësisë (DSC) në varësi të zv. Dekanit për Sigurimin e Cilësisë, Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, e cila ka si funksion përmirësimin e cilësisë në FE. Në UT ekziston gjithashtu Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik. Ky manual përcakton mënyrën dhe metodën e vlerësimit të personelit akademik të UT-së të të gjitha kategorive. Në këtë Manual, detajohen elementët e vlerësimit të procesit mësimor në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Veprimtaritë bazë brenda dhe jashtë auditorit në mbështetje të procesit arsimor; 2. Kontributi në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike; 3. Kontributi institucional; 4. Kontributi profesional; <p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e FE zhvillon çdo semestër pyetësorë studentorë për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve. Këta pyetësorë janë në përputhje me udhëzimet e Paketës së instrumentave të cilësisë. NJSBC ia përcjell raportet përfundimtare dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe ky më tej ia përcjell rektorit të Universitetit të Tiranës.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Që në raportin vjetor të NJSBC, të përfshihet edhe të dhënat për vitin 2023-2024 dhe 2024-2025(vjetor).</i></p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf, Kreu X</u></p> <p><u>Evidenca 7.1 - FE Organigrama 2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.6 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12 - UT-Paketa-e-instrumentave.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.1 - UT Vendimi-nr30-1 Manuali i vleresimit te performances se personelit akademik.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.2 - UT Plani i veprimit per SC 2024-2028.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.8 - FE Java e cilesise.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.6 - Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri 1.pdf</u></p>




	<p><u>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</u> <u>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ vëren se IAL-ja garanton përfshirjen e mendimit të studentëve raportin periodik të vlerësimit. NJSBC është struktura përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit. Për vlerësimin e programit “Bachelor në Informatikë Ekonomike”, NJSBC përdor mekanizma të standardizuar, si pyetësorët për vlerësimin e lëndës dhe pyetësorët për vlerësimin e pedagogut. Të dhënat e mbledhura përmes këtyre formave pasqyrojnë mendimet dhe përvojat e studentëve, dhe analiza e tyre lejon evidentimin e pikave të forta dhe pikat të dobëta të procesit mësimor, dhe procesin e vlerësimit. NJSBC analizon të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe i përcjell ato pranë organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse akademike përmes raportit vjetor, duke siguruar transparencë dhe mbështetje për vendimmarrjen institucionale.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 1.1- Statuti i UT.pdf</u> <u>Evidenca 1.21 - FE Rregullore e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.pdf</u> <u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</u> <u>Evidenca 1.6 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë.pdf</u> <u>Evidenca 11.1 - UT Vendimi nr. 51 “Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë UT.pdf</u> <u>Evidenca 12 - UT-Paketa-e-instrumentave.pdf</u> <u>Evidenca 12.2 - UT Plani i veprimit per SC 2024-2028.pdf</u> <u>Evidenca 17.6 - Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri 1.pdf</u> <u>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</u> <u>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC analizon të dhënat e grumbulluara dhe i komunikon ato organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatës përmes raportit të NJSBC-së. Kjo njësi bën publike rezultatet e vlerësimit nëpërmjet raporteve vjetore të hartuara në çdo vit akademik. Raporti i vlerësimit të NJSBC, depozitohet pranë njësisë kryesore FE dhe njësisë bazë DSIZ. Vlerësimet janë bërë në kohë dhe pedagogët kanë qenë të disponueshëm ndaj nevojave të studentëve.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 12 - UT-Paketa-e-instrumentave.pdf</u></p>

	<p><i>Evidenca 12.2 - UT Plani i veprimit per SC 2024-2028.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12.3 - FE Aktiviteti i NJSBC (ndryshuar).pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12.3.2 - FE Plani i Veprimtarise NJSBC 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12.8 - FE Java e cilesise.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Rezultatet e Raportit Vjetor të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) shqyrtohen nga organet drejtuese të UT/FE. Këto instrumente shërbejnë për përcaktimin e nivelit aktual të procesit mësimor dhe përvojës studentore, por edhe si bazë për ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësim të vazhdueshëm. Një komponent tjetër për rritjen e cilësisë është angazhimi i stafit akademik në programe zhvillimi profesional, përfshirë mobilitetet ndërkombëtare si Erasmus+ dhe trajnime të vazhdueshme të organizuara nga Qendra e Zhvillimit Profesional.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 17.6 - Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri 1.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se DSIZ monitoron mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, realizon azhurnimin e syllabuseve dhe literurës përkatëse, ofron trajnime për stafin. NJSBC është struktura që monitoron mbarëvajtjen e programit të studimit dhe raporton periodikisht në këtë drejtim. NJSBC përdor instrumente të ndryshëm për mbikëqyrjen e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Pyetësorët për vlerësimin e lëndës nga studenti, Pyetësorët për vlerësimin e pedagogut të cilët menaxhohen nga NJSBC, janë instrumentat kryesorë për realizimin e këtij procesi.</p> <p><u>GVJ rekomandon:</u></p> <p><i>Që në raportin vjetor të NJSBC, të përfshihet informacioni edhe për vitin 2023-2024 dhe 2024-2025 (vjetor).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2




Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti i Tiranës ka hartuar politika dhe rregullore në mbështetje të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC). Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Tiranës ka në strukturën e tij Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si strukturë themelore përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë brenda fakultetit. NJSBC-ja në FE përfshin tetë anëtarë, nga të cilët shtatë janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, dhe një është përfaqësues i Këshillit Studentor. Funkzioni i kësaj njësie mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” dhe Kodin e Cilësisë, VKM Nr. 531, datë 11.09.2018. Detyrat kryesore të kësaj njësie janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. zbaton politikën e UT-së për sigurimin e cilësisë dhe planifikon veprimtaritë monitoruese; 2. organizon veprimtaritë periodike të monitorimit për zbatimin e legjislacionit, të rregulloreve dhe të udhëzimeve, paketën e vlerësimit të brendshëm; 3. në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, sipas kalendarit përkatës, organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies; 4. përgatit raportin vjetor për sigurimin e cilësisë; <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Neni 141</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.3 - Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit të cilësisë.pdf</u></i></p> <p><i><u>1.21 - FE Rregullore e Njësive të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.pdf</u></i></p> <p><i><u>12.4 - FE Perberja e Komisionit të NJSBC 2024-2025.pdf</u></i></p> <p><i><u>17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe</p>	<p>Bazuar në evidencat e IAL-së, GVJ vëren se UT ka në strukturën e tij, njësi përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, si: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPSSC), dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Këto njësi realizojnë vlerësimin e brendshëm të njësive që ofrojnë programin e studimit. KPSSC përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 3 janë studentë. NJSBC është ngritur pranë FE dhe ka në përbërje 8 anëtarë, ndër të cilët një është student. Kjo njësi funksionon si mekanizëm për të garantuar</p>

<p>bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm në FE dhe rezultatet paraqiten në raportin vjetor.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Neni 141</u></p> <p><u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.21 - FE Rregullore e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.2 - UT Plani i veprimit per SC 2024-2028.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.3.3 - FE Plani i Veprimtarise NJSBC 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.4 - FE Perberja e Komisionit te Njsbc 2024-2025.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vëren se Universiteti i Tiranës ka një strukturë dhe proces të mirëorganizuar për sigurimin e cilësisë. Akreditimi institucional i UT me vlerësim pozitiv për një periudhë gjashtëvjeçare, bazuar në Vendimin Nr. 4 të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, datë 27.01.2023, është element tregues për procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Programi i studimit “Bachelor në Informatikë Ekonomike” ndodhet për herë të parë në fazën e vlerësimit për akreditim. Gjithashtu FE dhe DSIZ realizojnë vlerësime analitike e krahasuese në lidhje me tregun e punës.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 21.3.2 - DSIZ RaportimVjetor 2022-2023.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>NJSBC-ja e Fakultetit të Ekonomisë miraton në fillim të çdo viti, Planin e Veprimtarisë së NJSBC-së. Plani i Veprimtarisë së NJSBC-së ka 2 komponentë: “Kërkimin shkencor” dhe ‘Mësimdhënia’.</p> <p>NJSBC ngarkon njësi të caktuara për grumbullimin e informacionit. Për “Kërkimin shkencor” ngarkohen departamentet të pasqyrojnë të dhëna rreth stafit akademik dhe punës kërkimore-shkencore që ata kanë realizuar, ndërsa sa i përket mësimdhënies, i referohen pyetësorëve të studentëve.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 12.2 - UT Plani i veprimit per SC 2024-2028.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.3.3 - FE Plani i Veprimtarise NJSBC 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 21.3.2 - DSIZ RaportimVjetor 2022-2023.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 21.4.1 - DSIZ Raport PunaKerkimoreShkencore 2023-2024.pdf</u></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ vëren se Universiteti i Tiranës ka një proces të mirëorganizuar për sigurimin e cilësisë. NJSBC-ja e Fakultetit të Ekonomisë miraton në fillim të çdo viti, Planin e Veprimtarisë së NJSBC-së. Plani i Veprimtarisë së NJSBC-së ka 2 komponentë: "Kërkimin shkencor" dhe "Mësimdhënia". NJSBC aktivizon mekanizma të ndryshëm për grumbullimin e informacionit.</i></p> <p><i>Për "Kërkimin shkencor" ngarkohen departamentet të pasqyrojnë të dhëna rreth stafit akademik dhe punës kërkimore-shkencore që ata kanë realizuar, ndërsa sa i përket mësimdhënies, i referohen pyetësorëve të studentëve. NJSBC-ja përgatit raportin vjetor të njësisë kryesore, ku paraqitet e gjithë veprimtaria akademike dhe kërkimore shkencore e stafit akademik dhe FE.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura</p>	<p>Në mënyrë periodike, çdo fund semestri UT angazhohet për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit. Ky proces koordinohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Instrumentat e përdorur në këtë proces janë të përcaktuar në 'Paketën e instrumenteve të cilësisë'. Ata përfshijnë metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të monitorimit dhe vlerësimit, mbi përputhshmërinë e përmbajtjes akademike me objektivat e përcaktuara, organizimin e ngarkesës orare, si dhe cilësinë e materialeve didaktike. NJSBC harton raportin vjetor, ku përfshihet analiza e të dhënave të mbledhura, ku vlerësimi i brendshëm përfshin edhe analiza mbi strukturën dhe përmbajtjen e syllabuseve, për të siguruar që ato janë në përputhje me objektivat akademike të programit, si dhe vëzhgime të drejtpërdrejta të procesit mësimor, kontrollin e mënyrës së zhvillimit të provimeve, shqyrtimin e procesverbaleve dhe elementë të tjerë të rëndësishëm për funksionimin cilësor të programit.</p>

<p>autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raporti vjetor prezantohet tek njësitë drejtuese të FE, ku merren masa për përmirësimin rezultateve.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.6 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 11.4 - UT Rregullore-per-organizmin-dhe-funksionimin-e-Njsbc.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12 - UT-Paketa-e-instrumentave.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ vëren se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Fakultetin e Ekonomisë, harton raportin vjetor të veprimtarisë së saj, dhe pasqyron të gjithë elementët kyç të vlerësimit cilësor, në përputhje me Manualin e Sigurimit të Cilësisë në UT, Rregulloren për sigurimin e cilësisë në UT dhe Planin e Veprimtarisë së NJSBC-së për vitin 2024–2025. Raportet e vlerësimit për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përfshijnë: objektivat formues, të përcaktuara në mënyrë të qartë në dokumentet e programit si syllabuset dhe planet mësimore, rezultatet reale të arritura, progresi akademik dhe punësimi pas diplomimit, identifikimin e mangësive dhe dobësive në zbatimin e programit, si dhe masat e ndërmarra për përmirësim, të dokumentuara në Planin e Veprimit të NJSBC-së dhe në Strategjinë e Zhvillimit të UT 2023–2028.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 1.3 - Strategjia e Zhvillimit te UT 2023-2028.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.1 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 12.3.3 - FE Plani i Veprimtarise NJSBC 2024-2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 21.3.2 - DSIZ RaportimVjetor 2022-2023.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>	<p>NJSBC në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, zbaton një kombinim të metodave të drejtpërdrejta të</p>

<p>cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>vlerësimet. Këto metoda përfshijnë: Vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, Vlerësimin e didaktikës dhe të kurrikulës, Vëzhgime në auditorë dhe ambiente laboratorike. Këto metoda janë të dokumentuara në planet vjetore të veprimtarisë së NJSBC-së dhe shërbejnë për vendimmarrje mbi përmirësimet në programin e studimit.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 12.3.3 - FE Plani i Veprimtarisë NJSBC 2024-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.3.2 - DSIZ RaportimVjetor 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>NJSBC zbaton gjithashtu një sërë formash të tërthorta të vlerësimit me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Ndër këto forma, një rol të rëndësishëm luajnë pyetësorët e studentëve, të cilët përdoren për të mbledhur informacion të strukturuar mbi perceptimet, kënaqësinë dhe përvojën e tyre gjatë procesit mësimor. Përmes këtyre instrumenteve, institucioni arrin të identifikojë pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim, duke e bazuar vendimmarrjen në të dhëna reale dhe të qëndrueshme.</p> <p>Përveç kësaj, Qendra e Karrierës luan një funksion thelbësor në ndjekjen e ecurisë së të diplomuarve. Ajo mban kontakte të rregullta me ish-studentët dhe mbledh të dhëna të vlefshme mbi rrugëtimin e tyre profesional pas përfundimit të studimeve. Këto informacione ndihmojnë institucionin të vlerësojë nëse programi i studimit i përgatit studentët në mënyrë efektive për tregun e punës dhe nëse të përshtatë kurrikulën mësimore sipas kërkesave të zhvillimit profesional dhe nevojave të sektorëve përkatës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 12 - UT-Paketa-e-instrumentave.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 12.6 - FE Alumni Pyetesor.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</i></p>

Konkluzione	GVJ vëren se UT angazhohet në mënyrë periodike në vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit. Ky proces koordinohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Instrumentat e përdorur në këtë proces janë të përcaktuar në 'Paketën e instrumenteve të cilësisë'. Raportet e vlerësimit për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përfshijnë: objektivat formues, të përcaktuara në mënyrë të qartë në dokumentet e programit si syllabuset dhe planet mësimore, rezultatet reale të arritura, progresi akademik dhe punësimi pas diplomimit, identifikimin e mangësive dhe dobësive në zbatimin e programit, si dhe masat e ndërmarra për përmirësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se UT ka përfshirje të njësisve drejtuese, në përputhje me përcaktimet e Statutit të UT-së dhe me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC. Struktura e NJSBC-së përfshin një përfaqësim sa më të gjerë institucional, duke përfshirë përfaqësues nga njësitë akademike kryesore si edhe një anëtar të zgjedhur nga radhët e studentëve. Gjithashtu institucioni mbështet përfshirjen e aktorëve të tjerë të rëndësishëm, si stafin akademik e administrativ, ish-studentët (Alumni), partnerët institucionalë dhe bashkëpunëtorë të tjerë. Këta aktorë ofrojnë sugjerime dhe praktika reale për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të programit Bachelor Informatikë Ekonomike. <u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu X</u> <u>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</u> <u>Evidenca 11.4- UT Rregullore-per-organizmin-dhe-funksionimin-e-Njsbc.pdf, Kreu II</u> <u>Evidenca 12.4 - FE Perberja e Komisionit te Njsbc 2024-2025.pdf</u>




<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar statutit dhe rregullores së UT, GVJ vëren se në nivel institucional përgjegjësit për cilësinë janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i përhershëm i Cilësisë së UT, Rektori, Administratori i UT, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Universiteti, Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, Këshilli i Studentëve. Detyrat, individët dhe strukturat përcaktohen në rregulloren për sigurimin e cilësisë. Të gjithë këta njësi kanë detyra të qarta për të siguruar cilësinë.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu X</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 - UT Manual i sigurimit te cilesise.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.6 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Përmes strukturës së NJSBC-së, garantohet angazhimi i drejtpërdrejtë i njësisë përgjegjëse për programin, i personelit akademik, administrativ, dhe i studentëve, të cilët kontribuojnë në mënyrë aktive në këtë proces. Njësia bazë që mbulon programin e studimit, harton raporte, bazuar në anketimet dhe diskutimet e realizuara me stafin. Këto mekanizma, të mbështetura nga të dhënat e pyetësorëve për studentët, ndihmojnë në krijimin e një raporti gjithëpërfshirës.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>1.4 - Kodi Etikes UT.pdf</i></p> <p><i>17.3 - FE Pyetesor Vleresimi i lendes nga studenti.pdf</i></p> <p><i>17.4 - FE Pyetesor Vleresimi per pedagogun nga studenti.pdf</i></p> <p><i>Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 20</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se komisionet e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti krijohen duke përfshirë si anëtarë stafin akademik ashtu edhe përfaqësuesit e studentëve, duke garantuar kështu gjithëpërfshirje dhe shmangie të pabarazisë apo diskriminimit. Këto komisione funksionojnë në përputhje me parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes së gjerë në proceset e vlerësimit institucional. Gjithashtu, struktura dhe funksionimi i Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përcaktohen në Statutin e Universitetit të Tiranës, në nenin 141, i cili rregullon organizimin, përgjegjësitë dhe rolin e saj në monitorimin e cilësisë akademike.</p> <p>Evidenca:</p> <p><i>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu X</i></p> <p><i>Evidenca 1.2 - Rregullore e UT.pdf</i></p>

	<p><u>Evidenca 1.4 - Kodi Etikes UT.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 1.6 - UT Rregullore për sigurimin e cilësisë.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 8.4.1 - UT Barazia gjinorePBGJ 2024-2026.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është e harmonizuar në varësi të kërkesave dhe standardet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. NJSBC ushtron veprimtarinë e saj duke siguruar një proces të qëndrueshëm dhe sistematik vlerësimi, monitorimi dhe përmirësimi të cilësisë së veprimtarisë akademike të institucionit. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, institucioni ka zhvilluar marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me një gamë të gjerë institucionesh, si nga sektori publik, ashtu edhe nga ai privat. Këto partneritete krijojnë hapësira për zhvillimin profesional të stafit akademik, përmes shkëmbimeve të përvojave, trajnimeve dhe angazhimeve në projekte të përbashkëta. Njëkohësisht, ata ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për studentët, duke u ofruar mundësi praktike, orientim profesional dhe përfshirje në tregut të punës.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><u>Evidenca 22.1 - Marreveshjet NderInstitucionale Mars 2025.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 22.2 - Lista Marreveshjeve Institucionale Praktikant 2023-2024.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 22.3 - Lista Marreveshjeve Institucionale Praktikant 2022-2023.pdf</u></p> <p><u>Evidenca Aneks Tabelat Përmbledhëse, Tab. 5</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vëren se UT ka përfshirje të njësisve drejtuese, në përputhje me përcaktimet e Statutit të UT-së dhe me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC. Struktura e NJSBC-së përfshin një përfaqësim sa më të gjerë institucional, duke përfshirë përfaqësues nga njësitë akademike kryesore si edhe një anëtar të zgjedhur nga radhët e studentëve.</p> <p>Gjithashtu institucioni mbështet përfshirjen e aktorëve të tjerë të rëndësishëm, si stafin akademik e administrativ, ish-studentët (Alumni), partnerët institucionalë dhe bashkëpunëtorë të tjerë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>NJSBC garanton transparence në lidhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, si edhe me politikat, procedurat dhe veprimtaritë që ndërmerren në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. NJSBC harton dhe shpërndan raportin vjetor, i cili u përcillet njëjësive bazë të fakulteteve për të siguruar informim të rregullt dhe të aksesueshëm. Në këtë mënyrë, sigurohet një proces komunikimi i qëndrueshëm, sistematik dhe efikas midis strukturave qendrore dhe atyre akademike, duke mundësuar përfshirje më të gjerë të stafit dhe rritje të përgjegjshmërisë institucionale në raport me cilësinë.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 1.1 - Statuti i UT.pdf, Kreu X</u> <u>Evidenca 1.3 - Strategjia e Zhvillimit të UT 2023-2028.pdf</u> <u>Evidenca 1.4 - Kodi Etikes UT.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>IAL-ja ka të miratuar Kodin e Etikës, i cili ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes sipas standardeve të vendosura, në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të universitetit dhe me lirinë akademike. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në njësinë kryesore FE kryen funksione që synojnë garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe administrative.</p> <p>Gjithashtu, ajo ndjek procesin e vlerësimit të brendshëm, mbikëqyr përgatitjen e raporteve përkatëse, monitoron kushtet për vlerësimin e jashtëm dhe koordinon masat strategjike të përmirësimit. Raportet e NJSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Rezultatet e NJSBC publikohen duke respektuar lirinë, etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale, duke respektuar statutin dhe rregulloren, kodin e etikës e IAL-së.</p> <p><u>Evidenca:</u> <u>Evidenca 1.4 - Kodi Etikes UT.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të</p>	<p>GVJ vëren se NJSBC-ja përpunon një plan veprimi për aktivitetet që do kryejë gjatë vitit akademik. Kjon njësi</p>

<p>shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe të gjitha veprimtarive përkatëse, duke mbikëqyrur zbatimin e standardeve të cilësisë në përputhje me misionin dhe planin strategjik të njësisë. Plani i veprimit hartohet në 4 pika kryesore, si: Mësimdhënia, Kërkimi shkencor, Aktiviteti akademik, dhe Akreditimi dhe sigurimi i cilësisë. Të dhënat mbliidhen përmes pyetësorëve, takimeve, dhe raporteve kërkimore shkencore të DSIZ.</p> <p>NJSBC shqyrton dhe analizon të dhënat e mbledhura nga anketimet e realizuara me studentët dhe aktorë të tjerë institucionalë dhe duke u bazuar në rezultatet e këtyre anketimeve, NJSBC nxjerr përfundime të cilat raportohen deri në nivel departamenti. Departamenti DSIZ diskuton në lidhje me problematikat, dhe zbaton mekanizma si përmirësimi i kurrikulës dhe syllabuse-ve etj për zgjidhjen e tyre.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 17.6 - Raporti NJSBC 2024-2025 Semestri 1.pdf</u></i></p> <p><i><u>9.1 - DSIZ Mbledhje departamenti Pedagoget Mbikqyres te Programeve 10 Shtator 24.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 2.5 - Kerkese Dekanit Ndryshim Lendesh 2023.pdf</u></i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>FE/DSIZ ushtron një rol të rëndësishëm në vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore, duke analizuar cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, por edhe marrëdhëniet ndërvepruese midis stafit akademik dhe studentëve. Njësia e sigurimit të cilësisë siguron koordinimin e zbatimit të standardeve të kontrollit të brendshëm. Ajo organizon aktivitete të rregullta monitorimi dhe përmirësimi, si dhe vlerëson e publikon të gjitha veprimtaritë e përgatitura nga NJSBC e UT-së në kuadër të paketës së instrumenteve, udhëzuesve dhe manualeve përkatëse të cilësisë.</p> <p>Analizat e kryera gjatë vitit akademik përmbliidhen në raportet vjetore të departamenteve dhe fakultetit, të cilat paraqesin performancën akademike, administrative dhe bashkëpunimit me studentët. Në vijim, raportet integrohen në raportin vjetor të Universitetit të Tiranës, duke kontribuar në analizën institucionale të performancës dhe në ndërmarrjen e politikave për përmirësim të vazhdueshëm. Këto raporte diskutohen dhe miratohen nga strukturat drejtuese, dhe përfshihen në raportin vjetor të Universitetit të Tiranës.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i><u>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</u></i></p> <p><i><u>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</u></i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit, organizon takime me stafin akademik dhe me studentët, për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe të aktivitetit akademik. Personeli akademik informohet mbi raportet vjetore të përgatitura nga NJSBC, të cilat përmbajnë analiza dhe rekomandime mbi performancën e programit të studimit. Në mbledhjet periodike të departamentit dhe të dekanatit diskutohen gjetjet dhe identifikohen problematikat që lidhen me organizimin e mësimdhënies, infrastrukturën, ngarkesën akademike etj.</p> <p>DSIZ dhe NJSBC bazuar në problemet e identifikuara përmes analizës, si përmirësimi i kurrikulave, syllabuseve, literaturës së përdorur, kualifikimet e stafit akademik, sugjerojnë zgjidhje duke kontribuar kështu në rritjen e përgjithshme të cilësisë institucionale.</p> <p><u>Evidenca:</u></p> <p><i>Evidenca 17.1 - Raport NJSBC 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 21.2 - Raporti vjetor FEUT 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>9.1 - DSIZ Mbledhje departamenti Pedagoget Mbikqyres te Programeve 10 Shtator 24.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka një angazhim të qartë dhe të strukturuar ndaj vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë, si pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Kjo qasje reflekton funksionimin efektiv të mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, përmes të cilëve vlerësohet në mënyrë periodike performanca akademike, zbatimi i standardeve dhe cilësia e përvojës studentore.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) luan një rol qendror në këtë proces, duke garantuar transparencë të plotë lidhur me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, politikat institucionale dhe veprimtaritë e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Përmes hartimit dhe shpërndarjes së raportit vjetor, NJSBC siguron që informacioni të mbërrijë në mënyrë të rregullt dhe të qartë tek njësitë bazë të fakulteteve. Ky proces ndikon në rritjen e ndërgjegjësimin institucional, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet njësive akademike dhe garantimin e një monitorimi të qëndrueshëm dhe efikas të cilësisë në të gjitha nivelet e universitetit.</p> <p>Mekanizmat e ngritur të vlerësimit dhe transparencës mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit,</p>

	<i>rritjen e cilësisë akademike dhe përmirësimin e përgjithshëm të funksionimit institucional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor. (Standarti IV.2, Standarti IV.3, kriteri 1)
2. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. (Standarti I.1)
3. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, organizojnë këtë program studimi me angazhimin e një stafi të përkushtuar, të plotësuar me tituj dhe grada sipas akteve ligjore në fuqi dhe të kualifikuar në fushën përkatëse të studimit. (Standarti I.1, Kriteri 4, Standarti II.1, Kriteri 1, Standarti IV.1, Kriteri 1)
4. Programi gëzon kërkesë të lartë nga të rinjtë, gjë që reflektohet në numrin e madh dhe të qëndrueshëm të studentëve të regjistruar. (Standarti V.4, Kriteri 2)
5. Në mbështetje të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit të Tiranës, ku përcaktohet si prioritet ndërkombëtarizimi, institucioni ka krijuar bashkëpunime me kompani për krijimin e programeve të praktikës profesionale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe sigurimin e mundësive të punësimit për studentët dhe partneritete me institucione akademike dhe kërkimore si shkëmbimin e njohurive, organizimin e konferencave të përbashkëta apo mundësi për studime të avancuara dhe projekte kërkimore. (Standarti I.2, Kriteri 2)
6. Plani mësimor (kurrikula) dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh dhe në përputhje me ato të ofruara nga IAL të tjera. (Standarti II.1, Kriteri 1, 3, 6; Standarti II.4, Kriteri 3, Standarti III.4, Kriteri 4)
7. Komunikim student-pedagog, student-institucion është i mirë. (Standarti III.1, Kriteri 4, Standarti IV.4, Kriteri 4)
8. Institucioni mbështet organizimin e studentëve në Këshilla studentorë. (Standarti II.5, Kriteri 2, Standarti V.5, Kriteri 1, 3)
9. Personeli akademik mbështetet financiarisht nga IAL në rritjen e tyre akademike dhe profesionale. (Standarti III.1, Kriteri 3)
10. Universiteti i Tiranës ka funksionale mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë ku përfshihen edhe studentët. (Standarti VI.1, Kriteri 1, 2)
11. Fakulteti i Ekonomisë administron informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes një sistemi menaxhimi elektronik me anë të të cilit ndjek ecurinë e studentëve që nga regjistrimi deri në diplomim. (Standarti IV.4, Kriteri 1, Standarti V.3, Kriteri 4, Standarti V.4, Kriteri 1)
12. Faqja web zyrtare e Fakultetit të Ekonomisë është e pasur me informacione të përditësuara dhe lehtësisht të aksesueshme si: rregulloret institucionale, udhëzuesit,

- bibliotekën, kriteret e pranimeve/ kuotave/ transferimeve për çdo program studimi, etj. (Standarti IV.4, Kriteri 6, Standarti V.3, Kriteri 3)
13. Fusha e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përputhet me nevojat e tregut të punës, kjo ndikon në punësimin e studentëve të diplomuar. (Standarti II.4, Kriteri 4)
 14. Struktura e programeve të studimit të ofruara nga Fakultetit të Ekonomisë e Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, plotesojnë të gjitha ciklet e studimit për studentët, kjo ofron qëndrueshmëri dhe vazhdimsi të përparimit akademik të tyre. (Standarti I.1, Kriteri 5)
 15. Institucioni nxit pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete. (Standarti III.4, Kriteri 4)

b. Pika të dobëta:

1. Mungon një program i miratuar/licensuar për të shmangur plagjiaturën në projektet apo tezat e diplomave bachelor. (Standardi III.3, Kriteri 5)
2. Shpërndarje jo uniforme, në zhvillimin e ngarkesës vjetore të stafit akademik PAE të DSIZ. (Standardi IV.1, Kriteri 2)

Rekomandime:

1. Të përditësohen syllabuset dhe plani mësimor specifikisht duke vendosur kodet e lëndëve; përcaktuar kreditet/orët e dedikuara të detyrave të kursit/projekteve; përcaktuar temat javore me orët përkatëse në çdo javë sipas ndarjes në leksione, seminare, laboratore dhe detyra kursi (në syllabuse). (Standardi II.3, Kriteri 4)
2. Institucioni të rrisë fondet e dedikuara për mbështetjen e aktivitetit kërkimor-shkencor të stafit akademik dhe njëkohësisht, të hartojë e zbatojë një procedurë të standardizuar të mbështetjes financiare, e orientuar drejt fuqizimit të publikimeve në revista të indeksuara (SCOPUS, Web of Science), pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe rritjes së performancës kërkimore-shkencore të institucionit. (Standardi III.1, Kriteri 3)
3. Institucioni/Fakulteti të ngriejë komisionet e mbrojtjes së diplomave me jo më pak se tre anëtarë, me qëllim rritjen e transparencës dhe objektivitetit të vlerësimit, si dhe të hartojë dhe zbatojë një procedurë të standardizuar për punimin e diplomës, duke përfshirë përgatitjen e një manuali të posaçëm që t'u vihet në dispozicion studentëve edhe në faqen zyrtare të institucionit. (Standardi III.5, Kriteri 2 dhe 6)
4. Në mbështetje të realizimit të ngarkesës mësimore të ketë një shpërndaje uniforme tek stafi PAE. (Standardi IV.1, Kriteri 2)
5. Të bëhen raportimet vjetore të DSIZ, në mënyrë periodike, pasi mungojnë për dy vitet e fundit akademike, 2023-2024, 2024-2025, të përfshihet edhe raporti analitik i sekretarisë mësimore. (Standardi IV.1, Kriteri 3, Standardi V.4, Kriteri 4 dhe 5)
6. Institucioni të shtojë postet PC në bibliotekë, në mbështetje të studentëve, në funksion dhe mbështetje të procesit të studimit. (Standardi IV.3, Kriteri 3)

7. Në sistemin ‘Sistemi inteligjent i dokumentacionit shkresor’, viti 2016, të shtohen shërbime e reja për ruajtjen e të dhënave të stafit akademik. (Standardi IV.4, Kriteri 2)
8. Të publikohen në faqen zyrtare të UT-së, në seksionin “Programi i Transparencës” [<https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/>], dokumentacioni mbështetës për procesin e auditimit. (Standardi IV.5, Kriteri 3)
9. Në raportin vjetor të NJSBC, të përfshihet të dhënat për vitin 2023-2024 dhe 2024-2025(vjetor). (Standarti VI.1, Kriteri 2)
10. Të përdoret një program (psh. softueri Turnitin) për parandalimin e plagjiaturës edhe në ciklin e parë, Bachelor. (Standarti III.3, Kriteri 5)

Evaluation’s conclusions for the first cycle study program Bachelor in “Economic Informatics”

a. Strengths and affirmations:

1. The suitable facilities and modern didactic infrastructure available to the study program provide the necessary contemporary spaces and conditions for the teaching process. (Standard IV.2, Standard IV.3, Criterion 1)
2. The study program is designed in accordance with the development strategy of the Higher Education Institution (HEI) and the country's economic development, addressing labor market needs in line with the strategic goals of national economic growth. (Standard I.1)
3. The Faculty of Economics and the Department of Applied Statistics and Informatics organize this study program with the commitment of a dedicated staff, qualified in their respective fields, holding academic titles and degrees in accordance with the applicable legal acts. (Standard I.1, Criterion 4, Standard II.1, Criterion 1, Standard IV.1, Criterion 1)
4. The program demonstrates sustained demand among students, reflected in consistently high enrollment numbers. (Standard V.4, Criterion 2)
5. In support of the Internationalization Strategy of the University of Tirana, where internationalization is defined as a priority, the institution has established collaborations with companies to create professional internship programs, develop joint projects, and provide employment opportunities for students, as well as partnerships with academic and research institutions for knowledge exchange, joint conferences, advanced studies, and research projects. (Standard I.2, Criterion 2)
6. The subjects, the curriculum, and the organization of the study program are in line with the formative objectives of the students for this cycle of studies and are similar to those offered by other Higher Education Institutions (HEIs). (Standard II.1, Criterion 1, 3, 6; Standard II.4, Criterion 3, Standard III.4, Criterion 4)

7. Good communication between students and faculty, as well as between students and the institution. (Standard III.1, Criterion 4, Standard IV.4, Criterion 4)
8. The institution supports the organization of students in student councils. (Standard II.5, Criterion 2, Standard V.5, Criterion 1, 3)
9. Academic staff are financially supported by the university in their academic and professional development. (Standard III.1, Criterion 3)
10. The University of Tirana has functional internal and external mechanisms for monitoring and continuously improving quality, which also involve students. (Standard VI.1, Criterion 1, 2)
11. The Faculty of Economics manages student, academic staff, and administrative staff information through an electronic management system that tracks student progress from enrollment to graduation. (Standard IV.4, Criterion 1, Standard V.3, Criterion 4, Standard V.4, Criterion 1)
12. The official website of the Faculty of Economics is rich in up-to-date and easily accessible information such as institutional regulations, guides, library access, admission criteria/quotas/transfers for each study program, etc. (Standard IV.4, Criterion 6, Standard V.3, Criterion 3)
13. The field of the Bachelor's program in Economic Informatics matches labor market needs, which positively impacts the employability of its graduates. (Standard II.4, Criterion 4)
14. The structure of the study programs offered by the Faculty of Economics and the Department of Statistics and Applied Informatics covers all study cycles, ensuring stability and continuity in students' academic progress. (Standard I.1, Criterion 5)
15. The institution encourages student participation in mobility programs. (Standard III.4, Criterion 4)

c. Weaknesses:

1. There is no approved/licensed program to prevent plagiarism in bachelor's projects or theses. (Standard III.3, Criterion 5)
2. There is an overload of the full-time academic staff (PAE) of the Department of Statistics and Applied Informatics in developing the annual teaching workload, as a consequence of its non-uniform distribution. (Standard IV.1, Criterion 2)

Recommendations

1. The syllabuses and curricula should be updated specifically by assigning course codes; defining credits/hours dedicated to coursework/projects; and specifying weekly topics with their corresponding hours divided into lectures, seminars, labs, and coursework (in syllabuses). (Standard II.3, Criterion 4; Standard II.5, Criterion 1)
2. The institution should increase the funds dedicated to supporting the research activities of the academic staff and, simultaneously, develop and implement a standardized




procedure for financial support, aimed at strengthening publications in indexed journals (SCOPUS, Web of Science), participation in scientific conferences, and enhancing the institution's research performance. **(Standard III.1, Criterion 3)**

3. The institution/faculty should establish thesis defense committees consisting of at least three members to ensure greater transparency and more objective evaluation. In addition, it should develop and implement a standardized procedure for thesis preparation, including the creation of a dedicated manual to be made accessible to students, also via the institution's official website. **(Standard III.5, Criterion 6; Standard III.5, Criterion 2)**
4. To support the fulfillment of teaching workload in compliance with the applicable legal acts, there should be a uniform distribution among the PAE staff. **(Standard IV.1, Criterion 2)**
5. Annual DSIZ reports should be made periodically, as they are missing for the last two academic years, 2023-2024, 2024-2025, also should be included the analytical report of the academic secretariat. **(Standard IV.1, Criterion 3, Standard V.4, Criterion 4 and 5)**
6. The institution should add PC positions in the library, to support students in the study process. **(Standard IV.3, Criterion 3)**
7. In the "Intelligent Written Documentation System," established in 2016, new services should be updated for storing academic staff data. **(Standard IV.4, Criterion 2)**
8. The University of Tirana should publish supporting documentation for the auditing process in its official website under the "Transparency Program" section [<https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/>]. **(Standard IV.5, Criterion 3)**
9. In the annual report of the NJSBC, data for the year 2023-2024 and 2024-2025 should also include. **(Standard VI.1, Criterion 2)**
10. A software (e.g. Turnitin software) must be used to prevent plagiarism even in the first cycle, Bachelor. **(Standard III.3, Criterion 5)**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

